



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës
“Mbrojtja dhe Administrimi i Monumenteve të Kulturës”**



Shtator 2022

PËRMBAJTJA

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	3
1.1 Konteksti i Problemit Social	3
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	4
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim	4
2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjen	6
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit	7
2.4 Pesha në buxhet	9
2.5 Feedback-u i subjekteve gjatë gjithë auditimit	13
3. DETAJET E AUDITIMIT	14
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve	14
3.2 Objektivat e auditimit	15
3.3 Pyetjet e auditimit	15
3.4 Fushëveprimi i auditimit	16
4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE	16
4.1 A është i plotë kuadri rregullator për menaxhimin e monumenteve të kulturës?	17
4.1.1 A janë hartuar aktet rregullatore në funksion të mirëmenaxhimit të monumenteve të kulturës?	17
4.2 A ka rezultuar i përshtatshëm funksionimi dhe koordinimi i institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës?	37
4.2.1 A janë ngritur dhe funksionojnë institucionet përgjegjëse për mirëmenaxhimin e monumenteve të kulturës?	37
4.2.2 A ka gjeneruar veprimtaria e këtyre institucioneve përmirësim të proceseve të mirëadministrimit të monumenteve të kulturës?	45
4.3 A është garantuar financim buxhetor i duhur për menaxhimin e monumenteve të kulturës?	72
4.3.1 A ka rezultuar i mjaftueshëm financimi buxhetor në drejtim të mirëadministrimit të monumenteve të kulturës?	72
4.3.2 A ka sjellë financimi buxhetor impaktin e duhur në mirëadministrimin e monumenteve të kulturës?	81
5. PËRMBLEDHJA	85
6. SHTOJCAT	86
7. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	91

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i Problemët Social

Monumentet e Kulturës së një kombi janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj të tij. Këto institucione shpirtërore dhe materiale të një kombi duhet të marrin vendin që ju takon, të bëhen të vlefshëm deri të shenjta për të gjithë popullin shqiptar. Trashëgimia kulturore e secilit vend del nga kultura, traditat, zakonet dhe historia e banorëve të atij vendi, prandaj duhet ruajtur dhe mbrojtur për gjeneratat e ardhshme. Përmes trashëgimisë kulturore, procesi historik i formimit dhe jetës së një populli shprehet dhe përfaqësohet, sepse është sinteza e dukshme dhe e prekshme e elementeve që e karakterizojnë atë. Përmes kësaj trashëgimie përforcohet identiteti rajonal ose kombëtar dhe ndjenja e përkatësisë ndaj një populli. Meqenëse është produkt dhe shprehje e krijimtarisë njerëzore, trashëgimia kulturore transmetohet, rikrijohet dhe modifikohet. Ajo kalon nga brezi në brez dhe mund të shkatërrohet nëse vlera e saj kulturore dhe historike nuk vlerësohet dhe ruhet.

Zhvillimet sociale dhe urbane mbas viteve 90-të, problemet e pronësisë, zhvillimi dhe 0nënvleftësimi i monumenteve të kulturës në këto vite, marrja me to e gjithkujt qoftë edhe pa një formim dhe edukim në këtë fushë, (jo profesionistë), kanë marrë përmasa shqetësuese duke rrezikuar ekzistencën e tyre. Monumentet e kulturës në Republikën e Shqipërisë, të çfarëdo lloji, natyre dhe kulture, mjedisi social dhe natyror, përkatësie të të njëjtit civilizim klasik mesdhetar, varësie, menaxhimi, madhësie apo pozicioni gjeografik ku ndodhen, kanë qenë dhe do të mbeten një faktor i rëndësishëm i zhvillimit historik, kulturor dhe social ekonomik në vendin tonë. Këto asete krijojnë mundësinë e nxitjes dhe aktivizimit të të mirave materiale dhe shërbimeve, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës, veçanërisht të komuniteteve përreth, të cilët e kanë kuptuar se jeta e tyre është e lidhur ngushtë me kontekstin në të cilin jetojnë dhe punojnë. Ky kontekst përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor dhe shërben si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetesës.

Meqenëse trashëgimia kulturore materiale është një prej burimeve më të rëndësishme kombëtare në vend, i cili nuk ripërtërihet, duhen bërë disa përpjekje të veçanta për të rivendosur ekuilibrin ndërmjet nevojave tona dhe mbrojtjes së këtij burimi.

Monumentet e kulturës zënë një vend të veçantë në spektrin e 0destinacioneve ekoturistike, të cilat janë tashmë të njohura në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Në ditët e sotme, koncepti i monumenteve të kulturës po ndryshon drejt një prespektive të re që synon jo vetëm mbrojtjen e tyre, por dhe domosdoshmërinë për rritjen ekonomike dhe mirëqenien e popullsisë drejt standardeve evropiane. por edhe në zhvillimin ekonomik si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë.

Përballja me çështje kontradiktore lidhur me, zotërimin e certifikatës së pronësisë, mos - inventarizimin, mos regjistrimin, ndryshimet globale, ruajtjen e asaj që ekziston e cila është e njohur dhe asaj çka është akoma për t'u zbuluar dhe nevojës për ta shfrytëzuar këtë burim për përfitime socio - ekonomike të komuniteteve lokale, aksesueshmërinë për publikun, financimin, zhvillimet urbane të paplanifikuara, të cilat janë në qendër të politikave të që merren me monumentet e kulturës, kanë bërë që menaxhimi i tyre nga institucione shtetërore përkatëse të ketë mangësi të cilat shfaqen dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve dhe, në kushtet aktuale nuk mund të sigurojnë dhe garantojnë ruajtjen, duke rrezikuar dhe ekzistencën e tyre.

Mbrojtja dhe administrimi i monumenteve të kulturës rregullohet nga ligji nr. 27/2018 për 0trashëgiminë kulturore dhe muzetë dhe disa akte nënligjore në zbatim të tij. Në këtë fushë janë ndërmarrë reforma të ndryshme të cilat kanë sjellë ndryshimin e strukturave drejtuese dhe

menaxhuese të ministrisë së linjës dhe institucioneve të varësisë përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës si edhe ndryshime në statuset e tyre. Duhet të theksojmë se mungesa e akteve nënligjore për menaxhimin e monumenteve të kulturës, mungesa e planeve të menaxhimit të tyre, mungesa e bashkëpunimit me pushtetin vendor, ministritë e tjera që janë faktorë në këtë proces, centralizimi i kompetencave si edhe shumë problematika të tjera të shfaqura në vazhdimësi, kanë vënë në rrezik gjithnjë e më shumë ruajtjen dhe administrimin e tyre.

Menaxhimi i monumenteve të kulturës duhet të synojë vendosjen e ekuilibrave midis përdorimit dhe ruajtjes së tyre. Kjo kërkon njohjen, mbrojtjen, regjistrimin, menaxhimin dhe vlerësimin e tyre. Nëse institucionet shtetërore me politikat e tyre nuk janë në gjendje të njohin dinamikën e zhvillimit dhe sfidat themelore, menaxhimi i monumenteve të kulturës është i pamundur. Kjo gjë tregon rëndësinë e menaxhimit, të përdorimit nga vizitorët dhe vendimmarrjen e integruar, në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara dhe të parapërcaktuara në objektivat strategjike të Ministrisë së Kulturës, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe institucioneve të tjera të varësisë. Nevojitet angazhimi i të gjithë grupeve të interesit të cilat duhet të jenë proaktive në përcaktimin e interesave të përbashkëta dhe hartimin e strategjive afatgjata me plane veprimi konkrete me përgjegjësinë për të punuar bashkërisht drejt arritjes së qëllimit të përbashkët. Strategji të tilla do të kenë një impakt kulturor, social dhe ekonomik në të gjithë vendin, veçanërisht në komunitetin përreth, që nga ndërgjegjësimi i tyre nëpërmjet trajnimeve, edukimit, punësimit, përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe logjistike, zhvillimit të ekosistemeve përreth zonës dhe ngritjen e cilësisë së jetës dhe përfitimeve të komuniteteve lokale dhe vendeve pritëse. Këto strategji do të rrisin dhe performancën e institucioneve përgjegjëse.

Gjykuar në sa më sipër, për shkak të vlerave që mbart menaxhimi i monumenteve të kulturës, problemi social në fokus është ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i tyre, si domosdoshmëri për zhvillimin e kulturës, ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies kombëtare, duke marrë parasysh shqetësimin e opinionit publik të shprehur së fundmi në media dhe forume të ndryshme, lidhur me dëmet që po i shkaktohen kësaj pasurie kulturore, e konsideruam të rëndësishëm kryerjen e auditimit, duke u fokusuar më konkretisht. Mos realizimi në mënyrë efektive i funksioneve parësore të subjekteve nën auditim, përbën një dëm të konsiderueshëm në aspektin kulturor, social, por edhe ekonomik në vend.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjekte të këtij auditimi janë institucionet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e monumenteve të kulturës, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin me sukses të procesit.

Subjektet nën auditim janë:

1. Ministria e Kulturës.
2. Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.
3. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.
4. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.
5. Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

Ministria e Kulturës, është ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e pasurive kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara të fushës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera shtetërore dhe privatët, në bazë të marrëveshjeve apo formave të bashkëpunimit, të

parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Struktura organizative e MK përmban tre drejtori të përgjithshme:

- χ Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, që ka në varësi óDrejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturoró, óDrejtorinë e Zhvillimit të Programeve të Kulturësó, óDrejtorinë e Konceptimit dhe Fizibitetit të Projekteveó.
- χ Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse.
- χ Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë për Kulturën.

Nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, si dhe institucioneve në varësi, Ministria e Kulturës është administratori shtetëror më i rëndësishëm i Trashëgimisë Kulturore. Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore, Ministria e Kulturës harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore materiale, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e administrimin e saj.

Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, (në vijim IKMTK-ja), është institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, krijuar me VKM nr. 364/2019¹, struktura e të cilit është miratuar me Urdhrin nr. 137/2019² të Kryeministrit të Shqipërisë ka në varësi dy drejtori: óDrejtorinë e Monumenteve të Kulturësó dhe óDrejtorinë e Shërbimeve Arkeologjikeó. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, krijuar me VKM nr. 432, datë 26.6.2019 óPër funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturoreó, është institucion kombëtar i specializuar i trashëgimisë kulturore në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. IKRTK-ja ka për mision krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Pasurive Kulturore, në formë elektronike dhe të shkruar. IKRTK-ja, në funksion të përmbushjes së misionit të vet, bashkëpunon me institucionet e shtetit shqiptar, organet e policisë, institucionet doganore si dhe institucionet ndërkombëtare në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore. IKRTK-ja ka për detyrë regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin, promovimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare. IKRTK-ja monitoron dhe koordinon punën me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore. IKRTK-ja u ofron shërbime organeve të administratës shtetërore qendrore, pushtetit vendor, institucioneve shkencore, kulturore apo fetare, personave fizikë dhe juridikë privatë për evidentimin, regjistrimin dhe katalogimin e pasurive kulturore.

Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK), miratuar me VKM nr. 581, datë 28.08.2019³ óPër funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale


¹ VKM nr. 364, datë 29.05.2019 óPër funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturoreó.

² Urdhëri nr. 137, datë 21.10.2019 óPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturoreó, i Kryeministrit të Shqipërisë.

³ VKM nr. 581, datë 28.08.2019 óPër funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturoreó.

të Trashëgimisë Kulturore. Struktura e Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) është miratuar me Urdhrin nr. 139/2019⁴ të Kryeministrit të Shqipërisë për miratimin e strukturës dhe organikës së DRTK. Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore, janë institucione rajonale të specializuara, tekniko-administrative, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. DRTK-të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ato administrojnë. DRTK-të, për të kryer funksionet e tyre, monitorohen dhe koordinohen nga IKTK-ja, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-ve. Ato bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën me institucionet e vetëqeverisjes vendore, personat fizikë ose juridikë, publikë dhe privatë, shqiptarë apo të huaj në fushën e trashëgimisë kulturore.

Skema 1: Institucionet në auditim



2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjen

Subjektet në auditim e bazojnë aktivitetin e tyre për menaxhimin dhe zbatimin e politikave për ruajtjen e monumenteve të kulturës në Ligjin nr. 27/2018 për trashëgiminë kulturore dhe muzetë në Republikën e Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij, etj. Këto ligje dhe akte nënligjore e administrative, kanë për qëllim ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e pasurive kulturore, për të rritur ndikim e tyre në zhvillimet social-ekonomike dhe shoqërore të vendit. Listojmë një pjesë të këtyre akteve:

- χ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- χ Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 - 2025;
- χ Ligj Nr.9048, datë 07.04.2003 për trashëgiminë kulturore i ndryshuar me ligjin 9592 datë 27.07.2006, ligjin 9882 datë 28.02.2008, ligjin 10137 datë 11.05.2009 dhe ligjin 77/2013.
- χ Ligji nr. 27/2018 për trashëgiminë kulturore dhe muzetë

⁴ Urdhri nr. 139, dt. 21.10.2019 për miratimin e strukturës dhe organikës së DRTK i Kryeministrit të Shqipërisë.

- χ Ligj Nr.9806, datë 17.9.2007 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane "Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike" (të rishikuar)
- χ Ligji nr. 81/2017 òPër zonat e mbrojturaò;
- χ VKM nr. 581, datë 28.08.2019 òPër funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturoreò;
- χ Urdhri nr. 139, dt. 21.10.2019 òPër miratimin e strukturës dhe organikës së DRTKò i Kryeministrit të Shqipërisë.
- χ Auditime të SAI-ve të vendeve më të zhvilluara në fushën e Trashëgimisë Kulturore.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.

Menaxhimi i monumenteve është i lidhur me zhvillimin e ekonomik, social kulturor të shoqërisë, vlerat dhe kërkesat e saj për integrimin drejt BE. Ruajtja, rijetëzimi, mbrojtja, administrimi dhe vlerësimi i tyre përbën thelbin e identitetit kulturor dhe shërben si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetesës. Ministria e Kulturës është institucioni përgjegjës, për realizimin e programit politik të qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore, menaxhimit të monumenteve të kulturës dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në programin e Qeverisë në fushën e trashëgimisë kulturore ajo harton strategjinë kombëtare të kulturës, harton planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore, ndjek zbatimin e kontratave të rijetëzimit, ushtron veprimtarinë e saj bazuar në legjislacionin përkatës për trashëgiminë kulturore, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore materiale si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e saj.

Me miratimin e Ligjit 27/2018 organe kolegjiale vendimmarrëse pranë ministrit të kulturës janë: KKTKM dhe KKMPK.

- χ KKTKM-ja miratuar me VKM nr. 208, datë 10.04.2019⁵, licencon subjektet, personat fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim, vlerësim, të aktiviteteve arkeologjike, të arkeologjisë së shpëtimit, miraton projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim, miraton lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, miraton në parim shpalljen e parqeve dhe zonave arkeologjike, etj.
- χ KKMPK-ja miratuar me Urdhrin nr. 535, datë 24.09.2019⁶, miraton strategjinë për administrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore, miraton programin e zhvillimit në territor të trashëgimisë kulturore, konsulton ministrin për trashëgiminë kulturore për tipologjinë e aktiviteteve tregtare që zhvillohen në ambientet e pasurive kulturore dhe në zonat e mbrojtura, miraton kriteret për licencimin e subjekteve tregtare të dedikuara në fushën e promovimit e të prezantimit të vlerave kulturore, etj.

Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, misionin e saj Ministria e Kulturës e realizon në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qendrore publike që merren me menaxhimin e monumenteve të kulturës .

⁵ VKM nr. 208, datë 10.04.2019 për òPërbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të këshillit Kombëtar të trashëgimisë Kulturore Materialeò.

⁶ Urdhri nr. 535, datë 24.09.2019 òPër caktimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturoreò.


Trashëgimia Kulturore është dëshmi e qytetërimeve të së kaluarës. Në këto kushte vetëm nëse mbrohet nga shteti dhe institucionet e tjera publike dhe private, trashëgimia kulturore do të ruhet në shekuj dhe do të vihet në shërbim të zhvillimit të shoqërisë dhe edukimit të brezit të ri me ndjenja kombëtare.

IKTK është krijuar me VKM nr. 364/2019⁷, struktura dhe organika e të cilit është miratuar me Urdhrin nr. 137, datë 21.10.2019⁸ të Kryeministrit të Shqipërisë, ka në varësi dy drejtori: “Drejtorinë e Monumenteve të Kulturës” dhe “Drejtorinë e Shërbimeve Arkeologjike”. IKTK, i cili është institucion kombëtar i specializuar shkencor, ka vlera si në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, ashtu edhe në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, në shërbim të planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

IKTK-ja është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Kulturës, financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Misioni i tij është gjurmimi, hulumtimi, studimi, projektimi, konservimi, restaurimi, mbikëqyrja, kolaudimi, promovimi, publikimi i trashëgimisë kulturore materiale, arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimi i trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë. IKTK-ja harton kriteret e hulumtimeve arkeologjike, shqyrton dokumentacionin teknik në lidhje me to, si dhe kryen mbikëqyrjen e proceseve arkeologjike dhe ecurisë së projekteve zhvillimore, në varësi të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegjiale.

IKTK-ja, harton, përditëson dhe publikon platformën digjitale për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë si edhe bashkërendon punën me DRTK, NJAKPA, NJVQV, subjektet publike dhe private, vendase apo të huaja, në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

Skema 2: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore



DRTK (ish - DRKK), miratuar me Urdhrin nr. 139/2019⁹ të Kryeministrit të Shqipërisë, janë institucione rajonale të specializuara, tekniko - administrative buxhetore, në varësi të ministrit përgjegjës për Trashëgiminë Kulturore. DRTK-të kanë për mision, gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që administrojnë, financohen nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme dhe monitorohen dhe koordinohen nga IKTK-ja, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-ve.

⁷ VKM nr. 364, datë 29.5.2019 për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

⁸ Urdhri nr. 137, datë 21.10.2019 për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

⁹ Urdhri nr. 139/2019 për miratimin e strukturës dhe organikës së DRTK.

2.4 Pësja në buxhet

Në territorin e Shqipërisë aktualisht ekzistojnë rreth 2159 monumente kulture dhe 174 zona të mbrojtura të tyre. Këto monumente kulture janë kryesisht të kategorizuara me emërtimin e monumentit, kategorinë (monument kulture i kategorisë së I në numër 1227 dhe të II në numër 932 në numër), adresën e vendndodhjes së objektit (*bashkia, qarku*), të dhënat e shpalljes monument, numri i objektit, si dhe zona të mbrojtura me emërtim të specifikuar sa më poshtë;

a. *Ndërtesa, godina banesa familjare.*

b. *Ndërtesa, kulte fetare të evidentuara (Xhami, Kisha, Teqe, Tyrbe, Ikona, etj).*

c. *Ndërtesa të ndryshme sociale.*

d. *Ndërtime të evidentuara (Kala, Fortesë, Urë, Shpellë, Varrezë, etj).*

Në zbatim të ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 *óPër trashëgiminë kulturore dhe Muzetë*, VKM nr. 581, datë 28.08.2019 *óPër funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore*, si dhe VKM nr. 139, datë 21.10.2019 *óPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore*, DRTK^{të} kanë detyrimin ligjor të administrojnë dhe monitorojnë monumentet e kulturës të pasqyruara sa më poshtë:

Tabela nr. 1

Nr	Institucionet	Objekte të trashëgimisë së kulturës			Zona të Mbrojtura
		Totali	Kat.(I)	Kat.(II)	
1	DRTK Tiranë	378	167	211	32
2	DRTK Shkodër	230	212	18	27
3	DRTK Vlorë	218	218	0	40
4	DRTK Korçë	304	286	18	47
5	DRTK Berat	479	123	356	5
6	DRTK Gjirokastrë	550	221	329	23
	Totali objekte të trashëgimisë	2 159	1 227	932	174

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga faqe zyrtare e Ministrisë së Kulturës, ITKT dhe DRTK

Për periudhën objekt auditimi (2019, 2020, 2021) në objektet e aksesuara për vizitorët të administruara nga 4 DRTK janë evidentuar dhe realizuar të ardhura sa më poshtë;

Tabela nr. 2

Nr	Institucioni	Objekti vizituar	2019	2020	2021
1	DRTK Tiranë		0	0	0
2	DRTK Shkodër	Kalaja e Rozafës	13.695.700	4.447.440	10.910.400

3	DRTK Vlorë	Kalaja (Palermo, Himarë, Kaninë, Finiq)	4.942.900	1.237.100	4.200.800
4	DRTK Korçë		0	0	0
5	DRTK Berat	Kalaja e Beratit	10.964.430	5.116.300	18.548.860
6	DRTK Gjirokastrë	Kalaja e Gjirokastrës dhe Parku Antigone	17.977.146	5.768.890	15.656.020
		TOTALI	45.580.176	16.569.730	49.316.080

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin e buxhetit faktik në DRTK.

Të dhënat në tabelë evidentojnë se nga 2159 objekte të trashëgimisë së kulturës, vetëm nga 8 prej tyre janë realizuar të ardhura nga shitja e biletave për visitor vendas dhe të huaj, ku për secilën periudhë raportuese të ardhurat nga shitja e biletave janë në vitin 2019 shuma *45.580.176 lekë*, në vitin 2020 shuma *16.569.730 lekë* dhe në vitin 2021 shuma *49.316.080 lekë*.

Për periudhën objekt auditimi subjektet e përfshira në këtë auditim kanë realizuar misionin e monitorimit, ruajtjes, vlerësimit, mbrojtjes, administrimit dhe mirmbajtjes rutinë të objekteve si njësi shpenzuese sipas buxheteve përkatëse të miratuar për llogaritë ekonomike (600, 601, 602, 231). Gjendja e treguesve faktik të buxhetit paraqiten sa më poshtë.

Tabela nr. 3 Periudha raportuese ushtrimore viti 2019 pasqyrohet me këta tregues.

Në 000/lekë

Nr	Institucioni	Treguesit faktik buxhetor të shpenzimeve				Struktura organike			
		Llog.(600)	Llog.(601)	Llog.(602)	Llog.(231)	Specialist	Mirëmbajtës	Sezonal	Totali
1	IKRTK (QKIPK)	4.978	813	2.363	0	8	0	0	8
2	IKTK (IMK)	31.929	5.324	10.314	29.217	55	0	0	55
3	DRTK Tiranë	Sëka	Sëka	Sëka	0	12	8	2	22
4	DRTK Shkodër	14.771	2.472	6.768	0	12	9	2	23
5	DRTK Vlorë	19.726	3.304	7.990	0	19	17	2	38
6	DRTK Korçë	12.768	2.136	5.635	0	16	10	1	27
7	DRTK Berat	13.665	2.281	7.791	0	24	14	3	41
8	DRTK Gjirokastrë	17.112	2.850	13.660	0	16	14	4	34
	Totali	114.949	19.180	54.521	29.217	162	72	14	248
9	M. Kulturës	890.932	0	486.103	751.665				

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin e buxhetit faktik në DRTK.

Pas riorganizimit dhe funksionimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, si edhe të DRTK për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 të dhënat e treguesve faktik të buxhetit pasqyrohen sa më poshtë;

Tabela nr. 4

Në 000/lekë

Nr	Institucioni	Treguesit faktik buxhetor të shpenzimeve				Struktura organike			
		Llog.(600)	Llog.(601)	Llog.(602)	Llog.(231)	Specialist	Mirëmbajtës	Sezonal	Totali
1	IKRTK	5.936	987	973	0	8	0	0	8
2	IKTK	42.226	7.006	14.247	13.117	55	0	0	55
3	DRTK Tiranë	11.732	1.959	4.170	0	12	8	2	22
4	DRTK Shkodër	13.290	2.237	6.235	0	12	9	2	23
5	DRTK Vlorë	21.363	3.654	9.991	2.000	19	17	2	38
6	DRTK Korçë	15.392	2.571	4.194	0	16	10	1	27
7	DRTK Berat	13.628	2.276	5.363	0	24	14	3	41
8	DRTK Gjirokastrë	16.684	2.788	9.842	0	16	14	4	34
	Totali	134.315	22.491	54.042	15.117	162	72	14	248
9	M. Kulturës	893.531	0	454.045	800.228				

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin e buxhetit faktik në DRTK.

Tabela nr. 5 Periudha raportuese ushtrimore viti 2021, pasqyrohet me këta tregues.

Në 000/lekë

Nr	Institucioni	Treguesit faktik buxhetor të shpenzimeve				Struktura organike			
		Llog.(600)	Llog.(601)	Llog.(602)	Llog.(231)	Specialist	Mirëmbajtës	Sezonal	Totali
1	IKRTK	5.680	934	1.659	0	8	0	0	8
2	IKTK	43.138	7.228	15.375	4.982	55			55
3	DRTK Tiranë	11.449	1.917	6.395	0	12	8	2	22
4	DRTK Shkodër	13.251	2.236	3.528	0	12	9	2	23
5	DRTK Vlorë	21.071	3.546	8.209	3.744	19	17	2	38
6	DRTK Korçë	15.422	2.571	3.570	1.144	16	10	1	27

7	DRTK Berat	13.784	2.335	8.071	0	24	14	3	41
8	DRTK Gjrokastër	17.929	3.015	9.485	0	16	14	4	34
	Totali	141.724	23.782	56.292	9.870	162	72	14	248
9	M. Kulturës	910.877	0	426.725	493.463				

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin e buxhetit faktik në DRTK.

Të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme evidentojnë treguesit faktik të realizuar për shpenzimet e kryera në periudhat raportuese ushtrimore nga secila DRTK, nga Ministria e Kulturës, nga IKTK dhe IKRTK, si institucione të cilat kanë si qëllim kryesor monitorimin, evidentimin, ruajtjen, vlerësimin, mbrojtjen dhe administrimin e gjendjes teknike të objekteve monumente të trashëgimisë së kulturës dhe të kryejnë investime për restaurimin, rehabilitimin, rikonstruksionin e mirëmbajtjen rutinë.

Duke iu referuar hartës së riskut dhe monitorimit të vazhdueshëm i kryer nga DRTK^{-të} për gjendjen teknike të çdo objekti të trashëgimisë së kulturës të administruar në juridiksion të DRTK^{-ve}, njëkohësisht bazuar në treguesit buxhetor të programuar me kërkesat nëpërmjet PBA periudha (2019 - 2021), si dhe në nivelin e treguesve buxhetor të miratuar nga MK, apo në treguesit faktik të buxheti të realizuar nga njësia shpenzuese DRTK^{-ja}, gjendja e zërit shpenzime për *Investime* të administruar në llog.(231) me analizë të hollësishme të kërkuara, të miratuara dhe të realizuara për secilën DRTK si njësi shpenzuese, gjendja e investimeve pasqyrohet sa më poshtë;

Tabela nr. 6

në 000/lekë

Nr	Institucio n	2019			2020			2021		
		<i>Të kërkuar a në PBA</i>	<i>Miratuar me buxhet dhe te realizuar</i>	<i>Gjendja e evidentuar në bilanc</i>	<i>Të kërkuara në PBA</i>	<i>Miratuar me buxhet dhe te realizuar</i>	<i>Gjendja e evidentuar në bilanc</i>	<i>Të kërkuara në PBA</i>	<i>Miratuar me buxhet e te realizuar</i>	<i>Gjendja evidentuar në bilanc</i>
1	IKRTK	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	ITKT	0	29.217	228.318	0	13.117	241.435	617.448	4.982	
3	DRTK BR	0	0	75.829	0	0	75.829	0	0	
4	DRTK SH	3.600	0	209.451	3.600	0	209.451	3.600	0	
5	DRTK TR	0	0	0	0	0	0	0	3.744	
6	DRTK KO	93.058	0	0	70.946	0	0	24.950	1.144	0
7	DRTK GJ	0	0	0	0	0	0	0	0	

8	DRTK VL	61.894	0	27.527	62.900	2.000	36.419	169.329	3.744	
	Totali	158.552	29.217	551.125	137.446	15.117	563.134	815.327	9.870	

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e PBA, të buxhetit dhe Pasqyrat financiare në DRTK.

Nga të dhënat në tabelë konstatohet se nga DRTK^{-të} janë kërkuar fonde në investime për restaurime, rehabilitime e rikonstruksione në objekte të trashëgimisë kulturore si më poshtë:

- në vitin 2019 vlera 158.552 mijë lekë;
- në vitin 2020 vlera 137.446 mijë lekë;
- në vitin 2021 vlera 815.327 mijë lekë.

Ndonëse nga DRTK^{-të} janë bërë kërkesa të vazhdueshme për investime dhe të shoqëruara me projekte e preventiva paraprak, nga Ministria e Kulturës në programet buxhetore janë miratuar e alokuar fonde për investime në total vlera prej **6.888 mijë lekë** ku;

- për vitin 2019, vlera 0 (zero) lekë;
- për vitin 2020, vlera 2.000 mijë lekë në DRTK Vlorë;
- për vitin 2021, vlera 4.888 mijë lekë, në DRTK Korçë vlera 1.144 mijë dhe në DRTK Vlorë vlera 3.744 mijë lekë.

Ministria e Kulturës, në cilësinë e institucionit epror, ka realizuar investime në vlerën 46.704.702 lekë, ndonëse në këto objekte në të cilat ka investuar MK, DRTK ñ të nuk kanë bërë kërkesa për investim, ndërkohë këto objekte nuk i kanë konsideruar prioritare me vlerën e investuar sa më poshtë:

<i>Nr</i>	<i>Institucioni</i>	<i>Objekti i investuar</i>	<i>Vlera e investimit</i>	<i>Periudha investuar</i>	<i>Investitori</i>
1	DRTK Tiranë	- Projekti Elektrik për ndriçimin e jashtëm Kalaja e Krujës	15.439.576	2020	M.Kulturës
2		- Restaurimi i çatisë banesa e Sali Shijakut (Faza emergjencës) Objekt privat.	1.266.210	2020	M.Kulturës
3	DRTK Gjirokastrë	- Restaurim Kisha Shën Ilias Stegopull	7.759.380	2020	IKTK
4		- Projekti Elektrik për ndriçimin e jashtëm Kalaja e Gjirokastrës	22.239.536	2020	M.Kulturës
		Totali i investuar nga Ministria e Kulturës	46.704.702		

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e PBA, të buxhetit dhe Pasqyrat financiare në DRTK.

2.5 Feedback-u i subjekteve gjatë gjithë auditimit

Gjatë gjithë auditimit subjektet e përfshira në auditim, Ministria e Kulturës, IKTK, IKRTK dhe DRTK Rajonale Shkodër, Tiranë, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë i janë përgjigjur në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, si dhe intervistave me kërkesat për dokumentacion.

Është plotësuar informacioni i kërkuar, kryesisht me dokumentacionin që lidhet me ligjin dhe aktet nënligjore, strategjitë, strukturën, përshkrimet e punës, buxhetin, raportet e aktivitetit, statistikën, megjithëse këto të fundit të kufizuara në raport me atë që ka kërkuar grupi i auditimit. Takimet konsultuese dhe intervistat e zhvilluara me stafet respektive, si dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, shërbeu për njohjen e aktivitetit specifik të çdo institucioni, identifikimin e risqeve potenciale, si dhe në përcaktimin e fokusit të auditimit. Grupi i auditimit arriti në përfundimin se stafet përkatëse treguan gatishmëri në vënien në dispozicion të mjeteve të punës dhe informacionit të kërkuar.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve

Risqet e aktivitetit të subjekteve janë ato risqe me të cilat përballen institucionet e audituara për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi që lindin nga aktiviteti i tyre në drejtim të mirëmenaxhimit të monumenteve të kulturës në vendin tonë. Risqet e aktivitetit të subjekteve janë analizuar dhe evidentuar të klasifikuara sipas analizës SWOT: fuqitë, dobësitë, shanset, kërcënimet, detajuar në faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Ato paraqiten si më poshtë:

Tabela 7 – Analiza SWOT

	Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
Faktorë të brendshëm	Kuadri ligjor. Pasuri me vlera kombëtare dhe ndërkombëtare, risi për ekoturizmin dhe kulturën kombëtare. Pozicioni gjeografik dhe klimaterik i Shqipërisë dhe prania e disa prej tyre në zona urbane. Interesi në rritje për trashëgiminë kulturore. Ekzistenca e nismave private dhe bizneseve lokale, që përfshijnë akomodimin, restorante, bare, ture dhe guidat për MK. Ekzistenca e strukturave drejtuese dhe menaxhuese në nivel qendror dhe vendor.	Moszbatimi i strategjisë kombëtare dhe i planeve të veprimit 2019 - 2025, kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit për TK. Mbivendosje kompetencash dhe komunikimi ndër-institucional jofunksional, për trashëgiminë kulturore, midis institucioneve publike. Mungesa e planeve të menaxhimit. Financimi nga buxheti i shtetit i pamjaftueshëm në të gjitha nivelet. Mungesa e infrastrukturës rrugore dhe logjistike. Reforma të shpeshta strukturore të pabazuara në meritokraci dhe profesionalizëm.
	Shanset (O)	Kërcënimet (T)
Faktorë të jashtëm	Praktikat më të mira rajonale. Njohja nga qeveria e rëndësisë së TK. Prania e institucioneve donatore që operojnë në shkallë kombëtare dhe rajonale në kulturë dhe turizëm. Përfshirja e grupeve të interesit në hartimin e politikave. Statusi i vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Iniciativa të reja të propozuara nga sektori privat duke përfshirë dhe qeverinë për zhvillime strategjike me	Gjendja óKatastrofikeóe shumë prej MK në vendin tonë. Mungesa e Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e TK. Regjistër kombëtar i TK i pa përditësuar dhe mungesa e inventarizimit të MK. Problematikat e pronësisë së MK. Decentralizim dhe burokracitë e shfaqura në menaxhimin e MK dhe disiplinës urbane. Politika konkurruese dhe kërcënuese në rajon, si edhe rënia e nivelit të turizmit. Ekonomia e vendit dhe ajo rajonale.

	qëndrueshmëri financiare afatgjatë dhe efektive. Ndryshimi i konceptit të MK, jo vetëm në aspektet mbrojtëse, por si faktor zhvillimi ekonomik dhe social.	Fatkeqësitë natyrore dhe pandemitë botërore.
--	--	--

Përpunoi: Grupi i auditimit, KLSH

Në vijim, grupi i auditimit ka bërë një ndarje intuitive të risqeve të veprimtarisë duke i kategorizuar ata në strategjikë, financiarë, juridikë dhe operacional.

Tabela nr. 8

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Politikat e MK për monumentet e kulturës	Risk Strategjik	I Lartë
2	Reformat strukturore të Institucioneve (DRTK, IKTk dhe IKRTK)		I Lartë
3	Kuadri Strategjik aktual		I Lartë
4	Investimet	Risk Financiar	I Lartë
5	Forma e financimit		I Lartë
6	Sistemet e monitorimit dhe raportimit	Risk Rregullator dhe Juridik	I Lartë
7	Kuadri Ligjor		I Lartë
8	Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit	Risk Operacional	I Mesëm
9	Staf i pakualifikuar dhe i pamjaftueshëm		I Mesëm
11	Risqet procedurale		I Mesëm
12	Risqet e dokumentacionit		I Ulët

3.2 Objektivat e auditimit

Ky auditim ka si objektiv vlerësimin e efektivitetin të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen dhe administrimin e monumenteve të kulturës në vendin tonë në përfitim të promovimit të vlerave kulturore kombëtare të këtyre monumenteve, për periudhën 2019 - 2021.

3.3 Pyetjet e auditimit

Pyetja Kryesore:

A kanë rezultuar efektive masat e marra për menaxhimin e monumenteve të kulturës për periudhën 2019 - 2021?

Nënpyetja e parë e nivelit të parë:

1. A është i plotë kuadri rregullator për menaxhimin e monumenteve të kulturës?

Nënpyetja e nivelit të dytë:

1.2 A janë hartuar aktet rregullatore në funksion të mirëmenaxhimit të monumenteve të kulturës?

Nënpyetja e dytë e nivelit të parë:

2. A ka rezultuar i përshtatshëm funksionimi dhe koordinimi i institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës?

Nënpyetjet e nivelit të dytë:

2.1. A janë ngritur dhe funksionojnë institucionet përgjegjëse për mirëmenaxhimin e monumenteve të kulturës?

2.2. A ka gjeneruar veprimtaria e këtyre institucioneve përmirësim të proceseve të mirëadministrimit të monumenteve të kulturës?

Nënpyetja e tretë e nivelit të parë: 3. A është garantuar financim buxhetor i duhur për menaxhimin e monumenteve të kulturës?

Nënpyetjet e nivelit të dytë:

3.1 A ka rezultuar i mjaftueshëm financimi buxhetor në drejtim të mirëadministrimit të monumenteve të kulturës?

3.2 A ka sjellë financimi buxhetor impaktin e duhur në mirëadministrimin e monumenteve të kulturës?

3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka në fokus mbrojtjen dhe Administrimin e Monumenteve të Kulturës¹⁰, si objekte të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme¹⁰ të vendit tonë e cila duhet, ruajtur, rritet, rehabilituar apo ristrukturuar me qëllim promovimin e vlerave kulturore të vendit tonë. Fokusi i këtij auditimi konkretisht do të jetë i orientuar kundrejt efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi në nivel të qeverisjes qendrore si dhe institucioneve të tyre të varësisë në nivel vendor.

Për këtë arsye në trajtimin e kësaj tematike grupi i auditimit ka përfshirë si subjekte auditimi Ministrinë e Kulturës në cilësinë e institucionit epror politik bërës, Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, Tiranë, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë. Periudha e auditimit e përzgjedhur për trajtimin e kësaj teme përfshin vitet 2019 në 2021, pa përjashtuar këtu edhe përfshirjen e periudhave kohore të mëparshme që mund të shpjegojnë çështje, fenomene dhe dukuri të cilat reflektohen në gjendjen aktuale të monumenteve të kulturës.

Grupi i auditimit për të realizuar këtë mision auditimi ka përdorur si qasjen më të përshtatshme, bazuar edhe në të dhënat e grumbulluara gjatë fazës studimore, qasjen pragmatike. Nëpërmjet kësaj qasjeje grupi i auditimit ka përdorur të dhëna si sasiore ashtu edhe cilësore, për të kryer një analizë të duhur dhe korrekte të evidencave, duke çuar në rekomandime dobiprurëse për subjektet e përfshira në këtë auditim.

4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

Për pyetjen kryesore, **A kanë rezultuar efektive masat e marra për menaxhimin e monumenteve të kulturës për periudhën 2019 - 2021?**, u arrit në këtë **mesazh auditimi**:

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës nuk e kanë orientuar veprimtarinë e tyre në mënyrë efektive, me qëllimin final, mbrojtjen, mirë - administrimin, inventarizimin dhe vlerësimin e monumenteve në vendin tonë, me rezultatin e vetëm¹¹ që **122** monumente nuk ekzistojnë, **122** monumente janë plotësisht të shkatërruara, **884** monumente në gjendje të pranueshme por që kanë nevojë për restaurim, **745** objekte në gjendje të mirë dhe në nevojë për një mirëmbajtje të vazhdueshme, **98** objekte të tjetërsuar si dhe **15** objekte pa kartelë. Kjo situatë është shkaktuar edhe nga një programim ineffektiv i burimeve njerëzore dhe financiare në territor, sidomos sa i takon institucioneve të specializuara të ngarkuara me

¹⁰ Pasuri Kulturore materiale e paluajtshme quhet

¹¹ Të dhëna zyrtare të përpunuara nga IKTK për qëllimin e këtij auditimi.

mbrojtjen dhe administrimin e këtyre monumenteve. Nga ana tjetër, Ministria e Kulturës, si institucion politikëbërës nuk është angazhuar maksimalisht në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore, duke lënë sistemin kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore *pa Inspektoriat*, çka do të thotë, pa patur në dorë mundësinë e ndëshkimit ndaj atyre që abuzojnë, shkatërrojnë apo tjetërsojnë monumentet e kulturës. Ministria e Kulturës në të ardhmen duhet të angazhohet në bashkëpunim me institucionet e varësisë, por edhe me institucionet e tjera për të hartuar dokumentet dhe propozuar miratimin e procedurave të domosdoshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme në vendin tonë, për të sjellë një përmirësim konkret në gjendjen e tyre aktuale.

4.1 A është i plotë kuadri rregullator për menaxhimin e monumenteve të kulturës?

4.1.1 A janë hartuar aktet rregullatore në funksion të mirëmenaxhimit të monumenteve të kulturës?

Kuadri strategjik institucional mbi të cilin ushtron aktivitetin Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të varësisë mbështetet në vizionin për artet dhe trashëgiminë kulturore të Shqipërisë, si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit me mision krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat.

Për realizimin e këtij misioni është miratuar ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë¹² dhe Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 - 2025¹³, si edhe disa akte nënligjore në zbatim të tyre.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, (SKZHI) 2015 - 2020, janë shprehur drejtimet kryesore të politikës shtetërore në lidhje me Trashëgiminë Kulturore Materiale, ku Ministria e Kulturës dhe institucionet e specializuara janë përgjegjësit kryesor për hartimin e politikave, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e realizimit të tyre.

Qeveria Shqiptare e cila ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin e objektivave të zhvillimit të vendit për pesëvjeçarin e ardhshëm, nuk ka hartuar SKZHI për periudhën 2020 - 2025. Mungesa e SKZHI 2020 - 2025 sjell mungesën e orientimit të politikave shtetërore të hartuara në nivel makro, mungesën e objektivave prioritarë kombëtarë të zhvillimit të vendit nga të gjitha institucionet qendrore dhe vendore.

Në zbatim të SKZHI - së 2015 - 2020 është hartuar dhe miratuar Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 - 2025, me objektiva të njëjta me ato të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015 - 2020¹⁴, por pa plane veprimi konkrete.

Pikërisht fakti që Strategjia Kombëtare e Ministrisë së Kulturës është miratuar për vitet 2019 - 2025, (derivat i SKZHI - së) dhe objektivat janë të njëjta me ato të SKZHI 2015 - 2020 tregon për një mosrealizim dhe mosefektivitet të disa prej objektivave të tyre.

Bazuar në Urdhrin nr. 220, datë 12.04.2018 óPër ngritjen e grupit të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019 - 2025¹⁵, një nga detyrat e grupit të punës ka qenë hartimi i objektivave strategjike dhe planit të veprimit të realizimit të tij, si edhe raportimi i realizimit.

Gjithashtu bazuar në Urdhrin nr. 624, datë 12.09.2018 óPër ngritjen e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore të Ligjit nr. 27.2018 óPër trashëgiminë kulturore dhe muzetë¹⁶, grupi

¹² Ligji nr. 27/2018 óPër trashëgiminë kulturore dhe muzetë

¹³ VKM nr. 903, datë 24.12.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025.

¹⁴ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020

¹⁵ Raporti i KLSH-së, nr. 646/5 datë 30.04.2021, Vendimi nr.52 datë 26.04.2021 óEfektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016-2019.

i punës ka patur për detyrë miratimin e një kalendari pune duke përcaktuar prioritetin e secilit akt sipas fushës së kompetencës dhe afatin ligjor për nxjerrjen e tyre. Grupi i punës dhe strukturat përgjegjëse, bazuar në këtë urdhër kanë hartuar planin analitik për periudhën 2019 - 2021 me afatin ligjor për nxjerrjen e akteve, por pa përcaktuar prioritetin e secilit akt sipas fushës së kompetencës. Në planin analitik të vënë në dispozicion konstatohen vonesa në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore.

Në hartimin e kuadrit rregullator të trashëgimisë kulturore një rol të rëndësishëm luajnë edhe institucionet e tjera shtetërore qendrore të cilat me harmonizimin e politikave të përbashkëta për trashëgiminë kulturore, ndikojnë në mirëmenaxhimin e tyre. Objektivat strategjike të institucioneve të tjera shtetërore, në disa raste nuk rakordojnë për sa i takon aspekteve të fushës së kompetencës me ato të ministrisë përgjegjëse për Trashëgiminë Kulturore.

Nga intervistat dhe komunikimi me drejtuesit në MK, disa nga arsyet e tjera të vonesave në ecurinë e realizimit të planit analitik për hartimin e akteve, janë si më poshtë vijon:

- Vonesa në kthimin e përgjigjeve dhe dhënien e mendimeve për shkak të volumit të madh të punës që kanë edhe ministrinë e tjera, me të gjithë aparatit shtetëror. Edhe pse nga MK janë hartuar 4 VKM¹⁶ dhe janë dërguar për miratim në KM, ky i fundit, në kundërshtim me nenin 263 të ligjit nr. 27/2018, nuk i ka miratuar akoma.

- Mosrakordime për sa i takon aspekteve të fushës së kompetencës, me Ministrinë e Kulturës apo institucione të tjera ku ndërthuren fushat e kompetencës.

- Bashkërendimi me disa institucione nuk ka qenë gjithmonë i lehtë, pasi ka patur pika të cilat palët i kanë mbrojtur dhe nuk kanë dashur të ndryshojnë qëndrimin e tyre, ose nuk janë shprehur akoma për qëndrimet e tyre. Kjo gjë vihet re dhe me ministrinë e linjës. Konkretisht, në kundërshtim me nenin 265 të Ligjit nr. 27/2018 Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave nuk kanë miratuar 3 udhëzimet e përbashkëta¹⁷.

- Periudha e zgjatur e pandemisë, e cila ka bërë që për njëfarë kohe procesi i koordinimit me strukturat e brendshme, si dhe me institucionet e tjera, të realizohet shumë më ngadalë sesa në kushte normale.

Pikërisht, mungesa e koordinimit të punës brenda institucionit qendror të MK dhe bashkëpunimi i ulët ndërinstitucional, kanë ndikuar në mosmiratimin në kohë të kuadrit rregullator për menaxhimin e monumenteve të kulturës.

Në VKM - në nr. 903, datë 24.12.2019 óPër miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019 - 2025ó dhe relacionin shoqërues, në seksionin që lidhet me zbatimin dhe monitorimin e saj, ky dokument autorizon ngritjen e strukturave/organeve të posaçme, si:

¹⁶Në zbatim të pikës 3, të nenit 11, VKM-në óPër ruajtjen e TK nga rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktet e armatosuraó. Në zbatim të pikës 9, të nenit 29, VKM-në óPër mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe veprimtarisë së óQendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurimó (QRKR). Draft vendimi është në fazë bashkërendimi me ministrinë e linjës, ku Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike janë shprehur kundër në sistemin e-aktet për statusin juridik dhe varësinë institucionale. Më datë 02.12.2021 i është kthyer përgjigje shkresore Ministrisë së Drejtësisë dhe Departamentit të Administratës Publike. VKM nr 771, datë 30.9.2020 óPër deklarimin pasuri kulturore të óQendrës historikeó të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. (Vetëm pejzazhi nuk ka filluar ende për shkak të mungesës së stafit teknik). Në zbatim të shkronjës ócô, të pikës 3, të nenit 171, VKM-ja óPër përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturoreó, në fazë bashkërendimi final me MFE, do të miratohet brenda vitit 2022.

¹⁷ Në zbatim të pikës 10, të nenit 29 óUdhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga IKTK-jaó. Në zbatim të pikës 6, nenit 31, óUdhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga DRTK-tëó. Në zbatim të pikës 7, nenit 32, të këtij ligji óUdhëzimin e përbashkët për mbledhjen e tarifave për shërbimet e ofruara nga IKRTK-jaó.

1. Komiteti Ndërmintor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën, (KNZSKK) 2019 - 2025. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor në Ministrinë e Kulturës, mban rolin e sekretarisë për Komitetin Ndërmintor. Në Komitetin Ndërmintor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën (KNZSKK) 2019 - 2025 përveç përfaqësuesve të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve kulturore të varësisë, si anëtarë të tjerë të Komitetit, në nivel zëvendësministri, janë përfaqësues nga ministrinë e linjës dhe institucionet, veprimtaritë dhe buxheti i të cilave direkt apo indirekt ndikojnë në sektorin e kulturës: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarjes. Masat të cilat ndërlihen me kompetencat e ministrive të tjera të linjës, institucionet vendore dhe të huaja dhe partnerëve të ndryshëm shqyrtohen nga Komiteti Ndërmintor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025. Nga përgjigjet e pyetësorëve na është vënë në dukje se KNZSKK nuk është ngritur dhe nuk funksionon¹⁸.

Në Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025 dhe relacionin shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025", përshkruhen qëllimet e politikës, objektivat specifike përkatëse, masat dhe rezultatet për çdo objektiv, por nuk ka të përcaktuar ndonjë plan veprimi konkret, me institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe realizimin e tyre, referencën për programin buxhetor, afatet e zbatimit, etj.

Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor ka për detyrë ndërmarrjen e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin e planit të veprimit dhe realizimin e masave të parashikuara në dokumentin strategjik, si dhe raportimin periodik të zbatimit të tyre. Çdo dy vite do të përpilohen raportet për vlerësimin e nivelit të zbatimit të dokumentit strategjik, me informacione për indikatorët e përcaktuar, arritjet, problematikat, rreziqet dhe elementet tjera me rëndësi për procesin e zhvillimit të sektorit të kulturës. Bazuar në këto raporte do të rishikohet dhe përditësohet plani ekzistues për vitet në vijim, në frekuencë dy vjeçare. KNZSKK, mblihet çdo dy muaj për të raportuar dhe njoftuar mbi nivelin e zbatimit të masave. Mungesa e KNZSKK ka bërë që të mungojnë dhe raportimet periodike të realizimit të objektivave strategjike, me qëllim vlerësimin e performancës institucionale.

Për sa më lart, duke qenë se i gjithë procesi për hartimin dhe zbatueshmërinë e strategjisë është drejtuar nga grupi i punës ngritur me Urdhrin nr. 220, datë 12.04.2018 për ngritjen e grupit të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025¹⁹, Drejtoria e Politikave, nuk ka njohje për një direktivë të shprehur nga ky organ, apo nga titullarët në hierarki. Drejtoritë, bazuar në plan veprim si dhe PBA-të respektive, paraqesin raportet periodike të realizimit të Plan-Buxheteve respektive për 3 Programet Buxhetore të Ministrisë së Kulturës. Dokumenti i PBA-së paraqet në detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të MK dhe mundëson realizimin afatmesëm, për periudha 4 mujore, 8 mujore dhe vjetore, përkatësisht në nivel programi, por nuk garanton realizimin e objektivave strategjike të Ministrisë së Kulturës.

Në raportet vjetore të vëna në dispozicion nga eprorët e DPPZHK vihen në dukje disa prej problematikave administrativo-juridike të hasura në administrimin e institucioneve, gjatë periudhës objekt auditimi, si:

¹⁸ Përgjigjet e pyetësorëve ardhur nga MK.

¹⁹ Raporti i KLSH-së, nr. 646/5 datë 30.04.2021, Vendimi nr.52 datë 26.04.2021 për efektivitetin e politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016-2019.

- Implementimi i kuadrit të ri ligjor përmes akteve nënligjore ku të marrin zgjidhje çështje të cilat hasin në vështirësi zbatimin nga kuadri aktual;

- mungesa e fondeve për të përballuar një sërë problematikash në sistemin e trashëgimisë kulturore të adresuara sipas fushave;

- mungesa e stafit (rishikimi i strukturave të institucioneve të varësisë) etj.

Për shkak të problematikave të sipërpërmendura, disa nga detyrat funksionale të saj DPPZHK nuk i ka realizuar brenda afateve ligjore të parashikuara²⁰.

Në kushtet e mosfunksionimit të KNZSKK dhe planeve konkrete të veprimit të SKK 2019 - 2025 me indikatorët përkatës, kuptohet që, efektiviteti i politikave për menaxhimin e monumenteve të kulturës nuk është realizuar në masën 100%. Konkretisht:

- Ligji nr. 27/2018 parashikon hartimin e planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive kulturore, planeve të menaxhimit për qendrat historike dhe monumentet e kulturës, si edhe të gjitha planet e tjera për menaxhimin e pasurive kulturore.

- Objektivi specifik i parë për realizimin e strategjisë kombëtare ka qenë krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës. Për këtë, që nga periudha e daljes së ligjit nr. 27/2018 óPër trashëgiminë kulturore dhe muzetëó, duhet të konsolidohej reformimi i kuadrit rregullator mbështetës duke krijuar:

- Paketën e legjislacionit primar/ligjeve e finalizuar (reforma e ligjeve në fuqi/ligje të reja).

- Paketën e legjislacionit dytësor/e finalizuar (akte nënligjore).

- Fushata informuese/ndërgjegjësimi për paketën ligjore.

Reformimi i kuadrit rregullator mbështetës do të arrihej nëpërmjet mekanizmave për zbatimin e kuadrit ligjor dhe strategjik të përmirësuar, të cilat do të konsistonin në:

- Hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e strategjisë nga institucionet kulturore të varësisë.
- Hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e strategjisë nga niveli vendor.
- Hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e strategjisë në fushën e turizmit kulturor.
- Hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e strategjisë përmes digjitalizimit të shërbimeve dhe produkteve kulturore.
- Hartimin e planeve të veprimit për përcaktimin e të dhënave statistikore për sektorin e kulturës.
- Hartimin e planeve të menaxhimit të pasurive kulturore.

Në kushtet e mungesës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 27/2018, së funksionimit të disa akteve në zbatim të ligjit nr. 9048/2003, të ndryshuar, së miratimit të një dokumenti strategjik pa plane konkrete veprimi, mungesës së planeve të sipërpërmendura, komunikimit institucional dhe ndërinstitutional të dobët, menaxhimi i monumenteve të kulturës nuk ka rezultuar të jetë efektiv, evidentuar kjo dhe në përgjigjet e pyetësorëve, intervistat, raportet e MK-së²¹ ashtu dhe në takimet me drejtuesit e tyre.²²

Ligji nr. 27/2018 óPër trashëgiminë kulturore dhe muzetëó, si një ligj voluminoz dhe problematik në disa aspekte, si në formë dhe interpretim, konceptuar dhe si Kod i cili të përfshijë të gjithë kuadrin ligjor të detajuar për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, paraqet vështirësi në trajtimin e vet.

Bazuar në pikën a) të nenit 264 të Lligjit nr. 27/2018, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të nxirrte komentarin

²⁰ Raportet vjetore 2019 ñ 2021.

²¹ Raportet e MK 2019 ñ 2021.

²² Përgjigje e pyetësorëve nga MK.

dhe manualin e përkufizimeve. **Komentari dhe manuali i përkufizime është më se i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të qartësuar terminologjinë, konceptet, interpretimet dhe problematikat e ligjit lidhur me monumentet e kulturës.**

Konkretisht, me Vendimin nr. 95, datë 07.04.2020 i KKTKM-së óPër miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar të Butrintit 2020-2030²³ parashikohet miratimi i një plani të integruar menaxhimi të parkut të Butrintit, nocion ky i pa trajtuar në ligjin për trashëgiminë dhe muzetë.²⁴ Ligji nr. 27/2018²⁴ óPër trashëgiminë kulturore dhe muzetë²⁴ përcakton format e menaxhimit të pasurive kulturore dhe mënyrat e administrimit të tyre. Për rrjedhojë, hartimi i planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme, me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre, është prioritet institucional i MK - së sipas këtij ligji.

Duke marrë në konsideratë përkufizimet e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë lidur me përkufizimin e ópasurisë kulturore²⁴ dhe ópasurisë kulturore të paluajtshme²⁴, si dhe duke bërë një krahasim me terminologjinë e përdorur në aktin e themelimit të fondacionit dhe në marrëveshjen e nënshkruar midis MK dhe AADF, konstatohet mungesë koherence në përkufizimet e përdorura. Njëkohësisht, në marrëveshjen e datës 24.02.2021 ndërmjet MK dhe AADF përcaktohet se, në rast rast konflikti midis përkufizimit të ópasurisë kulturore²⁴ sipas saj dhe përkufizimit të pasurisë kulturore sipas ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, përkufizimi përkatës sipas marrëveshjes do të mbizotërojë. Referuar teknikes legjislative, terminologjia dhe përkufizimet duhet të jenë të unifikuara dhe për rrjedhojë marrëveshja duhet të reflektojë përkufizimet e ligjit për trashëgiminë kulturore.

Në kushtet kur fokusi i këtij auditimi kanë qenë monumentet e kulturë e jo drejtpërdrejt ósitet arkeologjike²⁴, për shkak të ndjeshmërisë së madhe dhe impaktit të kësaj çështjeje, sugjerojmë kryerjen e një auditimi të plotë përputhshmërie mbi të.

Me VKM-në nr. 432, datë 26.06.2019 óPër funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore²⁴, është krijuar Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, IKRTK dhe statuti i të cilit duhet të miratohej brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, është miratuar me Urdhrin nr. 75 datë 17.02.2021 óPër miratimin e statutit të IKRTK²⁴. Pra statuti i IKRTK është miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara, gjë që ka ndikuar në mosfunksionimin e përshkrimeve të punës dhe realizimin e detyrave funksionale.

Në zbatim të VKM-së së mësipërme dhe VKM nr. 581, datë 28.8.2019 óPër funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore²⁴, IKRTK nuk ka krijuar zyrtar rajonale të IKRTK-së, të cilat kanë për detyrë:

- a) regjistrimin on-line të pasurive kulturore kombëtare dhe të çdo procedurë për identifikim e regjistrim.
- b) zbatimin e monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar dhe ndërkombëtar, të certifikuar të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit.

Bazuar në gërmën e) të pikës 2. të nenit 7 të Ligjit nr.27/2018, Inspektorati Kombëtar Përgjegjës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, IKMTK, është përgjegjës për zbatimin e masave për regjistrimin e pasurive kulturore pranë IKRTK-së.

²³ Bazuar në Ligjin nr. 27/2018 në asnjë nen tjetër të këtij ligji nuk ka përcaktim me termin óPlani i menaxhimit të integruar²⁴, pasi në pikën c) të nenit 42 është përcaktuar óPlanet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme²⁴.

²⁴ Neni 171 Ligji nr.27/2018.

Bazuar në pikën 4 të nenit 27 të Ligjit nr. 27/2018, Inspektoriati Kombëtar Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (IKMTK), i cili duhet të ishte krijuar brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit dhe të funksiononte me zyrat e veta në DRTK-të, nuk është ngritur ende. Sipas VKM-së nr. 581, datë 28.8.2019, deri në krijimin e IKMTK-së dhe daljen e akteve nënligjore, inspektimet do të kryhen si më parë nga DRTK-të. Por siç na u deklarua nga eprorët, stafi është shumë i kufizuar dhe ky proces nuk realizohet me efektivitet të plotë.

Bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 56 të Ligjit nr. 27/2018, identifikimi i trashëgimisë kulturore kryhet nëpërmjet inventarizimit të realizuar nga ana e IKRTK-së, sipas parashikimeve të këtij ligji.

IKRTK-ja është institucioni që mban, përditëson dhe administron Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore, si dhe regjistrat kombëtarë të vlerave kulturore materiale e jomateriale.

Në kushtet e mungesës së IKMTK-së dhe të zyrave të regjistrimit pranë DRTK-ve, stafeve të kufizuara në DRTK-të, mungesës së infrastrukturës përkatese, shpërndarjes së re territoriale (*administrimi i një monumenti kulture në zonë bëhet nga një DRTK, kur ai është aset për një NJVQV tjetër, etj*), koordinimit të ulët institucional midis MK, IKTK, MMT, MT, ASHK, ARSH, NJVQV, etj), menaxhimi i zinxhirit të proceseve për administrimin e monumenteve të kulturës vështirësohet shumë dhe nuk është efektiv.

Bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 27/2018, termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme i nënshtrohen miratimit nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore pas marrjes së mendimit paraprak nga KKTKM-ja dhe KKMPK-ja.

Dhe pse VKM-ja nr. 208 datë 10.04.2019 óPër përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materialeó, Urdhri nr. 223, datë 03.07.2020 i ministrit të Kulturës për óMiratimin e rregullores për veprimtarinë e KKTKM, Këshillit Teknik, të sekretarisë teknike dhe sportelit unik të sajó, është miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara. Në informacionin e vënë në dispozicion nga Ministria e Kulturës²⁵ rezulton se dhe pas miratimit të VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019, disa vendime janë miratuar nga KKR-ja²⁶ dhe KKA-ja²⁷. Pas miratimit si organ kolegjal vendimmarrës vendimet duhet të merreshin prej KKTKM-së, por ky organ nuk kishte rregullore të miratuar. Miratimet janë bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Rregullorja për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike të tij është miratuar me Urdhrin nr. 690, datë 15.11.2019 të ministrit të Kulturës óPër miratimin e rregullores për veprimtarinë e KKMPK dhe sekretarisë teknike të tijó, jashtë afateve ligjore të parashikuara.

Bazuar në nenin 60, pikën 3. të nenit 62 dhe pikën 1. të nenit 96 të Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në lidhje me pasurinë kulturore të paluajtshme, si dhe Këshilli i Ministrave, për grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme, kanë kompetencë të përcaktojnë zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, veçmas ose të grupuara, perspektivën, kushtet mjedisore dhe peizazhin.

Bazuar në pikën 3. të nenit 9 të Ligjit nr. 27/2018 mbi deklarin e pasurive kulturore të paluajtshme, të grupuara, MK ka miratuar disa vendime për deklarin e qendrave

²⁵ Raporti i KLSH-së, nr. 646/5 datë 30.04.2021, Vendimi nr.52 datë26.04.2021 óEfektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016-2019ó.

²⁶ Vendim KKR Nr. 228, datë 05.07.2019; Vendim KKR Nr. 257, datë 23.07.2019; Vendim KKR Nr. 326, datë 10.10.2019; Vendim KKR Nr. 363, datë 01.11.2019.

²⁷ Vendim KKA Nr. 237 datë 31.10.2019 óRelacion verifikimi - gjetje arkeologjike rastësore, Gjorm, Vlorëó. Vendim KKA Nr. 180 datë 31.07.2019 óPlotësim me ambiente shërbimi në lokalit óLeon Rayó, Apolonió. Vendim KKA Nr.137 datë 28.05.2019 óProjekt për ndërhyrje rehabilituese në parkun arkeologjik të Amantiasó.

historike/parqeve arkeologjike, përcaktimin e zonave mbrojtëse të tyre dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre, por jo për të gjitha zonat e mbrojtura në RSH²⁸.

Mungesa e akteve nënligjore mbi deklarimin e pasurive kulturore të paluajtshme, të grupuara për deklarimin e qendrave historike/parqeve arkeologjike, përcaktimin e zonave mbrojtëse të tyre dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre, kanë bërë që brenda zonës së mbrojtur të veprohet në mënyrë abuzive, të ndërhyhet dhe të bëhen ndërtime pa leje. Kjo rrezikon integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, dëmtimin dhe zhdukjen e zonave arkeologjike, pasurive kulturore, dëmton imazhin dhe identitetin kombëtar.

Ministria e Kulturës, bazuar në Ligjin nr. 27/2018 ËPër trashëgiminë kulturore dhe muzetë, nuk ka rishikuar VKM-në nr.729 dt. 01.09.2010 për Shpalljen e zonave arkeologjike në qytetin e Vlorës dhe miratimin e rregullores së administrimit.

Në Nëntor të vitit 2019 Shqipëria u godit nga tërmeti i fuqishëm i cili shkaktoi dëme të mëdha materiale si ngodina publike, pallate, dëme të konsiderueshme në monumentet e kulturës, kryesisht në Durrës, Tiranë, Krujë, etj. MK, duke mos patur plan emergjence të miratuar, e detyruar nga rrethanat e momentit, ngriti grupe pune për verifikimin e situatës dhe nxerrjen e vlerave të dëmeve të shkaktuara.

Në fillim të muajit Mars 2020, Evropa u bë qendra globale e pandemisë dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) klasifikoi shpërthimin e COVID-19 si një pandemi globale në botë. Si çdo sektor tjetër dhe trashëgimia kulturore u godit nga pandemia e virusit Sars-Cov-2 gjatë vitit 2020. Sipas INSTAT, gati 17 % e vizitorëve në institucionet e trashëgimisë kulturore ishin të huaj. Për shkak të pandemisë, edhe numri i vizitorëve pësoi rënie të ndjeshme me rreth 83%.²⁹

Gjithashtu për shkak të ndërprerjes së punës, transportit, për moskryerjen e shërbimeve të planifikuara, shumë monumente të kulturës rrezikuan zhdukjen e tyre, si në Tiranë, Gjirokastrë, Vlorë, Sarandë etj.³⁰

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga MK, gjatë periudhës janar-dhjetor 2020:

- Gjashtë Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, nuk kanë mundur të kryejnë planin e parashikuar për mirëmbajtjen, restaurimin, konsolidimin, pastrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në territoret nën juridiksionin e tyre. Kjo për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid 19.
- Si rezultat i mungesës së fondeve nga të ardhurat që do të vilesnin nga vizitorët në muzetë, monumentet dhe parqet arkeologjike nuk është bërë e mundur realizmi i objektivave e si rrjedhojë janë kryer kryesisht punime mirëmbajtje rutinë të objekteve të vizitueshëm, nxjerrja e disa objekteve/banesave nga gjendja e riskut, pastrime nga vegjetacioni si dhe përgatitja e objekteve të trashëgimisë kulturore për sezonin turistik.

²⁸ Vendimi ËPër deklarimin pasuri kulturore Qendër historike të fshatit Bënjë, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. Vendimi ËPër deklarimin pasuri kulturore Qendër Historike të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj, dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre, i ndryshuar. Vendimi nr. 582, datë 3.10.2018 ËPër deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin. Vendimi nr. 60, datë 29.1.2020 ËPër deklarimin pasuri kulturore ansambël historik urban, zonës mbrojtëse të tij, dhe zonës arkeologjike ËB, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. VKM nr. 786, datë 26.12.2018 ËPër miratimin e zonave arkeologjike ËA dhe ËB të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. VKM nr. 687, datë 23.10.2019 ËPër miratimin e zonës arkeologjike ËA të qytetit të Elbasanit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj. Vendimi nr.399, datë 13.05.2020 ËPër përcaktimin e kufijve të parkut arkeologjik Durrës.

²⁹ <https://ata.gov.al/2021/02/03/pandemia-goditi-edhe-artin-dhe-kulturën-numri-i-shfaqjeve-ra-ne-328-ne-2020/>
<https://faktoje.al/monumentet-e-kultures-ne-gjirokastr-vuajne-harresen-institucionale/> Monumentet e kulturës në Tiranë drejt zhdukjes.

- Veprimtaria e këtyre institucioneve në dy muajt e parë të vitit 2020 janar dhe shkurt është zhvilluar normalisht. Ndërsa në muajt në vijim punimet janë kryer me ritme të ngadalta për shkak të pandemisë COVID - 19.
- DRTK-të së bashku me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore gjatë kësaj periudhe janë fokusuar në hartimin e projekteve të nevojshëm për restaurimin e objekteve.³¹

Bazuar në nenet 9, 14, si edhe në zbatim të pikës 2 të Nenit 22 të Ligjit nr. 45/2019 óPër mbrojtjen civile, në kushtet e fatkeqësive natyrore, çdo ministër dhe drejtues institucioni qendror është përgjegjës për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore apo të kompetencave të tyre. Ministritë dhe institucionet qendrore kanë për detyrë të hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe ta dërgojnë atë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi.

Nga auditimi rezulton se MK nuk ka një plan të emergjencave civile, me qëllim zvogëlimin e pasojave negative të diktuar nga rreziqet dhe menaxhimi i krizave në raste fatkeqësish natyrore. Bazuar në pikën 3, të nenit 11 të Ligjit nr. 27/2018 óPër trashëgiminë kulturore dhe muzetë, Ministria e Kulturës kishte planifikuar hartimin e VKM-së óPër ruajtjen e trashëgimisë kulturore nga rastet e fatkeqësive natyrore dhe konfliktet e armatosura, deri në Prill 2021.

Sipas eprorëve të MK është hartuar drafti i Projekt VKM dhe është për mendim të MF. Është prezantuar në Këshillin Konsultativ. Pritet të mbyllet dhe të dërgohet në KM për miratim deri në fund të muajit Maj 2022. Por ky akt deri tani rezulton i pamiratur.

Me Urdhrin e Ministrit të Kulturës Nr. 20, datë 19.01.2021 óPër një ndryshim në Urdhrin nr. 410 datë 9.7.2019 óPër ngritjen dhe funksionimin e komisionit të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, të ndryshuar, është krijuar Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.

Të menaxhosh monumentet e kulturës do të thotë: të ekzistojë kuadri rregullator i plotë dhe mbështetës në funksion të zbatimit të politikave shtetërore, të bëhen analiza të detajuara të rëndësisë së tyre, stafet e punonjësve si dhe grupet e interesit të lidhura me to të arrijnë të kuptojnë se vlerat kulturore duhen ruajtur dhe trashëguar, të hartosh plane menaxhimi të cilat duhet të mbajnë parasysh planet kombëtare dhe vendore, ndryshimet demografike, faktorët ekonomikë, planifikimin urban dhe zhvillimin e territorit, inspektimin dhe hartimin e raporteve nga profesionistët me kualifikimet e duhura, hartimin e planeve strategjike të mirëmbajtjes, ruajtjes, konservimit të integruara me planet vjetore të punës, etj.³²

Ligji Nr. 27/2018 doli si një domosdoshmëri për një mirëmenaxhim të monumenteve të kulturës, në të gjitha aspektet e funksionimit të tyre, si atë të bashkëpunimit privat-shtet, mirëmbajtjen e objekteve të pasurive të paluajtshme, shfrytëzimin e monumenteve të kulturës ndërmjet rijetëzimit, kërkesat që sistemi i trashëgimisë kulturore kishte në mënyrën e menaxhimit, administrimin, kontrollin dhe masat për ruajtjen të fondeve të pasurisë kulturore të cilat ishin shoqëruar me dëmtime të monumenteve me vlera të veçanta kulturore, rrëmbime të objekteve të TK, etj.³³ Duhet të realizohet gjithçka nëpërmjet harmonizimit të legjislacionit mbi trashëgiminë kulturore me direktivat dhe rregulloret të BE-së për trashëgiminë kulturore, lëvizjen e objekteve kulturore, direktivë e Këshillit të Evropës dhe Parlamentit Evropian të 15 maj 2014, 2014/60/EU, mbi óKthimin e objekteve kulturore të hequr në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti

³² óUdhëzues për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore © Cultural Heritage ËithoutBorders 2010. Bernard M. Feilden dhe Jukka Jokilehto.

³³ Përgjigjet e pyetësorëve të ardhura nga MK.

anëtar dhe amendon rregulloren (EU) nr.1024/2012⁶, Rregullore e Këshillit të Evropës nr.116/2009, datë 18 dhjetor 2008, për òEksportin e mallrave kulturore⁷.

Me miratimin e Ligjit nr. 27/2018 òPër trashëgiminë kulturore dhe muzetë⁸, ndryshoi struktura e MK dhe me Urdhrin nr. 92, datë 19.02.2020 të ministrit të Kulturës òPër miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm për MK⁹, u miratua jashtë afateve ligjore të parashikuara rregullorja e brendshme administrative mbi bazën e së cilës hartohen dosjet me përshkrimin e funksioneve të punonjësve dhe stafit drejtues, specifikat e procedurave të punës së tyre si edhe të çdo drejtorie, rregullat, kërkesat dhe procedurat që i shërbejnë efektivitetit të shërbimit të administratës së institucionit.

Gjatë periudhës objekt auditimi 2019-2021, në MK janë bërë ndryshime dhe reforma strukturore në fushën e administrimit dhe menaxhimit të monumenteve të kulturës.

Nga përgjigjet e pyetësorëve jemi vënë në dijeni se strukturat e mëparshme me të cilën ka realizuar veprimtarinë e saj Ministria e Kulturës në funksion të realizimit të politikave shtetërore për menaxhimin e monumenteve pranë MK kanë qenë më efektive, më të organizuara në përputhje me fushat e përgjegjësisë së Ministrisë së Kulturës, ku çdo drejtori kishte misionin e saj strategjik: òHartim dhe zhvillim projektesh dhe monitorimin e tyre¹⁰.

Struktura aktuale e Ministrisë së Kulturës nuk funksionon apo nuk ka gjetur përputhshmëri me mënyrën e organizimit të stafeve dhe menaxhimin e tyre pasi vijohet të punohet sipas formës së organizmit të strukturave të mëparshme. Rregullorja e MK është miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara.

Lidhur me DJ, e cila është një ndër drejtoritë përgjegjëse për hartimin e kuadrit rregullator mund të themi se ka patur problematika lidhur me aspektet e brendshme administrative, të cilat mund të renditën si më poshtë vijon:

- Në kuadrin e një ligji voluminoz, ka volum të konsiderueshëm pune, pasi mbulon të gjithë aparatit e Ministrisë së Kulturës me dhënien e konsulencës juridike, përfshirë dhe institucionet e varësisë të sistemit të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

- Asiston në dhënien e ndihmës juridike për përfaqësim të institucionit në procese gjyqësore, dhënien e mendimit juridik për marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, kontratat e sponsorizimit, si dhe çështje të tjera të karakterit juridik që lidhen me Drejtorinë e Integritetit dhe Drejtorinë e së Drejtës së Autorit.

- Asiston në hartimin e projekturdrave & projektudhëzimeve të Ministrit të Kulturës, të cilat rrjedhin nga një ligj voluminoz.

- Në lidhje me burimet njerëzore të drejtorisë, në pjesën më të madhe të vitit 2020 kanë patur vështirësi të konsiderueshme. Kështu, në periudhën më të ngarkuar me draftimin dhe miratimin e projektakteve (shkurt-qershor 2020), kjo drejtori ka funksionuar me më pak se 50% të kapacitetit dhe plotësimi i vendeve vakante ka ardhur gradualisht dhe vetëm nga fundi i vitit 2020 ka një staf të plotë.

- Drejtoria juridike varet në punën e saj nga drejtoritë e përmbajtjes në ministri, si edhe ministritë e tjera. Si drejtori rregullatore dhe standardizimi, drejtoria nuk harton politika, por vetëm sigurohet që materiali që vjen nga drejtoritë e tjera të jetë i standardizuar dhe i harmonizuar me legjislacionin në fuqi. Për këtë arsye, ecuria e projektakteve lidhet në një masë të madhe nga puna që bëjnë drejtoritë e përmbajtjes për përgatitjen e drafteve fillestare, si dhe synimeve që kanë këta të fundit në ndjekjen e politikave sektoriale të cilat më pas i nënshtrohen një rishikimi në formë dhe arsyetim ligjor nga drejtoria juridike. Për këtë proces janë ngritur grupet përkatëse të punës ku përfaqësues nga DJ asistojmë në cilësinë e anëtarit në hartimin e akteve nënligjore.

Pikërisht një strukturë e tillë joeficiente si dhe bashkëpunim i dobët instituciona sjellin mosrespektimin e afateve kohore në hartimin e kuadrit rregullator.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, IKTK, krijuar me VKM nr. 364/2019³⁴, struktura e të cilit është miratuar me Urdhrin nr. 137/2019³⁵ të Kryeministrit të Shqipërisë, gjatë periudhës objekt auditimi ka funksionuar me dy akte nënligjore të miratuara jashtë afateve ligjore të parashikuara:

a) statutin i cili është miratuar me Urdhrin Nr. 342, dt. 22.09.2020 të ministrit të Kulturës; b) rregulloren e IKTK-së, e cila është miratuar me Urdhrin nr. 344, datë 22.09.2020 për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të IKTK.

Ndryshimi i roleve dhe përgjegjësi të strukturave i pa përfaqësuar në aktet nënligjore dhe administrative përkatëse (statut dhe rregullore), ka bërë që të ketë menaxhim të dobët, papërgjegjshmëri dhe komunikim institucional jo efektiv midis IKTK-së, DRTK-ve, NJVQV-ve, subjekteve publike dhe private, vendase apo të huaja, në fushën e trashëgimisë kulturore.

Gjykuar në sa më sipër kuptohet që reformat strukturore në MK, IKTK dhe institucionet e varësisë nuk i kanë shërbyer shumë realizimit të misionit të këtij institucioni qendror. Në mungesë të kuadrit rregullator, stafit të punës, reformave strukturore realizuar jo mbi analiza konkrete, menaxhimi i monumenteve të kulturës nuk ka qenë efektiv.

Bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr. 27/2018 për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, për kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në kuadrin e planeve të veta sektoriale, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, harton planet kombëtare të peizazhit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara.

Gjykuar në sa më sipër, bazuar në pikën 4 të nenit 245, Ministria e Kulturës duhet të propozojë dhe të miratojë Planin Kombëtar të Peizazhit, sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithashtu, në zbatim të pikës 8 të nenit 30 të Ligjit Nr. 27/2018, nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit në bashkëpunim me institucione të vetëqeverisjes vendore, partnerë publikë e privatë, vendas dhe të huaj, IKTK-ja mund të luajë rolë të madh në kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të parkut.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 96, VKM-në për përcaktimin e zonave mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin, është miratuar VKM-ja nr 771, datë 30.9.2020 për deklarimin pasuri kulturore të Qendrës historike të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. Por në zbatim të kësaj VKM vetëm peizazhi nuk ka filluar ende për shkak të mungesës së stafit teknik.

Bazuar në pikat 1 dhe 4, të nenit 102, të Ligjit nr. 27/2018, Ministria e Kulturës nuk ka hartuar udhëzimin për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së

³⁴ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 364, datë 29.5.2019 për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore

³⁵ Urdhër nr. 137, datë 21.10.2019 për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore

subjekteve, të cilin nuk e ka as në proces draftimi. Nga intervistat me eprorët e MK vihet në dukje mungesa e specialistëve të peisazhit, i cili shikohet si një problem shqetësues dhe që do të sjellë vonesa në realizimin e këtyre detyrimeve ligjore. Kjo tregon dhe një herë mosefektivitetin e strukturave pranë MK dhe papërgjegjshmërinë institucionale të eprorëve të këtij institucioni. Në kushtet e shpërndarjes së re territoriale, për shkak të ndryshimit të varësisë së administrimit të monumenteve të kulturës nga DRTK-të përkatëse apo/dhe NJVQV si asete në territorin e tyre, bashkëpunimit jo korrekt midis MK, MMT, MT, ASHK, ARSH, NJVQV, RTSH, etj, që nga momenti i vendosjes së sinjalistikës rrugore dhe tabelave për të evidentuar vendndodhjen e tyre dhe më tej, stafeve të kufizuara, etj, menaxhimi i zinxhirit të proceseve për administrimin e monumenteve vështirësohet shumë dhe ndesh në problematika të pazgjidhshme.

Në zbatim të nenit 186, MK ka miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara VKM Nr. 828, datë 18.12.2019 óPër miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të kontratës së rijetëzimit. Kjo kontratë lidhet për një kohëzgjatje deri në 20 vjet, me të drejtë rinovimi vetëm një herë, nëse subjekti ka përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet kontraktuese, në bazë të raportit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, i cili nuk është krijuar akoma.

Gjithashtu, në zbatim të pikës 3 të nenit 84 të Ligjit nr. 27/2018, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore vendos hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim pasi konsultohet me KKTKM-në, KKMPK-në dhe IKTK-në, dhe për vlerat arkeologjike kulturore të paluajtshme të IKTK-së, mbi bazën e kërkesës individuale të subjektit të interesuar, ndërkohë që kuadri rregullator për funksionimin e këtyre organeve kolegjiale nuk është miratuar i plotë.

Në mungesë të, IKMTK-së dhe zyrave përkatëse në DRTK-të, akteve dhe daljes së tyre jashtë afateve ligjore të parashikuara, edhe funksionet e ruajtjes, të mbrojtjes, kontrollit teknik, inspektimit dhe mbikëqyrjes së pasurive të dhëna në rijetëzim, pra shfrytëzimi i monumenteve të kulturës ndërmjet rijetëzimit, nuk ka rezultuar efektiv.

Siç pohohet në përgjigjet e pyetësorëve, kërkesat dhe dobësitë që sistemi i trashëgimisë kulturore kishte në mënyrën e menaxhimit në të gjitha aspektet e funksionimit të tyre, administrimit, kontrollit, masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e fondeve të pasurisë kulturore, atë të bashkëpunimit privat-shtet, shfrytëzimit të monumenteve ndërmjet rijetëzimit, etj, nxorren domosdoshmërinë e hartimit të ligjit të ri³⁶.

Observacionet e Subjektit:

Ministria e Kulturës ka paraqitur observacionet me shkresën nr. 3580 prot., datë 01.07.2022 (protokolluar me tonën me nr. 100/5 prot., datë 30.06.2022), me anë të së cilës paraqiten observacionet mbi Projektraportin e Auditimit të performancës me temë: “*Mbrojtja dhe administrimi i monumenteve të kulturës*”, si më poshtë vijon:

1. Përsa i përket rekomandimit 4, u paraqit observacioni i mëposhtëm: Lidhur me përsheptimin e punës për miratimin e VKM-së për deklarimin e qendrave historike, përcaktimin e zonave mbrojtëse të tyre dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre, janë propozuar dhe miratuar:

VKM Nr. 687, datë 23.10.2019 óPër miratimin e zonës arkeologjike "A" të qytetit të Elbasanit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj. VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për

³⁶Raportimet gjatë periudhës objekt i auditimit (2016 - 2019) <https://mega.nz/folder/NxlyAASA#C2h5vOsB-1YvOM7MPPO3Hw>. Raporti i KLSH-së, nr. 646/5 datë 30.04.2021, Vendimi nr.52 datë 26.04.2021 óEfektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016-2019.

miratimin e zonës arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. VKM Nr. 729, datë 16.09.2020 óPër deklarimin pasuri kulturore "Qendër historike" të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. VKM Nr. 771, datë 30.9.2020 óPër deklarimin pasuri kulturore të óQendrës historike" të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. VKM Nr. 582, datë 3.10.2018 "Për deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj. VKM Nr. 60, datë 23.10.2019 óPër deklarimin pasuri kulturore "Ansambël historik urban", zonës mbrojtëse të tij, dhe zonës arkeologjike óBô, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. VKM Nr. 399, datë 13.05.2020 "Për përcaktimin e kufijve të parkut arkeologjik Durrës".

Aktualisht janë në proces me ministritë e linjës:

Projektvendimi "Për deklarimin e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Elbasanit".

Projekt-vendimi për deklarimin e zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Elbasanit

Puna do të vijojë në përputhje me Planin analitik vjetor të projektakteve. Gjithashtu VKM-të për shpalljen e qendrave historike të Beratit dhe Gjirokastrës janë hartuar dhe propozuar bazuar mbi studimet e kryera nga DRTK-të dhe IKTK-ja dhe janë miratuar me VKM-të përkatëse, respektivisht:

VKM nr. 767, datë 12.11.2014 (qendra historike Berat) VKM nr. 619, datë 7.7.2015 (qendra historike Gjirokastrë)

Rregulloret e të dy qendrave historike nuk bien në kundërshtim me Ligjin 27/2018. Ndërkohë aktualisht është në proces përgatitja e Planit të Menaxhimit të integruar (PMI) të Qendrave Historike Berat dhe Gjirokastrë. Projekti për zhvillimin e PMI për qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë është ndërmarrë nga IKTK-ja në kuadër të zbatimit të vendimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore/UNESCO që theksojnë nevojën urgjente për një plan të integruar menaxhimi për pasurinë botërore. Projekti për përgatitjen e PMI drejtohet nga IKTK, nën koordinimin e QTB/UNESCO dhe bashkëfinancim të UNESCO s (Programi për Asistencë Ndërkombëtare) dhe buxhetit të shtetit. Hartimi i draftit të planit do të zhvillohet në periudhën maj - dhjetor 2022 me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë që do të përzgjidhen dhe kontraktohen nga QTB. PMI propozohet të shtrihet në periudhën 7 vjeçare (2023-2030). Rishikimi i VKM të lartpërmendur do të rivlerësohen pas miratimit të Planit të Menaxhimit të Integruar për qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket sqarimit të mësipërm nga ana juaj, theksojmë se, grupi i auditimit ka evidentuar vonesat në: hartimin e rregulloreve për DRTK-të; miratimin e vendimeve lidhur me deklarimin e qendrave historike; përcaktimin e zonave mbrojtëse të tyre; miratimin e planit për ruajtjen e administrimin e tyre të cilat kanë sjellë problematika në zonat e mbrojtura në qytetet respective. Për këto çështje kemi adresuar zgjidhjen e problemit përmes bashkëpunimit ndërinstitucional. Lidhur me pretendimet tuaja, sqarojmë se është përgjegjësi institucionale respektimi dhe përmbushja e detyrimeve ligjore.

2. Në lidhje me nënpyetjen 4.1.1 A janë hartuar aktet rregullatore në funksion të *mirëmenaxhimit të monumenteve të kulturës?*, për të cilën është arritur në përfundimin se mungesa e koordinimit të punës brenda institucionit qendror të Ministrisë së Kulturës dhe bashkëpunimi i ulët ndërinstitucional, kanë ndikuar në *mosmiratimin* në kohë të kuadrit rregullator për *menaxhimin*

e monumenteve të kulturës, u argumentua se:

DPHSKRr zbaton çdo vit vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili miratohet në fund të muajit Dhjetor të çdo viti kalendarik, nëpërmjet të cilit paraqitet Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve që duhet të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave deri në fund të vitit. Këtij vendimi i bashkëlidhen tabelat me aktet nënligjore për miratim për çdo ministri. Sipas pikës 7 të Kreut II të vendimit nr. 584, datë 28.8.2003 *"Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave"*, i ndryshuar, *brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik dhe në çdo rast, brenda afatit të caktuar nga Kryeministri, sipas fushës së veprimtarisë që kanë në kompetencë, ministrat i paraqesin Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave projektprogramin e hollësishëm të projektakteve që parashikojnë të propozojnë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në vitin pasardhës. Këto akte janë të ndarë në katërmujorë dhe kanë të parashikuar edhe afatin e paraqitjes së tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.*

A. Pas miratimit të vendimit për Programin Analitik të Projektakteve, nis procedura për përgatitjen e projektakteve. Përpara fillimit të procesit të hartimit të projektaktit, strukturat teknike, që përfshijnë ekspertë sipas fushës specifike që rregullon projektligji ose projektvendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, bëjnë vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektaktit në të cilin përfshihen, ndërmjet të tjerave:

a) qëllimet e projektaktit dhe synimet që arrihen;

b) përputhshmërinë me programin politik dhe me programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian si dhe me strategjitë e programet e miratuara mbi drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore; c) pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi; d) parashikimet dhe masat që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e projektaktit; e) shpenzimet buxhetore dhe efektet financiare të pritshme; f) ndikimet ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore të pritshme.

Mbështetur në vlerësimin paraprak të projektaktit, ministri cakton me urdhër të veçantë çështjet që duhen rregulluar, format e pjesëmarrjes dhe hapat kryesore të realizmit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet njerëzore dhe materiale që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e çdo projektakti. Projektaktet hartohen nën përgjegjësinë e strukturës juridike, e cila në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të ministrisë, organizon këshillime me drejtues a specialistë të drejtorive, sektorëve a enteve, si dhe me struktura të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit. Gjithashtu struktura juridike, sipas rastit mund të kërkojë mendimin e ekspertëve të tjerë, brenda ose jashtë ministrisë. Në bashkërendim me strukturën juridike, strukturat përgjegjëse përpilojnë raportin e vlerësimit të ndikimit të projektaktit, relacionin shpjegues të projektaktit, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare, si dhe plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm shoqërues përpara se t'i dërgohen për shqyrtim ministrit. Në përfundim të konsultimeve dhe shqyrtimit të projektaktit dhe të gjithë dokumentacionit të sipërcituar, ministri pasi vlerëson nismën, vendos dërgimin e tyre për mendim në ministritë dhe institucionet e interesuara ose urdhëron rishikimin e tyre brenda një afati të caktuar prej tij.

B. Faza e dytë pasardhëse është ajo e bashkërendimit, gjatë së cilës projektakti dërgohet për mendim. Ky projektakt shoqërohet me raportin e vlerësimit të ndikimit të plotësuar, relacionin shpjegues me të gjitha elementet e tij, si dhe çdo dokument tjetër, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 584, datë 28.8.2003 *"Për miratimin e rregullores të Këshillit të Ministrave"*, të ndryshuar. Çdo projektakt i

dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë e cila shprehet mbi ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes, për çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legislative, terminologjinë juridike dhe formulimet përkatëse. Gjithashtu, në varësi të çështjeve që trajton projektakti, është detyrim që t'i dërgohen ministrive respektive. Faza e bashkërendimit nuk kufizohet vetëm me ministrinë e linjës, por edhe institucionet e tjera të interesuara. Sipas parashikimeve të pikës 28 të Kreut V të vendimit të sipërcituar, ministrat dhe titullarët e institucioneve të interesuara dërgojnë mendimet e tyre ministrin/ministrave propozues, në formë shkresore dhe elektronike, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga data e marrjes nëpërmjet sistemit e-akte të projektaktit dhe të kërkesës për mendim që e shoqëron atë. Për ministrin e Drejtësisë, ministrin përgjegjës për çështjet e integritetit evropian dhe ministrin përgjegjës për financat, ky afat është 10 (dhjetë) ditë pune. Nëse, pas mbarimit të afateve të sipërpërmendura, mendimi i kërkuar nuk është dhënë, do të konsiderohet se ministri përkatës është dakord dhe pa vërejtje për projektaktin, me përjashtim të ministrin të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet për aktin. Mendimet e ministrive dhe institucioneve të interesuara përmbajnë komente dhe sugjerime të cilat vlerësohen rast pas rasti. Në rastin e dhënies së mendimeve që synojnë të propozojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht thelbin e përmbajtjes së projektaktit, ministri duhet të paraqesë për çdo çështje edhe argumentet përkatëse dhe kur është rasti, riformulimet e nevojshme të dispozitave të projektaktit.

C. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Projektakti shoqërohet me raportin e vlerësimit të ndikimit, relacionin shpjegues ku janë reflektuar mendimet e subjekteve të interesuara dhe të gjithë procesin që ka ndjekur projektakti dhe llojit të këtij të fundit edhe dokumentacioni shoqërues dhe dokumentat e përcaktuar në pikën 45 të Rregullores së sipërcituar.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave kur vëren se dokumentacioni që shoqëron projektaktin është i plotë, e pranon atë për shqyrtim paraprak, kurse kur vëren mungesa ia kthen ministrin propozues. Në vijim Sekretari i Përgjithshëm në bazë të projektakteve dhe të çështjeve të paraqitura nga anëtarët e Këshillit të Ministrave, përgatit rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave dhe ia paraqet për miratim Kryeministrit.

Për sa parashtruar më sipër procesi për finalizimin e një projektakti është i gjatë dhe në pjesën më të madhe të tij varet nga bashkëpunimi brenda ministrisë, por edhe nga institucionet e interesuara. I gjithë ky proces është tejet intensiv dhe pavarësisht dëshirës për bashkëpunim rezultati nuk është gjithmonë ai i synuari. Nga të gjitha fazat e sipërcituara, faza e bashkërendimit është ajo e cila kërkon kohën më të madhe të procesit. Kjo për shkak se bashkërendimi për pjesën më të madhe të projektakteve shoqërohet me disa *kthim përgjigje*. Komentet nga institucionet e interesuara shqyrtohen dhe analizohen nga strukturat përkatëse brenda ministrisë dhe institucionet e varësisë, sipas objektit të projektaktit. Sipas rastit këto sugjerime mund të pranohen ose jo dhe në varësi të këtij qëndrimi, përgjigja i përcillet institucioneve përkatëse dhe në këtë mënyrë vijohet deri në arritjen e dakordësisë finale.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket sqarimit të mësipërm nga ana juaj, theksojmë se, grupi i auditimit ka vënë në dukje disa prej problematikave administrativo - juridike të hasura në administrimin e institucioneve, si edhe arsyet e tjera të vonësive në ecurinë e realizimit të planit analitik për hartimin e akteve, gjatë periudhës objekt auditimi, të cilat janë pasqyruar në raportet e vëna në dispozicion, përgjigjet e pyetësorëve dhe emailët dërguar nga ana juaj. Gjikuar mbi to, kemi adresuar zgjidhjen e problemit përmes bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitutional. Për sa më sipër, sqarojmë se është përgjegjësi institucionale përmbushja e detyrimeve ligjore.

3. Për sa i përket konkludimit se, vendimet e marra nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (KKR) dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për shkak se janë marrë gjatë kohës që ishte krijuar Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), ju bëjmë me dije se:

Pavarësisht krijimit të një institucioni/organi kolegjal të ri, që ka kompetencat në një fushë të caktuar, këto kompetenca nuk i hiqen institucionit/organit kolegjal paraardhës në mënyrë automatike. Në rastin konkret, pavarësisht se KKTKM-ja ka nisur të funksionojë nëpërmjet vendimit nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”* nuk do të thotë se nga data e botimit të vendimit në Fletoren zyrtare, që është dhe data e hyrjes në fuqi të aktit, aktet do të dalin menjëherë vetëm nga ky institucion. Mënyra e nxjerrjes së akteve, në këto raste rregullohet nëpërmjet dispozitave të fundit dhe kalimtare të aktit. Në rastin konkret në pikën 1 të Kreut VI të vendimit nr. 208, datë 10.04.2019, parashikohet se *“Aplikimet e nisura për shqyrtim dhe vendimmarrje nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (KKR) dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) trajtohen sipas akteve të krijimit të KKR-së dhe KKA-së, deri në ngritjen e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK)”*. Kjo do të thotë se pavarësisht krijimit të KKTKM-së, aplikimet e nisura dhe vendimet e KKR-së dhe KKA-së vazhdojnë të nxirren nga këto dy institucione deri në ngritjen e IKTK-së. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ka nisur të funksionojë nëpërmjet vendimit nr. 364, datë 29.05.2019 *“Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”*. Në pikën 3 të Kreut IV të këtij vendimi është parashikuar *“Deri në fillimin e funksionimit të plotë të IKTK-së, sipas këtij vendimi, strukturat aktuale vazhdojnë funksionimin e tyre sipas strukturave dhe organikave të miratuara”*, që do të thotë se deri në funksionimin e plotë të IKTK-së, KKR ja dhe KKA-ja vazhdojnë të funksionojnë si më parë, pra të nxjerrin akte që janë në kompetencën e tyre. Sqarojmë këtu se data e fillimit të funksionimit të plotë të IKTK-së është e ndryshme nga data e vendimit dhe hyrjes në fuqi të këtij të fundit, sepse procedura e krijimit dhe funksionimit të një institucioni inicohet me një vendim të Këshillit të Ministrave, por vijon me një sërë procedurash të tjera të cilat kërkojnë kohën e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket sqarimit të mësipërm nga ana juaj, theksojmë se, bazuar në VKM nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, aplikimet e nisura për shqyrtim dhe vendimmarrje nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (KKR) dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) trajtohen sipas akteve të krijimit të KKR-së dhe KKA-së, deri në ngritjen e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK). Por, dhe pse IKTK-ja ka funksionuar sipas VKM-së nr. 364, datë 29.5.2019 *“Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 137, datë 21.10.2019”* për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, disa vendime janë marrë nga KKA-ja dhe KKR-ja. Sqarojmë se është përgjegjësi institucionale respektimi dhe përmbushja e detyrimeve ligjore.

4. Për sa i përket akteve të pamiratuara të listuara në Shtojcën 2 të Projekt Raportit, lutemi reflektimin e informacionit të mëposhtëm në raportin përfundimtar të auditimit, sa i përket miratimit të akteve si vijon:

Vendimi nr. 438, datë 22.06.2022 *“Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Pallatit të*

Brigadave"; Vendimi nr. 420, datë 15.06.2022 "*Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura*"; Udhëzimi nr. 374, datë 24.06.2021 "*Për përcaktimin e rregullave të monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuritë kulturore*"; Projektvendimi "*Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim indirekt të pasurive kulturore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë*".

Paraprakisht evidentojmë se aktet nënligjore të listuara në shtojcën 2, në aspektin procedural duhet të ndahen në projektvendime dhe udhëzime.

Aktet në proces:

Projektvendime dhe projektligje:

Projektvendimi "*Për parashikimet në lidhje me zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, të veçanta, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin*"; Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar*", është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2022; Projektvendimi "*Për mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të komisionit këshillimor të ngritur pranë QKVT-së, IKRTK-së dhe IKTK-së për vlerësimin dhe identifikimin e pasurive kulturore*"; Projektvendimi "*Për përcaktimin e procedurave publike për kalimin në administrim indirekt të pasurive kulturore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë*", është dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave; Projektvendimi "*Për përcaktimin e tarifave për shpërblim të arsyeshëm nga riprodhimi i veprave për përdorim privat ose përdorim tjetër personal*", është publikuar në faqen e internetit për konsultim publik me grupet e interesit; Projektvendimi "*Për format dhe llojet e licencave të qarkullimit të lirë për eksportin e pasurive kulturore të luajtshme*"; Projektvendimi "*Për përcaktimin e funksionimit, organizimit dhe veprimtarisë së Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim*", është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2022. Udhëzimet: - "*Për rregullat e monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuri kulturore*"; "*Për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore*"; "*Për termat dhe kushtet për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme*"; "*Për procedurat dhe mënyrat e inventarizimit, regjistrimit dhe katalogimit të pasurive kulturore*";

"*Për funksionimin e "Sistemit digjital për bazën e të dhënave të pasurive kulturore"*"; "*Për kriteret dhe mënyrat e depozitimit të kërkesave për verifikim, metodologjinë e tarifave, organet këshillimore, kriteret për marrjen e vendimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të aplikimit*"; "*Për kriteret e përpilimit të listave të pasurive të paluajtshme në pronë shtetërore, mënyrat e redaktimit të skedave përshkruese dhe dërgimin e tyre për verifikim*"; "*Për mënyrën e funksionimit të komisionit këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë të luajtshme, të paluajtshme dhe në pasuritë jo materiale*"; "*Për kriteret dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, të krijuar pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-së*"; "*Për procedurën për kryerjen e kontrollit teknik të pasurive kulturore të paluajtshme*"; "*Për kriteret dhe nivelet e cilësisë që duhet të ketë programi i formimit vazhdues të personave të pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe me licencë për kryerjen e veprimtarive arkeologjike*"; "*Për mënyrën dhe formën e mbajtjes së informacionit nga subjektet publike ose private për pasuritë kulturore që kanë në pronësi ose administrim*"; "*Për mënyrat e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse*"; "*Për kushtet, kriteret, procedurat, mënyrat, kohëzgjatjen dhe tarifat për dhënien e miratimit dhe deklarimin e interesit kulturor*"; "*Për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlera arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteve*"; "*Për*

krijimin dhe funksionimin e "Regjistrimit të tregtimit të pasurive kulturore ">"; "Për procedurat dhe mënyrat e daljes së pasurive jashtë vendit"; "Për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimit të pasurive kulturore të vjedhura"; "Për rregullat e hollësishme mbi lejen për hulumtime arkeologjike"; "Për mënyrën e vlerësimit të gjetjeve rastësore të objekteve arkeologjike"; "Për format e mbështetjes së veprimtarive dhe strukturave për vlerësimin e pasurive kulturore në pronësi private"; "Për përcaktimin e rregullave për dhënien në përdorim të drejtpërdrejtë të pasurive kulturore".

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacioni merret parasysh

5. Në lidhje me rekomandimin 5, janë paraqitur observacione, konkretisht: Me vendim nr. 420, datë 15.06.2022 është miratuar VKM për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësisë natyrore dhe konflikteve të armatosura".

Në situatën e krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019 janë hartuar planet për përgatitje për emergjencat civile, të Ministrisë së Kulturës dhe 28 institucioneve të varësisë" (IKTK Nr. 2553 prot., datë 04.12.2019_Planet janë përcjellë nga Ministria e Kulturës në Ministrinë e Mbrojtjes, AKMC).

Gjithashtu, Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore janë pjesë e Grupit Teknik për "Hartimin e projektit të strategjisë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë", si dhe pjesë e Grupit Teknik për "Kryerjen e vlerësimit të riskut të tërmeteve". Të dy këto dokumente janë miratuar së fundmi dhe përfshijnë të gjithë spektrin e trashëgimisë kulturore në kuadër të risqeve ndaj fatkeqësisë natyrore.

1. Në periudhën 2019-2021 IKTK-ja ka rishikuar, përcjellë pranë Ministrisë së Kulturës dhe është finalizuar miratimi i VKM-së për qendrat historike për qytetin e Shkodrës, fshatrat Kaninë dhe Bënjë.

2. Në dhjetor 2021 është miratuar në KKTKM projektvendimi për qendrën historike të qytetit të Elbasanit dhe është përcjellë zyrtarisht në Ministrinë e Kulturës. 3. Në dhjetor 2021 është miratuar në KKTKM projektvendimi për zonën arkeologjike "A" dhe obeliskun të qytetit të Elbasanit dhe është përcjellë zyrtarisht në Ministrinë e Kulturës. 4. Në qershor 2021, IKTK ka përcjellë pranë Ministrisë së Kulturës draftpropozimin për rishikimin e rregullore (pa ndryshimin e kufijve) të administrimit për zonat arkeologjike të qendrave të qyteteve Berat, Sarandë, Krujë, Lezhë, Shkodër, Koman, Gradishta e Selcës, duke përfshirë edhe Vlorën.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa i përket sqarimit të mësipërm nga ana juaj lidhur me rekomandimin 5, theksojmë se, bazuar në nenet 9, 14, si dhe pika 2 e nenit 22 të Ligjit nr. 45/2019 për mbrojtjen civile, Ministria e Kulturës ka krijuar Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, por nuk ka hartuar planin e emergjencave civile, për të zvogëluar pasojat negative të diktura në raste fatkeqësish natyrore dhe luftrash duke garantuar mbrojtjen e monumenteve të kulturës. Sqarojmë se është përgjegjësi institucionale respektimi dhe përmbushja e detyrimeve ligjore.

Gjetje nga auditimi:

1. Ministria e Kulturës nuk ka krijuar Komitetin Ndërmënyësor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës (KNZSKK). Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, në cilësinë e sekretarisë teknike nuk ka realizuar detyrat funksionale brenda afateve ligjore të parashikuara.

2. Ministria e Kulturës nuk ka hartuar planet e veprimit për zbatimin e strategjisë nga institucionet kulturore të varësisë, planet e veprimit për zbatimin e strategjisë në nivel vendor, planet e veprimit për zbatimin e strategjisë në fushën e turizmit kulturor, planet e veprimit për zbatimin e strategjisë përmes digjitalizimit të shërbimeve dhe produkteve kulturore, planet e veprimit për përcaktimin e të dhënave statistikore për sektorin e kulturës, planet e menaxhimit të pasurive kulturore.

3. Ministria e Kulturës nuk ka hartuar dhe miratuar komentarin dhe manualin e përkufizimeve sikundër kërkohet ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

4. Ministria e Kulturës nuk ka hartuar dhe propozuar pranë organeve përgjegjëse aktin nënligjor përkatës për krijimin e Inspektoriatit Kombëtar Përgjegjës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

5. MK nuk ka hartuar dhe propozuar për miratim pranë organeve vendimmarrëse përkatëse VKM për deklarimin e qendrave historike, përcaktimin e zonave mbrojtëse të tyre dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e tyre në të gjithë Republikën e Shqipërisë, sidomos ato që përfshihen në UNESCO, për të ruajtur integritetin e pasurive kulturore, për të shmangur abuzimet dhe ndërtimet pa leje në to, duke garantuar imazhin dhe identitetin kombëtar. Gjithashtu nuk ka propozuar rishikimin e VKM për shpalljen e zonave arkeologjike në qytetin e Vlorës dhe miratimin e rregullores së administrimit.

6. MK nuk ka hartuar një plan të emergjencave civile, sikundër kërkohet nga ligji për mbrojtjen civile, por ka krijuar Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.

7. Në MK reformat dhe ndryshimet strukturore kanë bërë që struktura aktuale e saj të mos jetë funksionale për mënyrën e organizimit të stafëve dhe menaxhimit të tyre, pasi vijohet të punohet sipas formës së organizmit të strukturave të mëparshme. Drejtoritë e përmbajtjes si dhe drejtoritë e tjera kanë kapacitete të ulëta për të përballuar një volum të konsiderueshëm pune.

8. MK nuk ka hartuar dhe propozuar për miratim Planin Kombëtar të Peizazhit, si dhe aktet nënligjore lidhur me peisazhin, për shkak të mungesës së stafit teknik të peizazhit.

9. MK ka hartuar dhe ka propozuar me vonesë miratimin e 35 aktet nënligjore të parashikuara në planin analitik për periudhën 2019 - 2021, paraqitur në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur projekt-raportit, duke rezultuar në miratimin e tyre jashtë afateve të parashikuara. Gjithashtu, Ministria e Kulturës nuk ka hartuar dhe propozuar për miratim edhe 31 aktet nënligjore të tjera të parashikuara po në planin analitik për periudhën 2019 në 2021.

Konkluzione

1. Mungesa e KNZSKK ka bërë që Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, e cila ka për detyrë ndërmarrjen e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin e planit të veprimit dhe realizimin e masave të parashikuara në dokumentin strategjik, si dhe raportimin periodik të zbatimit të tyre në çdo dy vite, të mos realizojë detyrat brenda afateve ligjore të parashikuara. Në MK nuk ka një situatë të qartë lidhur me nivelin e zbatimit të dokumentit strategjik dhe të vlerësimit të objektivave specifike, me informacione për indikatorët e përcaktuar, arritjet,

problematikat, rreziqet dhe elementet tjera me rëndësi për procesin e zhvillimit të sektorit të kulturës dhe menaxhimin e monumenteve të kulturës. Në këto kushte nuk mund të realizohet qëllimi strategjik i qeverisë shqiptare për artin dhe kulturën dhe vizioni i saj që trashëgimia kulturore të shërbejnë si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit.

2. Duke qenë se, ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë është një ligj voluminoz, në kushtet e mungesës së komentarit dhe manualit të përkufizimeve, akteve nënligjore, komunikimit institucional dhe ndërinstitucional, menaxhimi i zinxhirit të proceseve lidhur me pasuri kulturore nuk ka rezultuar efektiv gjë e cila ka sjellë dëmtimin dhe zhdukjen e tyre. Gjithashtu në mungesë të IKMTK dhe të zyrave të regjistrimit të pasurive kulturore në DRTK-të, për shkak të numrit të madh të objekteve, të shpërndarjes gjeografike të tyre, të stafeve të kufizuara dhe infrastrukturës së dobët për inspektimin e tyre në terren, regjistrimi i pasurive kulturore në Regjistrin Kombëtar të Pasurive, identifikuar me çertifikatën e vet të pasurisë ka rezultuar jofektiv, siç u deklarua dhe nga takimet në DRTK-të. Disa monumente kulture nuk janë të inventarizuara pasi nuk janë aktive për shkak të mungesës së pronësisë.

3. Mos rishikimi i VKM-së për shpalljen e zonave arkeologjike në qytetin e Vlorës dhe miratimin e rregullores së administrimit, vonesat në hartimin e rregullores për DRTK në të tjerë, kanë sjellë problematika në zonat e mbrojtura në qytetet respektive. Vonesat në miratimin e vendimeve lidhur me deklarin e qendrave historike, përcaktimin e zonave mbrojtëse të tyre, miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e tyre dhe koordinimi i ulët institucional me NJVQV ka ndikuar negativisht në këtë proces. për të ruajtur integritetin e pasurive kulturore, perspektivën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin, ka bërë që të mos shmangen abuzimet dhe ndërtimet pa leje në to.

4. Mungesa e planit të emergjencave civile të MK, përbën rrezik kombëtar për ruajtjen, mbrojtjen, menaxhimin dhe administrimin e monumenteve të kulturës në raste fatkeqësish natyrore.

5. Në mungesë të planeve kombëtare të peizazhit, sipas dispozitave të ligjit për trashëgiminë kulturore, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara, zonat e mbrojtura po rezikohen çdo ditë dhe më shumë nga ndërhyrjet pa leje brenda tyre. Duke qenë se kontrata e rijetëzimit lidhet për një kohëzgjatje deri në 20 vjet, me të drejtë rinovimi vetëm një herë, nëse subjekti ka përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet kontraktuese, në kushtet ku shumë objekte të trashëgimisë kulturore në kartelat e pasurisë së tyre pranë DRTK-ve figurojnë pa pronar, pasi nuk kanë certifikatë pronësie dhe nuk ka bazë ose hapësirë ligjore që të mundësojë ndërhyrjen e institucioneve të specializuara.

Rekomandime

1. MK të marrë masa për funksionimin e Komitetit Ndërmintor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës (KNZSKK) dhe Sekretarisë Teknike të tij, Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, për të garantuar një menaxhim më efektiv të monumenteve të kulturës. MK në bashkëpunim me institucionet e varësisë të fillojë punën për hartimin e planeve konkrete të veprimit për zbatimin e strategjisë nga institucionet kulturore të varësisë, planet e veprimit për zbatimin e strategjisë në nivel vendor, planet e veprimit për zbatimin e strategjisë në

fushën e turizmit kulturor, planet e veprimit për zbatimin e strategjisë përmes digjitalizimit të shërbimeve dhe produkteve kulturore, planet e veprimit për përcaktimin e të dhënave statistikore për sektorin e kulturës, planet e menaxhimit të pasurive kulturore, sipas prioriteteve dhe fushës së kompetencës.

Dhjetor 2023

2. MK në bashkëpunim me institucionet e varësisë, institucionet akademike kërkimore-shkencore dhe institucionet kompetente ligjore, të ngrejë një grup pune për hartimin dhe miratimin e komentarit dhe manualit të përkufizimeve.

Dhjetor 2023

3. MK të rishikojë VKM nr. 729 dt. 01.09.2010 për shpalljen e zonave arkeologjike në qytetin e Vlorës dhe miratimin e rregullores së administrimit, si dhe të përshpejtojë punën me ministritë e linjës për miratimin e VKM-së për deklarinë e qendrave historike, përcaktimin e zonave mbrojtëse të tyre dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e tyre, në të gjithë Republikën e Shqipërisë, sidomos ato që përfshihen në UNESCO, për të ruajtur integritetin e pasurive kulturore, për të shmangur abuzimet dhe ndërtimet pa leje në to, duke garantuar imazhin dhe identitetin kombëtar.

Dhjetor 2023

4. MK, në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të hartojë planin e emergjencave civile, për të zvogëluar pasojat negative të diktuar në raste fatkeqësish natyrore dhe luftrash duke garantuar mbrojtjen e monumenteve të kulturës.

Qershor 2023

5. MK, për kontrollin e zonave të mbrojtura si dhe dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda tyre, në kuadrin e planeve të veta sektoriale, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, të propozojë, hartojë dhe miratojë planet kombëtare të peisazhit, sidomos për ato që përfshihen në UNESCO, si dhe të marrë masat për rekrutimin e stafit teknik të peisazhit, nevojë dhe domosdoshmëri për hartimin e këtyre planeve dhe menaxhimin e zinxhirit të proceseve për administrimin e monumenteve të kulturës.

Qershor 2023

6. MK të miratojë aktet nënligjore për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurive kulturore dhe të hartojë kuadrin e plotë rregullator për dhënien në përdorim të tyre me qëllim rijetëzimin në të gjitha format e përdorimit të tyre.

Qershor 2023

7. MK të hartojë dhe të dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave 31 aktet nënligjore të parashikuara në planin analitik për periudhën 2019 -2021, paraqitur në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij raporti auditimi.

Qershor 2023

4.2 A ka rezultuar i përshtatshëm funksionimi dhe koordinimi i institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës?

4.2.1 A janë ngritur dhe funksionojnë institucionet përgjegjëse për mirëmenaxhimin e monumenteve të kulturës?

Menaxhimi i monumenteve të kulturës, si objekte të trashëgimisë kulturore materiale kryet nga autoritetet shtetërore qendrore, autoritetet e vetëqeverisjes vendore, institucionet e specializuara, etj. të cilat së bashku formojnë sistemin kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore.³⁷ Në nivel qendror ligji identifikon Ministrinë e Kulturës, si organin qendror politik - bërës në këtë fushë, si dhe Inspektoratin Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Disa nga institucionet e specializuara të përfshira në këtë sistem janë Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, si dhe 6 Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore.³⁸

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKTK) është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore që ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.

Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (në vijim DRTK) janë institucione rajonale të specializuara, tekniko - administrative, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ato administrojnë.³⁹ Me VKM nr. 531, datë 28.08.2019 për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore janë krijuar 6 DRTK me seli në Tiranë, Vlorë, Korçë, Berat, Gjirokastrë dhe Shkodër. Këto institucione monitorohen dhe koordinohen për të kryer punën e tyre IKTK, si njësi përgjegjëse për mbarrëvajtjen e tyre.

DRTK ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas qarqeve, si më poshtë:

Tabela nr. 10

Nr.	Përshkrimi	Qarku/Bashkia	Nr. Mon.		Tot.	Z.M. ⁴⁰
			Kat. I	Kat. II		
1	DRTK Tiranë	Q. Tiranë, Q. Durrës, Q. Dibër	167	211	378	32
2	DRTK Shkodër	Q. Shkodër, Q. Lezhë, Q. Kukës	212	18	230	27
3	DRTK Vlorë	Q. Vlorë, Q. Fier	222	-	222	40
4	DRTK Korçë	Q. Korçë, Q. Elbasan	286	18	304	47

³⁷ Neni 26, ligji nr. 27/2018 për trashëgiminë kulturore dhe muzetë

³⁸ Pjesë e sistemit kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore janë edhe institucione të tjera të specializuara (si për shembull Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Arteve, Instituti i Arkeologjisë), të cilat nuk janë pjesë e këtij auditimi për shkak se tema e auditimit është e kufizuar tek monumentet e kulturës.

³⁹ Neni 31, ligji nr. 27/2018.

⁴⁰ Zona të mbrojtura.

5	DRTK Berat	Qendra Historike Berat (UNESCO), B. Ura Vajgurore, Berat, Kuçovë, Skrapar, Poliçan	123	356	479	5
6	DRTK Gjirokastrë	Qendrën Historike Gjirokastrë (UNESCO), B. Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Dropull	221	329	550	23
TOTAL			1231	932	2163	174

Aktualisht në vendin tonë ka rreth 2161 monumente kulture nga të cilat, 1231 janë monumentet e kulturës së kategorisë së parë dhe 932 monumente të kategorisë së dytë, si dhe 174 zona të mbrojtura të shpallura.

DRTK Gjirokastrë është drejtoria rajonale që ka në përgjegjësi mbrojtjen dhe administrimin e më shumë monumenteve në rang republike, nisur edhe nga fakti se Qendra Historike e qytetit të Gjirokastrë është e mbrojtur nga UNESCO. Vijon pas saj Drejtoria rajonale e Beratit e cila ka nën përgjegjësinë e saj 479 monumente kulture.

Strukturat dhe organikat e këtyre drejtorive janë miratuar me Urdhrin e kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, nga ku evidentohet se këto institucione funksionojnë me struktura pothuajse të unifikuara dhe me numër punonjësish të reduktuar.

Tabela nr. 11

Nr.	Përshkrimi	Nr. punonjësish	Shënime
1.	DRTK Tiranë	20	Shënime
	- Drejtor	1	
	- Sektori i arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore	12	
	- Sektori i Krujës	2	
	- Sektori i Dibrës	2	
	- Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	3	
	- Sektori i mirëmbajtjes	2	
2.	DRTK Vlorë	36	Shënime
	- Drejtori	1	
	- Sektori i arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore	9	
	- Sektori i Sarandës	8	
	- Sektori i Himarës	2	
	- Sektori i Parqeve Amantia, Orikum, Finiq, Antigonea	10	
	- Sektori i Fierit	3	

	- Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	3	1 përgjegjës sektori, 1 specialist, 1 punonjës pastrimi
3.	DRTK Shkodër	22	Shënime
	- Drejtori	1	
	- Sektori i arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore	9	5 specialistë, 1 restaurator, 3 mirëmbajtës (Sektori nuk ka përgjegjës të miratuar në strukturë)
	- Sektori i parkut arkeologjik (Rozafa, Lezhë)	7	1 përgjegjës sektori, 2 specialist arkeolog, 3 mirëmbajtës
	- Sektori i Kukësit	2	1 specialist, 1 mirëmbajtës
	- Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	3	1 përgjegjës sektori, 1 specialist, 1 punonjës pastrimi
4.	DRTK Korçë	26	Shënime
	- Drejtori	1	
	- Sektori i arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore	12	1 përgjegjës sektori, 4 specialist, 2 restaurator, 5 mirëmbajtës
	- Sektori i Elbasanit	4	2 specialist, 1 restaurator, 2 mirëmbajtës
	- Sektori i Pogradecit	2	1 specialist, 1 mirëmbajtës
	- Sektori i Kolonjës	2	1 specialist, 1 mirëmbajtës
	- Sektori i Bilishtit	2	1 specialist, 1 mirëmbajtës
	- Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	3	1 përgjegjës sektori, 1 specialist, 1 punonjës pastrimi
5.	DRTK Gjirokastrë	30	Shënime
	- Drejtori	1	
	- Sektori i arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore	13	1 përgjegjës sektori, 4 specialist, 1 restaurator, 7 mirëmbajtës
	- Sektori i Përmetit	2	1 specialist, 1 mirëmbajtës
	- Sektori i Tepelenës	2	1 specialist, 1 mirëmbajtës
	- Sektori i menaxhimit të qendrës historike – qendër e trashëgimisë botërore (UNESCO)	2	1 specialist, 1 specialist për Gjirokastrën
	- Sektori i menaxhimit të parqeve arkeologjike (Antigonesë, Adreanapolis)	7	1 përgjegjës sektori, 1 specialist, 1 restaurator, 4 mirëmbajtës
	- Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	3	1 përgjegjës sektori, 1 specialist, 1 punonjës pastrimi

6.	DRTK Berat	24	Shënime
	- Drejtori	1	
	- Sektori i arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore	15	1 përgjegjës sektori, 4 specialist, 1 specialist për qendrën historike UNESCO , 2 restaurator, 7 mirëmbajtës
	- Sektori Skrapar - Kuçove	3	1 specialist, 2 mirëmbajtës
	- Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	5	1 përgjegjës sektori, 1 specialist, 1 biletashitës, 1 roje, 1 punonjës pastrimi
TOTAL		158	

Konkretisht, sikurse është pasqyruar edhe më sipër në tabelë, të gjitha DRTK kanë nga një sektor të arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore, nga një Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse dhe sipas veçorive të territorit dhe monumenteve kanë sektorë të tjerë të orientuar si për shembull në rastin e DRTK Tiranë e cila ka sektorin e Krujës dhe të Dibrës.

DRTK Vlorë, Shkodër dhe Gjirokastrë kanë në strukturë nga një sektor për menaxhimin e parqeve arkeologjike. DRTK Gjirokastrë ka në strukturë **sektorin e menaxhimit të qendrës historike – qendër e trashëgimisë botërore (UNESCO)** me 2 specialistë, ndërsa DRTK Berat që është e ngjashme me Gjirokastrën në këtë drejtim nuk ka një sektor të dedikuar, por **1 specialist për qendrën historike UNESCO** të përfshirë në sektorin e arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Konstatohet nga auditimi se vetëm në DRTK Shkodër, sektori i arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore nuk ka të parashikuar në strukturë një përgjegjës sektori, por është i përbërë nga 5 specialist, 1 restaurator dhe 3 mirëmbajtës dhe varet direkt nga titullari i institucionit. Për periudhën objekt auditimi titullarët e DRTK Shkodër nuk kanë pasur profilin e studimit të përshtatshëm për të favorizuar një mbarëvajtje optimale të punës së një institucioni të specializuar me një profil të veçantë teknik siç është drejtoria rajonale e trashëgimisë kulturore. Për vitet 2019 në 2020, titullari ka pasur profilin gjuhë në letërsi, ndërsa për vitin 2021 e në vijim profili është Gazetari në Komunikim. Gjithashtu në kuadër të unifikimit të strukturave të synuar edhe nga urdhri i Kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 nuk del e qartë arsyeja se përse ky sektor është lenë pa përgjegjës vetëm në DRTK Shkodër.

Nga komunikimet e vazhdueshme me DRTK si dhe nga përgjigjet e pyetësorëve është evidentuar se shpërndarja gjeografike e monumenteve që ato kanë nën administrim është e përhapur dhe shumë prej tyre janë të pa aksesueshëm, sidomos gjatë muajve të dimrit, kur edhe kushtet atmosferike nuk lejojnë që punonjësit të shkojnë në zonat më të largëta. Gjithashtu është konstatuar se DRTK nuk janë të pajisura mjaftueshëm me mjete pune për të kryer aktivitetet e mirëmbajtjes rutinë, si dhe makinat në dispozicion të stafit për të kryer inspektime periodike të monumenteve të kulturës nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar çdo monument në territor. DRTK nuk kishin të përcaktuar një periudhë kohore minimale, si për shembull sa herë në vit, apo në tre muaj apo në gjashtë muaj parashikohet që të inspektohet apo mirëmbahet çdo monument në territorin përkatës. Shpesh herë, sikundër ka rezultuar edhe gjatë këtij auditimi, DRTK vihen në dijeni të problematikave lidhur me monumentet në mbrojtjen dhe administrimin e tyre si

pasojë e reklamimit të ngjarjeve në mediat lokale, apo sepse sinjalizohen nga qytetarë dhe dashamirës.

Pavarësisht faktit se, siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme fuqia punëtore (numër monumentesh për punonjës për secilën DRTK) duket në aparencë e mjaftueshme për të siguruar një mbulim të përshtatshëm të monumenteve, në realitetin e punës së përditshme të këtyre institucioneve evidentohet konkretisht mungesë burimesh njerëzore të specializuara të cilat të kenë në fokus mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale në vendin tonë. Në tabelën e mëposhtme grupi i auditimit ka marrë në konsideratë të gjitha DRTK duke analizuar shtrirjen gjeografike të monumenteve, numrin total të tyre dhe numrin e punonjësve (pa përfshirë shërbimet mbështetëse dhe titullarët e institucioneve) që këto DRTK kanë në dispozicion me qëllim përlogaritjen e numrit të monumenteve për 1 punonjës.

Tabela nr. 12

Tabela nr. 12						
Nr.	DRTK	Qarku/Bashkia	Sipërfaqja	Nr. Mon.	Nr. Punonj.	Nr. Mon për Punonjës
1	Tiranë	Q. Tiranë	1,586	266	12	22
		Q. Durrës	2,586	24	2	12
		Q. Dibër	766	88	2	44
TOTALI			4,938	378	14	27
2	Shkodër	Q. Shkodër	1,588	156	9	17
		Q. Lezhë	1,588	34	7	5
		Q. Kukës	2,373	40	2	20
TOTALI			5,549	230	18	13
3	Vlorë	Q. Vlorë	2,706	222	19	12
		Q. Fier	1,887	45	13	3
TOTALI			4,593	267	32	8
4	Korçë	Q. Korçë	3,711	171	18	10
		Q. Elbasan	3,278	133	4	33
TOTALI			6,989	304	22	14
5	Berat	Q. Berat	1,798	479	18	27
TOTALI			1,798	479	18	27
6	Gjirokastrër	Q. Gjirokastrër	2,884	550	26	21
TOTALI			2,884	550	26	21

Nga auditimi është evidentuar gjithashtu se profesionet e kërkuara në këto institucione janë specifike dhe rezultojnë në vështirë gjetja e burimeve të duhura njerëzore, sidomos në nivel rajonal dhe vendor në veçanti në vendin tonë, në kushtet kur arkitektët, inxhinierët etj synojnë të punojnë në kryeqytet ose në sektorin privat, edhe për arsye se trajtimi financiar i ofruar në nivel DRTK për specialistë apo përgjegjës sektori nuk ofron të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar, jo vetëm kostot e jetesës në ditët e sotshme, por vetëm mundin dhe burimet e investuara në arritjen e njohurive në ato fusha. Konkretisht një përgjegjës sektori në DRTK ka kategori IV ñ a me një pagë mesatare neto 54,800 lekë dhe bruto 67,200 lekë, ndërsa specialisti kategoria IV ñ b me një pagë mesatare neto 45,000 lekë dhe bruto 54,000 lekë. Ky është trajtimi financiar që i garantohet specialistëve dhe stafëve teknike të ngarkuar me mbrojtjen dhe mirë administrimit e këtyre monumenteve.

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, më poshtë referuar IKRTK-ja, është institucion kombëtar i specializuar i trashëgimisë kulturore në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Krijimi i këtij institucioni është parashikuar në nenin 32 të ligjit nr. 27/2018. Me VKM nr. 432, datë 26.06.2019 óPër funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore është përcaktuar mënyra e funksionimit të këtij institucioni. Ky institucion, ndër të tjera ka për mision krijimin, ruajtjen e përditësimin e Regjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore, në formë elektronike dhe të shkruar. Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore përfshinë të gjitha pasuritë kulturore, qofshin ato materiale apo jo materiale. Të dhënat e regjistruara në këtë bazë të dhënash ruajnë të gjithë informacionin mbi objektet e pasurisë kulturore kombëtare, si dhe Statusin e Objekteve Pasuri Kulturore (Trashëgimi Kulturore/Materiale/Jo Materiale/E Luajtshme/E Paluajtshme/në ruajtje, ekspozim, denoncuar e humbur, vjedhur, etj), Pronësinë, transaksionet mbi lëvizjet e objekteve, mbi lejet që jepen në lidhje me lëvizjen e objekteve për ekspozim, restaurim, etj, restaurimet që i bëhen objekteve, Dokumentet që krijohen për objektet etj).

IKRTK - ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sa i takon regjistrimit, katalogimit informatik, dokumentimit, vlerësimit, promovimit të trashëgimisë kulturore; monitorimit të respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare brenda e jashtë Republikës së Shqipërisë.

Observacionet e subjektit

1. Në lidhje me rekomandimin 13, Ministria e Kulturës sqaron se: Referuar dhe në zbatim të ligjit nr. 27/2018 óPër Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, procedurat e vlerësimit të interesit kulturor dhe çmimeve të referencës së objekteve pasuri kulturore kryhen përmes komisionit këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, i cili ende nuk është ngritur. Për sa i përket akteve autorizuese për vënien në funksion të këtij komisioni, IKRTK ka hartuar dhe përcjellë pranë Ministrisë së Kulturës projektpropozimet për ngritjen e komisionit këshillimor (pasuritë e luajtshme, paluajtshme, jomateriale).

2. Lidhur me rekomandimin 14, institucioni përgjegjës për regjistrimin, inventarizimin, dokumentimin dhe katalogimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale, përgjatë periudhës 1995 - 2022 ka kryer procedurat e regjistrimit inventarizimit të objekteve pasuri kulturore në posedim të institucioneve shtetërore. Në kuadër të përditësimit të të dhënave në regjistrimet e kryera ndër vite në Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, IKRTK me

shkresat si vijon: nr. 526 prot. datë 02.11.2021, drejtuar Institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës, dhe nr. 15 prot., datë 11.01.2022, drejtuar Bashkive të Republikës së Shqipërisë, ka ndërmarrë nismën për përditësimin e të dhënave, proces i cili vijon ende me vështirësitë e tij pasi sikurse cituar edhe në konkluzionin nr. 10 të auditit, ÓOrganika e reduktuar e Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore ka ndikuar drejtpërsëdrejti në pamundësinë për të kryer funksionet për të cilat ky institucion është krijuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit

1. Lidhur me këtë çështje grupi i auditimit gjykon se IKRTK së bashku me MK duhet të vijojnë në këtë drejtim me qëllim miratimin e këtij projektpropozimi dhe nisjen e procesit.
2. Lidhur me sa më sipër grupi i auditimit gjykon që përpjekjet në tërësi në drejtim të popullimit të regjistrit kanë qenë të vakëta dhe se duhet vijuar puna në drejtim të popullimit të regjistrit me mjetet dhe burimet në dispozicion deri në zgjidhjen më të mirë të problematikave.

10. IKRTK si institucion i specializuar i ngarkuar me menaxhimin e Regjistrit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, inventarizimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore funksionon me një strukturë të reduktuar me 8 punonjës në total. Ky institucion ende nuk ka shtrirë veprimtarinë në nivel rajonal (zyrat rajonale dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, të cilat duhet të funksionojnë pranë DRTK ñ ve). Zyrat rajonale fillimisht janë atashuar pranë DRTK ñ ve dhe janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme për të funksionuar, por procesi ka mbetur në këtë fazë, pasi në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe të organikës së tij nuk është parashikuar shtrirja vendore e këtij institucioni, sikundër kërkohet nga ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

11. Në Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore nuk janë të regjistruar të gjithë monumentet që kanë klasifikimin ómonument kultureó sipas përcaktimeve të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme nuk ka filluar ende, pavarësisht ekzistencës së Regjistrit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, kartelave të monumenteve të kulturës dhe detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. IKRTK ka nisur së fundmi procesin e përditësimit të regjistrit kombëtar⁴¹ duke iu drejtuar konkretisht Bashkive Divjakë, Fier, Lushnjë, Mallakastër, Patos dhe Rroskoveç⁴², në kuadër të bashkëpunimit që duhet të ketë me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e tjera publike dhe private, që kanë në administrim pasuri kulturore, për të siguruar katalogimin e pasurive kulturore dhe për të koordinuar aktivitetet në këtë fushë.

12. DRTK ñ të janë ngritur dhe funksionojnë me struktura pothuajse të unifikuara dhe numër punonjësish të reduktuar, trajtim financiar jo atraktiv për profesionistët e rinj, duke mos reflektuar ngarkesën e punës në raport me sipërfaqen që ato mbulojnë, numrin e monumenteve që kanë në mbrojtje e administrim, dhe mjetet e punës në dispozicion të tyre. Në rastin e DRTK Shkodër është evidentuar se sektori i arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore

⁴¹ Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Neni 25 - Detyrimet e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore të luajtshme, Neni 32 - Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore. Neni 56 - Inventarizimi dhe katalogimi i pasurive kulturore, Neni 228 - Konservimi dhe restaurimi i objekteve dhe dokumentacionit muzeor.

⁴² Shkresa e IKTK nr. 15, prot., datë 01.01.2022.

nuk ka të parashikuar në strukturë një përgjegjës sektori, por është i përbërë nga 5 specialistë, 1 restaurator dhe 3 mirëmbajtës.

13. MK nuk ka parashikuar profesionet e përshtatshme në përzgjedhjen e stafit drejtues në DRTK, nisur edhe nga fakti se këto janë institucione të specializuara teknike në të cilat kërkohet një nivel i lartë ekspertize.

Konkluzione:

6. Unifikimi i strukturave të DRTK në ve në organikë dhe numër punonjësish nuk ka i ka shërbyer Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore të kryejnë funksionet e tyre duke mos siguruar mbulim në territor për të gjithë monumentet e kulturës që ato duhet të mbrojnë dhe administrojnë.

7. Mospërcaktimi i qartë i individëve me arsimin e përshtatshëm në nivel të DRTK në ve ka penalizuar veprimtarinë e këtyre institucioneve, pasi jo gjithmonë ka mundur rekrutimin e stafit që i përgjigjet pozicioneve teknike që kërkohen në DRTK.

8. Sistemi i pagave të vendosura në të gjithë sistemin kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore nuk nxit interesin e profesionistëve të rinj kundrejt këtyre institucioneve, sidomos në nivel vendor ku edhe vet oferta për këto profesione është reduktuar si rezultat i lëvizjeve drejt qyteteve të mëdha të profesionistëve të rinj.

9. Mungesa e përgjegjës të sektorit në sektorin e arkeologjisë, artit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe varësia direkte e sektorit nga titullari i institucionit, ka ndikuar në mbarëvajtjen e përditshmërisë së punës në DRTK Shkodër, duke qenë se titullarët nuk kanë qenë profesionistë të fushës së trashëgimisë kulturore.

10. Organika e reduktuar e Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore ka ndikuar drejt për së drejti në pamundësinë për të kryer funksionet për të cilat ky institucion është krijuar.

11. Mosparashikimi i zyrave rajonale në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe të srganikës së IKRTK - së ka penalizuar ngritjen dhe funksionimin e tyre, pasi që në fillim ky institucion është konceptuar si i cunguar.

12. Moshedhja e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore materiale të paluajtshme në Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore përbën risk konkret për trashëgimin e kujtesës kombëtare të këtyre pasurive të paluajtshme, pasi procesi menaxhohet vetëm nëpërmjet kartelave të monumenteve të hartuara dhe përditësuara nga DRTK në të.

13. Mos nisja nga ana e IKRTK e procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të trashëgimisë të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme, përveçse është në kundërshtim me ligjin, nuk siguron transparencë për institucionet e tjera të përfshira në të gjitha hallkat e sistemit kombëtar të kujdesit ndaj trashëgimisë kulturore.

Rekomandime

8. MK, në bashkëpunim me DRTK ñ të dhe IKRTK - në, të ngrejë një grup pune të posaçëm për të rishikuar strukturat aktuale të këtyre institucioneve me qëllim korrigjimin e devijimeve të evidentuara gjatë këtij auditimi, por edhe bazuar në nevojat konkrete të shprehura nga to.

Dhjetor 2023

9. MK, në vijim të konkluzioneve të nxjerra nga grupi i punës për rishikimin e strukturave dhe organikave të DRTK ñ ve dhe IKRTK - së, të propozojë pranë autoritetit përkatës rishikimin e Urdhrit të Kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 óPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 136, datë 21.10.2019 óPër Miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

Dhjetor 2023

10. MK, në kuadër të rishikimit të strukturave dhe të organikave të institucioneve të riformulojë trajtimin financiar të punonjësve aktualë në sistemin kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore, duke synuar rivlerësimin monetar të këtyre pozicioneve të punës e duke propozuar nëse është e nevojshme edhe kalimin në shërbimin civil.

Dhjetor 2023

11. MK, në cilësinë e institucionit epror, të përcaktojë kritere të qarta për përzgjedhjen e stafit në institucionet e specializuara të sistemit kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore nëpërmjet një udhëzimi të posaçëm, duke synuar evidentimin e figurave profesionale të nevojshme për këtë sistem.

Qershor 2023

12. IKRTK, në cilësinë e institucionit përgjegjës për Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në bashkëpunim me institucionin epror të nisë procesin e inventarizimit dhe vlerësimit monetar të objekteve të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme.

Qershor 2023

13. IKRTK, në bashkëpunim me institucionet e tjera të specializuara dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të nisnin procesin e përditësimit të Regjistrit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në veçanti, sa i takon monumenteve të kulturës.

Qershor 2023

4.2.2 A ka gjeneruar veprimtaria e këtyre institucioneve përmirësim të proceseve të mirëadministrimit të monumenteve të kulturës?

Ministria e Kulturës është institucioni epror politikbërës në fushën e trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme. Ky institucion ushtron kompetencat e veta në këtë fushë⁴³, ndër të tjera duke hartuar strategjisë kombëtare të kulturës, duke hartuar planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore; duke koordinuar termat e referencës për planet e projektimit, ruajtjes dhe planet menaxhuese, skemat e ndarjes, planet dhe ndryshimet e tyre, rregullat e normat e tyre specifike dhe projektet e zhvillimit, në respekt me vlerat kulturore të paluajtshme, të vetme dhe të grupit, brenda kufijve të tyre dhe zonat e ruajtura, sipas rasteve të përcaktuara si

⁴³ Shih nenin 13 të ligjit nr. 27/2018 óPër trashëgimisë kulturore dhe muzetë.

më poshtë; ii. termat e referencës për projektimin e ndërtesave-muze dhe ekspozita të përhershme të saj; iii. projektet e zhvillimit për ndërtimin dhe vendosjen e monumenteve, strukturat monumentale - dekorative dhe elementet në hapësirat publike, në zonat urbane dhe jourbane, si dhe mënjanimin ose heqjen e tyre;

Ky institucion ka përgjegjësinë e administrimit të pronave publike me vlera kulturore si dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore⁴⁴ është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë. Ky institucion ka si mision gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale. Vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në fushat e përgjegjësisë, të trashëgimisë kulturore materiale; të arkeologjisë parandaluese të shpëtimit nëntokësor dhe nënujor; të pasurisë e peizazhit kulturor. IKTK ñ ja, ndër të tjera ka për detyrë të monitorojë dhe të koordinojë DRTK-të, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e tyre. Nëpërmjet sekretarisë teknike kryen verifikimet e natyrës teknike dhe siguron nga kërkuessit informacione të tjera shitesë në funksion të vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, lidhur me kërkesat për ndërhyrje. Ky institucion vendos për pezullimin e menjëhershëm të ndërhyrjeve me propozim të institucioneve të specializuara ose kryesisht konstaton kryerjen e punimeve në kundërshtim me ligjin etj..

Institucionet e specializuara të sistemit kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme janë të angazhuara në mënyrë konstante në përmirësimin e proceseve të administrimit të monumenteve të kulturës. Sikundër jemi shprehur përgjatë gjithë këtij materiali, institucionet e marra në konsideratë në këto procese kanë qenë kryesisht Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

Këto institucione kryejnë veprimtarinë e tyre bashkë me njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat janë të ngarkuara me bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në ushtrimin e funksioneve të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore , sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 në fushën e ruajtjes dhe të mbrojtjes të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme.

Sipas nenit 42 të ligjit nr. 27/2018 mbrojtja e trashëgimisë kulturore të paluajtshme në kuadër të planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nëpërmjet:

- regjimeve të ruajtjes, të cilat specifikohen në urdhrin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore., sipas parashikimeve të këtij ligji;
- planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë, me qëllim ruajtjen e pasurive kulturore të paluajtshme, si dhe rregullat specifike të lidhura me to;
- planet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme;
- vlerësim, në parim, të lejeve zhvillimore dhe dokumentacionin shoqërues të projekteve, iniciativat e investimeve e të projekteve të ndërhyrjes brenda zonave të mbrojtura, me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

Sipas nenit 43 të ligjit nr. 27/2018 regjimet e ruajtjes trashëgimisë kulturore të paluajtshme specifikohet në urdhrin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ndërsa regjimi i mbrojtjes së pasurisë kulturore të luajtshme, me vendndodhje në një pasuri kulturore të

⁴⁴ VKM nr. 364, datë 29.5.2019 óPër funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturoreó.

paluajtshme, përcakton vendndodhjen e pasurisë, shtrirjen territoriale, si dhe udhëzimet për ruajtjen e mirëmbajtjen e saj në pasurinë e paluajtshme ku ndodhet si dhe mjedisin përreth.

Në mbrojtjen dhe administrimin e monumenteve të kulturës si objekte të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme është i përfshirë edhe Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (më tej KKTKM ñ ja), si organ kolegjal⁴⁵, i cili ka për detyrë të miratojë projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim. Ky organ ka gjithashtu për detyrë:

- të mbikëqyrë veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit;
- të miratojë lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe lejet e parashikuara në këtë ligj;
- të miratojë, në parim, kërkesën për deklarimin e interesit kulturor;
- të miratojë, në parim, shpalljen e qendrave historike, të parqeve dhe zonave arkeologjike;
- të hartojë akte të karakterit të përgjithshëm, me qëllim sigurimin e uniformitetit të vlerësimit të interesit kulturor;
- të miratojë, të vlerësojë në parim planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore.

Nga përgjigjet e pyetësorëve dhe intervistat e zhvilluara në fazën e terrenit pranë DRTK ñ ve u konstatua se të gjithë monumentet e kulturës kanë kartelat e tyre identifikuese, të cilat rifreskohen nga stafet e DRTK ñ ve, por aktualisht asnjë nga këto institucione nuk ka nisur një proces inventarizimi të tyre.

DRTK, nëpërmjet punonjësve të tyre kryhen kontrollin teknik të objekteve dhe "inspektimin" e tyre, gjë e cila duhet të kryhet nëpërmjet zyrës së inspektimit që duhet të jetë e pranishme në DRTK në bazë të ligjit. Pas inspektimit hartohet raporti i inspektimit, kartelat e pasurive kulturore me bazë risku azhurnohen nga DRTK dhe dërgohen për informacion në IKTK dhe MK, për t'u përditësuar në Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, me qëllim krijimin e një tablle të qartë të objekteve, për të hartuar projektet e ndërhyrjes në to , në bazë risku.

DRTK çdo dy vjet dërgon informacion për kartelat e rishikuara në IKTK, por nuk ka vijimësi të këtij procesi , për t'u ruajtur, përditësuar në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore.

Shumica e këtyre monumenteve kanë problematika lidhur me pronësinë. Ky fenomen u konstatua edhe nga grupi i auditimit nga kërkimet e kryera në Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (databaza). Në checkimet e rastësishme të kryera nga grupi i auditimit në regjistrë rezultoi se për shumë objekte në pronësi të privatëve nuk kishte informacione të tjera shtesë përveç faktit që prona i përkiste privatit. Nuk përcaktohej as emri i pronarit, as certifikata e pronësisë me të gjithë elementët përkatës.

Po i njëjti konstatim u vërejt edhe në shqyrtimin e kartelave të monumenteve që mbanin DRTK ñ të respektive. Për ato monumentet në pronësi të shtetit (pronë shtet), në kartelat respektive nuk ishte vendosur institucioni përkatës i cili ka përgjegjësi administrimi të këtyre monumenteve. Në parim trashëgimia kulturore materiale e paluajtshme (dhe/ose trashëgimia kulturore në përgjithësi) bie në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Kulturës, por konkretisht ka rezultuar nga auditimi se monumentet e kulturës si asete nuk rezultojnë të jenë inventarizuar dhe regjistruar në bilancin e këtij institucioni apo edhe institucioneve të varësisë, siç janë për shembull DRTK ñ të të cilat janë të ngarkuara me mbrojtjen dhe administrimin e tyre. Nga ana

⁴⁵ Shih neni 37, ligji nr. 27/2018 óPër trashëgiminë kulturore dhe muzetëo.

tjetër, vet strukturat e MK në nuk kanë ditur ti përgjigjen pyetjeve të grupit të auditimit lidhur me përkatësinë institucionale të monumenteve të kulturës oporë shtetë.

Fakti që këto monumente ende nuk janë të regjistruara dhe inventarizuara si asete e për rrjedhojë nuk janë vendosur konkretisht në ngarkim të institucioneve në nivel qendror apo edhe vendor përbën risk konkret humbjen, shkatërrimin dhe/ose tjetërsimin e tyre. Në skenarin më të keq, ato lihen pas dore dhe degradojnë deri sa humbasin vlerat kulturore dhe arkitektonike e restaurimi ose rikthimi në gjendjen e mëparshme bëhet i pamundur, e këto hiqen nga lista e monumenteve të kulturës.

Monumentet e kulturës në pronësi të privatëve gjithashtu paraqesin problematika të tjera lidhur me pronësinë, pasi shumica e pronarëve janë të paidentifikuar, ose sepse janë spostuar jashtë vendit, ose kanë humbur interes mbi pronën, ose ka shumë bashkëpronarë në konflikt për titullin e pronësisë. Gjithë kjo situatë vetëm penalizon gjendjen e këtyre objekteve pasi në mungesë të elementit të pronësisë nuk mund të realizohen projektet e mirëmbatjes, ndërhyrjes, ruatjes dhe menaxhimit të monumenteve të kulturës për të cilat duhet aplikuar në IKTK dhe MK; nuk mund të zbatohet Fondi financiar për rijetëzimin e monumenteve të kulturës, ku një ndër kriteret kryesore për dhënie e këtij fondi është pajisja me certifikatë pronësie për monumentet.

Si rezultat i këtyre problematikave nga auditimi në terren është konstatuar shumë monumente janë lënë në harresë, disa nuk ekzistojnë më, shumë janë degraduar në gjendje të pa rrekuperueshme etj.

Në mungesë të krijimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, stafet e DRTK në ve janë të detyruar, deri në krijimin e këtij institucioni, të kryejnë edhe funksionet e inspektimit, detyrë kjo e cila i është ngarkuar DRTK në ve nga VKM nr. 531, datë 28.08.2019 Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, në pikën 4 të kreut IV ku thuhet se:

“DRTK - të do të kryejnë funksionet e inspektimit në territorin që mbulojnë deri në ngritjen e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore e muzetë dhe ligjin për inspektimin.”. Kjo situatë ngre shumë problematika thelbësore, pasi DRTK në të janë institucione të specializuara të një natyre teknike dhe kryejnë funksionin e inspektimit pa mjete dhe pa pasur në dorë mekanizmin e ndëshkimit (gjobë) ndaj subjekteve të cilat shkelin ligjin.

Nga ana tjetër, mbulimi i funksionit të inspektimi vetëm nga DRTK vështirëson procesin e ruajtjes së monumenteve, kontrollit teknik dhe vet inspektimit pasi, jo vetëm nuk janë alokuar fonde të veçanta për inspektim nga punonjësit e DRTK në ve, por edhe ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të cilat shprehin qartë mënyrën se si do të zhvillohet inspektimi në fushën e trashëgimisë kulturore në tërësi, e për atë materiale të paluajtshme që është objekt i këtij auditimi.

Mbi problematikat e evidentuar në territor gjatë auditimit për mbrojtjen dhe administrimin e monumenteve të kulturës

Në territorin e DRTK Berat, në lagjen Mangalem në territorin e ish sarajeve të pashait, gjatë kryerje së punimeve për zbërthimin e çatisë së shkollës óLlambi Goxhomani⁴⁶, e cila do të shembej në zbatim të projektit óBashkitë Berat dhe Përmet në Projekt ide, Projekt Zbatim dhe Supervizim për Rigjenerimin e integruar urban. Restaurim i peizazhit të historik urban të sheshit të Salamllekut të hartuar nga A.4 dhe K. me klient FSHZH e të miratuar me Vendim të

⁴⁶ DRTK Berat, Akt konstatim I datës 05.02.2021.

KKTKM nr. 162, datë 06.06.2020 për të rehabilituar hapësirën publike, ndodh shembje e menjëhershme e objektit e gjatë largimit të inerteve zbulohen gjurmët e një ndërtimi të vjetër.




Figura nr. 2 Shkolla Ll. Goxhomani óPamje e gjurmëve të ndërtimit të vjetërô (burimi DRTK Berat)

DRTK Berat, me shkresën nr. 27, prot., datë 05.02.2021, i përcjell aktkonstatimin përkatës IKTK për njoftuar mbi gjetjen e rastësishme. Me shkresën nr. 28, prot., datë 05.02.2021, DRTK i drejtohet Bashkisë Berat nëpërmjet një kërkesë për bashkëpunim, në të cilën kërkon që disa gurë me të cilët është ndërtuar shkolla e shembur i përkasin pikërisht objektit të zbuluar pas shembje dhe kërkohet që këto të ruhen nga bashkia në një ambient të posaçëm. DRTK gjithashtu i kërkon bashkisë që largimi i inerteve të kryehet me kujdes për të shmangur dëmtime të zbulimit si dhe sugjeron që të rishikohet projekti i rehabilitimit urban duke evidentuar edhe më shumë gjetjen arkeologjike e cila do ti shtonte vlera sheshit. Me shkresën nr. 92, prot., datë 28.03.2022 DRTK Berat i drejtohet IKTK dhe Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik, duke pasqyruar mendimet teknike mbi zbatimin e mëtejshëm të projektit nisur edhe nga fakti se ekziston i miratuar nga KKTKM me vendimin nr. 275, datë 08.06.2021 Koncepti i Gërmimit Arkeologjik për këtë projekt. Nisur nga ky konstatim DRTK kërkon që të vijojë gërmimi i plotë arkeologjik në vendin e zbulimit, në vijim të nisë procesi i konservimit. Pas përfundimit të gërmimit dhe konservimit të hartohet një material i cili të identifikojë qartë vlerat e zbulimit (sitit). Në përfundim të këtyre tre proceseve materialet e hartuara ti kalohen organeve vendimmarrëse (KKTKM dhe MK) me qëllim shpalljen e tyre monument kulture. Në vijim të rishikohet projekti fillestar në varësi të zbulime arkeologjike sikundër parashikohet edhe në Konceptin e Gërmimit Arkeologjik. Lidhur me sa me sipër, KKTKM dhe MK ende nuk janë shprehur zyrtarisht mbi procedurën që duhet ndjekur në këtë situatë.

Në territorin e DRTK Vlorë, Sektori i Sarandës me shkresën nr. 11, prot., datë 05.04.2022 ka raportuar pranë institucionit gjendjen e monumenteve óUra e gurtë e Tatzatit mbi lumin e Kalasës nën shkëmb, Tatzatô dhe óVarret (Varroshi), Vergoô.

Monumenti óUra e gurtë e Tatzatit mbi lumin e Kalasës nën shkëmb, Tatzatô, ndodhet ndërmjet fshatrave Kalasë dhe Tatzat. Ajo është e ndërtuar me mur guri me harqe dhe një sipërfaqe me

kalldrëm guri dhe shërbente për kalimin e lumit. Ka vetëm një hark me qemer në formë lundre me hapësirë rreth 9 metra. Gjatësia e urës është 18 metra. Kalldrëmi ka gjerësi 2.70 metra dhe pjerrësi nga të dy anët, me ngritje në pjesën e kiçit dhe me parapet. Nga Ura kanë ngelur vetëm kollonat anësore sepse është shëmbur në vitin 2008 dhe pjesa e sipërme është zëvendësuar me profile metalikë nga banorët e zonës. Statusin e Trashëgimisë Kulturore, Monument Kulture Kategoria e parë e ka marrë në 30.06.1983. Nga inspektimi i kryer është konstatuar ndërhyrje e karakterit ndërtimor të kryera nga pronari i një lokali aty pranë. Ndërhyrjet janë kryer në këmbën e urës në krahun e djathtë të saj.



Figura nr. 3 Pamje e këmbës së urës krahu i majtë, Burimi Grupi i Auditimit



Figura nr. 4 Pamje e ndërhyrjeve nga pronari i lokalit. (kryesisht betonim pranë krahëve të urës). Burimi Grupi i Auditimit

Nga momenti i shembjes së kësaj ure e deri në momentin e kryerjes së këtij inspektimi nga DRTK Vlorë nuk ka pasur ndërhyrje të çfarëdo lloji natyre për të rikuperuar çfarë mbetet nga ky objekt monument kulture i kategorisë së parë.

Gjatë inspektimit në terren të varreve monumentale në fshatin Vergo të Bashkisë Delvinë, është konstatuar ndërhyrje pa leje nga pronari i banesës pranë varreve monumentale. Pronari i banesës

në oborrin e të cilës gjenden dy varret ka bërë rrethimin e varreve me blloqe betoni duke i nxjerr jashtë rrethimit të banesës së tij.



Figura nr. 5 dhe 6 Pamje të murit rrethues të banesës. Burimi Grupi i auditimit

Evidentohet gjithashtu se për objektet e sipër përmendura nuk ka zonë të mbrojtur të shpallur e si rrjedhojë për këtë zbatohet Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 297, datë 31.07.2015 óPër shpalljen e zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturësó ku thuhet se zonë e mbrojtur quhet sipërfaqja e truallit brenda kufirit të pronës në të cilën ndodhet monumenti. Nëse kufiri i pronës përputhet me njollën e objektit zonë e mbrojtur konsiderohet:

- sipërfaqja e truallit rreth monumentit, diametri i së cilës përkon me distancën e parashikuar në rregulloren e planifikimit të territorit në fuqi, shumëzuar me koeficientin 1.01, në zonat urbane.
- sipërfaqja e truallit përreth monumentit me një gjerësi të vazhduar jo më të vogël se 100 metra në zonat rurale.

Në këto dy raste nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr. 297, datë 31.07.2015.

Nga ana tjetër konstatohet gjithashtu se urdhri nr. 297, i sipërpërmendur është miratuar në zbatim të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 óPër trashëgiminë kulturoreó, i ndryshuar, i cili tashmë nuk është më në fuqi.

Spektori i Sarandës në DRTK Vlorë ka hartuar një Relacion teknik të detajuar mbi monumentet e kulturës së territorit të Sarandës⁴⁷ për të cilat duhet ndërhyrje e vazhdueshme si në mirëmbajtje ashtu edhe në hartim projektsh, nga ku evidentohet se ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme në 36 monumente të administruara nga sektori i Sarandës:

⁴⁷ Relacion teknik të detajuar mbi monumentet e kulturës së territorit të Sarandës, mars 2022.

Për periudhën objekt auditimi DRTK Vlorë ka hartuar dhe dërguar institucioneve kompetente shumë shkresa lidhur me ndërhyrje të paaautorizuara në objekte monumente kulture në territorin që ky institucion administron nga evidentohen ndërhyrje pa leje në monumentet e kulturës, prishje të monumenteve gjatë zbatimit të projekteve të miratuara, kërkesa për pezullime punimesh etj nga të cilat mund të përmendim:

- objekti banimi 1 kat me kollona dhe soletë të ndërtuar së fundmi në zonën e mbrojtur B të parkut arkeologjik të Finiqit. Kjo problematikë nuk ka gjetur zgjidhje nga institucione të cilat u është drejtuar DRTK Vlorë⁴⁸;
- punime pa leje të Bashkisë Sarandë në zonat Arkeologjike A dhe B të qytetit të Sarandës;
- gërmime klandestine në varrezën tumulave të Himarës si dhe gërrime në shtratin e përroit të Korranit (Komisariatit të Policisë Vlorë ka referuar rastin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me nr. 921, prot., datë 05.05.2021);
- kërkesë pezullimi i punimeve të restaurimit të kishës së óShën Nikollësó në Porto Palermo, Himarë, pasi ato janë në kundërshtim me projektin e miratuar. Për këtë çështje DRTK Vlorë ka depozituar një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. 417, prot., datë 11.08.2020.
- vënie në dijeni të dëmtimit të monumentit të kulturës óTavani dekorativ në shtëpinë e Pirro Gjipopullitó i cili është restauruar në kuadër të projektit óRikualifikimi urban dhe restaurimi i objekteve në qendrën historike dhe zonën e mbrojtur fshatrat Dhërmió, konstatohet ndërtimi i çatië me strukturë betoni dhe zhvendosja e tavanit i cili nuk ndodhet më në objekt. Për sa më sipër, Fondi Shqipëtar i Zhvillimit me shkresë nr. 1634/1, prot., datë 03.08.2020, bazuar në óCertifikatën e Përfundimit të Punimeveó të lëshuar nga supervizuesi óA. Studioó, si dhe óCertifikatën e përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeveó nga Bashkia Himarë, e konsideron të mbyllur me sukses këtë projekt.

Edhe në DRTK Korçë janë evidentuar ndërhyrje të natyrave të ndryshme në monumentet e kulturës, si për shembull:

- evidentim i punimeve të paaautorizuara të karakterit ndërtimor në fshatin Rehove.⁴⁹
- kërkesë për pezullim punimesh në objektin sipas projektit me titull óRikonstruksion i pjesshëm i banesës 2 dhe 3 kate, ndërtim i shtesës anësore dhe rindërtim i katit të dytë, pasi nuk ka kontratë supervizimi për këtë projekt.
- ndërhyrje të paaautorizuara ndërtimore nga pronari në objektin monument kulture i kategorisë së dytë óVila Polena, për të cilat DRTK Korçë ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë.⁵⁰
- kërkesë për moslejim të bagëtive në oborret e kishave në fshatin Voskopojë. etj.

Në DRTK Gjirokastrë gjatë auditimit në terren u evidentua problematika e gjetjeve arkeologjike në Sheshin óÇerçiz Topullió. Me shkresën nr. 94. prot., datë 11.03.2021 DRTK Gjirokastrë i dërgon IKTK një relacion mbi gjetjet rastësore gjatë ndërtimit të parkimit nëntokësor në Sheshin

⁴⁸ Shkresa nr. 274, prot., datë 05.05.2021 óPër marrjen e masave të menjëhershme dhe prishjen e ndërtimeve pa lejeó, drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Vlorë, Komisariatit të Policisë Vlorë, Bashkisë Finiq, për Dijeni IKTK Tiranë ku kërkohet prishja e një objekti banimi 1 kat me kollona dhe soletë të ndërtuar së fundmi në zonën e mbrojtur B të parkut arkeologjik të Finiqit. Kjo problematikë nuk ka gjetur zgjidhje nga institucione të cilat u është drejtuar DRTK Vlorë.

⁴⁹ Shkresa nr. 124, prot., datë 07.03.2019, drejtuar Bashkisë Kolonjë, për dijeni IKTK.

⁵⁰ Kallëzim penal nr. 158, prot., datë 10.05.2021.

ÓÇerçiz Topulliô nga ku rezulton se pas inaugurimit të fillimit të punimeve, punimet kanë vijuar pa kryer lajmërimet përkatëse në DRTK nga firma BOE P. shpk dhe S. 98 shpk; sheshi i ndërtimit është i rrethuar me kangjella dhe është i pamundur aksesi në të, pasi ai ruhet nga punonjësit e firmës; objekti i gjetur është një pus me formë koni trung koni me murë guri rrethorë të thatë. Firma nuk ka njoftuar për këtë zbulim por DRTK ka marrë dijeni për këtë gjetje nëpërmjet burimeve të tërthorta (nuk citohet se si në shkresë). Më datë 11.03.2021 pusi është i mbushur me inerte të gërmimeve duke humbur çdo gjurmë të tij. Subjekti zbatues duhet të ketë në stafin e vet edhe një specialist arkeolog, por DRTK Gjirokastrë nuk disponon asnjë informacion lidhur me këtë gjë. Me shkresën nr. 214, prot., datë 20.05.2021, DRTK Gjirokastrë i drejtohet subjektit, për dijeni IKTK, për pezullim të menjëhershëm të punimeve në pjesën perëndimore të kantierit të ndërtimit të parkingut nëntokësor.

Me shkresën nr. 484/1, datë 15.04.2021, IKTK i drejtohet subjektit BOE P. shpk dhe S. 98 shpk, për dijeni Ministrisë së Kulturës, FSHZHnë, Bashkisë Gjirokastrë, DRTK Gjirokastrë duke thënë se në vijim të inspektimit të kryer nga grupi i punës i përbashkët midis DRTK dhe IKTK u konstatua se për shkak të inerteve të hedhura mbi të nga firma është i pamundur dokumentimi i tij. I kërkohet firmës ndërprerja e menjëhershme e punimeve dhe kthimi i pusit në gjendjen e mëparshme me qëllim vlerësimin dhe dokumentimin e tij sikundër kërkohet nga neni 145, pika 2 e ligjit nr. 27/2018 ÓPër trashëgiminë Kulturore dhe muzetëô.

Gjatë punimeve në shesh ka patur edhe zbulime të tjera arkeologjike siç edhe është evidentuar nga specialistët e DRTKnë në aktkonstatimin e mbatur më datë 18.06.2021 për vijimin e punimeve nga ku evidentohet se punimet vazhdojnë duke shkaktuar dëme të parikuperueshme në murin e zbuluar në atë zonë në shkelje të vendimit të KKTKMnë nr. 262, datë 08.06.2021, me atë të cili i kërkohet subjektit të kontraktojë një arkeolog të licencuar për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e zbulimeve arkeologjike aty.



Figura nr. 7 Foto realizuar më datë 26.05.2021 nga inspektorët e DRTK



Figura nr. 9 Foto realizuar më datë 18.06.2021 nga inspektorët e DRTK

Në ngjashmëri me drejtoritë rajonale të tjera edhe në DRTK Tiranë janë evidentuar ndërhyrje në monumentet e kulturës të natyrave të ndryshme si për shembull:

- Për projektin óRikonstruksion/rindërtim banese ekzistuese 1 katô, Zona A,Durrës, miratuar me Vendim të KKTKM-së nr. 396, dhe rishikuar nga KKTKM me Vendim nr. 442,datë 28.07.2021óNdryshim i projektit të miratuar: Rikonstruksion (rindërtim) i banesës ekzistuese 1 - kat me atiô, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike óAô të qytetit të Durrësitô, rezulton se projekti óRikonstruksion (rindërtim) i banesës ekzistuese 1 - kat me atiô i miratuar në KKTM me datë 28.07.2021, nuk është miratuar në Bashkinë e Durrësit.

- Pas një inspektimi në Kalanë e Dorëzit, (Pezë), më datë 21.07.2020 është konstatuar aktiviteti i një guroreje brenda zonës së mbrojtur të objektit shpallur me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr.46, datë 02.02.2015 Për shpallje Zonë të Mbrojtur për óKalaja e Dorëzitô, Pezë, Tiranë. Aktiviteti i kësaj guroreje shtrihej në 2-3 pika mbi sipërfaqen e kodrës dhe zonës së mbrojtur. Në kantier u evidentuan makineri të rënda që ngarkonin materialin guror dhe fadroma që punonin për nxjerrjen e materialit. Në vend ishin të instaluara edhe makineri për thyerjen dhe fraksionimin e gurit. Kjo problematikë është e mbartur ndër vite nga ana DRTK Tiranë



Figura nr. 10 Gurore pranë Kalasë së Dorezit në Pezë (Tiranë) Burimi DRTK Tiranë

Nga auditimi në terren pranë DRTK Shkodër janë evidentuar gjithashtu problematika të ngjashme me drejtoritë e tjera nga ku mund të veçojmë disa raste si më poshtme:

- Nga inspektimet e DRTK është konstatuar se Banesa Shtetërore Ish N. Z., sipas procesverbalit nr. 23/2, prot., datë 18.01.2022, monument kulture i kategorisë së parë nuk ekziston më. Për këtë konstatim DRTK i ka dërguar shkresën nr. 23/3, prot., datë 18.01.2022 Bashkisë Lezhë, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Lezhë, Drejtorisë së Policisë Lezhë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për dijeni Ministria e Kulturës dhe IKTK, një kërkesë për informacion lidhur me këtë ngjarje. Me shkresën nr. 23/4, prot., datë 18.01.2022 i është drejtuar ASHK Lezhë, për dijeni IKTK dhe Ministria e Kulturës, një kërkesë për informacion mbi statusin juridik të këtij objekti. DRTK nuk ka marrë përgjigje për këtë problematikë.

1. Në zbatim të programit të auditimit të performancës nr. 100/1, datë 06.04.2022 me temë "Mbrojtja dhe Administrimi i Monumenteve të Kulturës", i cili po zhvillohet në Ministrinë e Kulturës dhe në institucionet e varësisë: Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, IKTK dhe IKRTK, audituesit e grupit të auditimit kanë kryer një verifikim në Shkodër si rezultat i një ankese paraqitur pranë institucionit tonë si më poshtë vijon:

Kontrolli i Lartë i Shtetit mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. A. K. (ardhur me email më datë 04.05.2022 dhe protokolluar me tonën nr. 456, prot., datë 09.05.2022). Në këtë ankesë ngrihet problematika e rikonstruksionit të fasadës së një objekti në qytetin e Shkodrës i cili prish harmoninë dhe uniformitetin arkitektonik të qendrës historike të qytetit dhe zonës së mbrojtur. Lidhur me këtë çështje nga grupi i auditimit u kërkuar informacion pranë IKTK dhe KKTKM nga ku rezultoi se:

Subjekti aplikues z. F. S., ka paraqitur aplikimin me nr. AN020620210002 dhe datë aplikimi 02.06.2021 për projektin "Rikonstruksioni i Fasadës dhe çatisë i objektit brenda Qendrës Historike Shkodër, në Pronesi të z. A. S.".

Objekti i këtij projekti është një ndërtesë 2 dhe 4 kate me funksion dyqan/shërbim dhe hotel e ndodhur në Qendrën Historike të qytetit të Shkodrës, në rrugën Gjuhadol, Pronari i objektit, paraqet kërkesën e tij për shtimin e sipërfaqes së banimit, rehabilitimin e fasadës dhe rikonstrukcionin e çatisë.

Gjendja ekzistuese

Pronari disponon një truall (pasuria nr. 5/506) me sipërfaqe 336 m², ku ndodhet një ndërtesë me 2 dhe 4 kate me sipërfaqe ndërtimi prej 256 m² dhe lartësi 7.85 m deri në kornizën e çatisë.

Ndërhyrjet e propozuara në projekt janë si më poshtë:

- Rehabilitimin e fasadës dhe shtimin e sipërfaqes së banimit.
- Rikonstrukcionin e çatisë së objektit.
- Kati përdhe i fasadës ngelet i pa ndryshuar, ndërsa fasada e katit të parë (banim) ndryshon pjesërisht.
- Lartësia deri në kornizën e çatisë së propozimit është 9.75 m.
- Për sa i përket trajtimit arkitektonik të fasadës së ndërtesës, ajo përdor elementët karakteristik kompozicional të fasadës ekzistuese. Kemi përdorimin e drurit në dyert e jashtme, vetratat, dritaret dhe grilat karakteristike. Fasada do të suvatohet plotësisht duke u shoqëruar me kornizat dekorative, elemente që e karakterizojnë fasadat kompozuese të rrugës Gjuhadol.
- Në projekt, propozohet rikonstrukcioni i çatisë duke ulur pjerrësinë e saj për të shtuar hapësirat e brendshme të banimit.
- Konstrukcioni i çatisë do realizohet përgjithësisht me lende druri ose kapriata druri. Lenda e drurit do të jetë pishë apo lis, e staxhionuar mirë dhe e trajtuar ndaj elementeve atmosferike.
- Mbulesa e ndërtesës do të jetë çati me tjegulla vendi, me pjerrësi jo më të madhe se 25 gradë.

Lidhur me këtë projekt ka dhënë mendimet IKTK në Drejtorinë e Monumenteve të Kulturës në Sektorin e Qendrës Historike, Arkitektura e Traditës dhe Peizazhit në dokumentin me lëndë "Mendimi i Sektorit për Aplikimin AN020620210002 dhe datë aplikimi 02.06.2021" miratuar me firmë digjitale nga Drejtoria e Monumenteve të Kulturës pranë IKTK më datë 01.07.2021, ku paraqitet se objekti i përbërë nga dy godina: godina me 2 kate e cila ndodhet në qendrën historike të qytetit dhe godina me 4 kate e cila ndodhet brenda zonës së mbrojtur.

Për këtë projekt Drejtoria e Monumenteve të Kulturës shprehet se:

- titulli dhe përshkrimi i punimeve nuk pasqyrojnë qartë ndërhyrjet e propozuara.
- Në prezantim mungon vendosja e objektit në lidhje me kufirin e qendrës historike dhe zonës mbrojtëse.
- Nga projekti i paraqitur dallohet që pjesa e vjetër që del në rrugën "Gjuhadol", nga 2 kate me nënçati, propozohet të shtohet 1 kat dhe del tre kate (kemi shtesë sipërfaqe ndërtimi).
- Projekti i propozuar paraqet ndryshime në dritaret e fasadës kryesore nga me hark, në kuadratike.
- Në preventiv kemi ndërtim solete të re, dritare të reja me grila, etj. të cilat tregojnë për shtesë sipërfaqe ndërtimi në lartësi.

Objekti ndodhet brenda Kufirit të Qendrës Historike shpallur me VKM nr. 771, datë 30.09.2020 "Për Deklarimin Pasuri Kulturore të "Qendrës Historike" të Qytetit të Shkodrës, Përcaktimin e Zonës Mbrojtëse të saj dhe Miratimin e Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre".

Në konkluzionin e mendimit të kësaj drejtorie thuhet se objekti rritet në volum edhe nga ana pamore edhe në lartësi në raport me objektet e rrugës Gjuhadol, që kanë lartësi të unifikuar në lidhje me kornizën e çatisë.

Bazuar në pikën c të Nenit 10, Planit i Qendrës Historike të Qytetit të Shkodrës thuhet se rikonstruktionet ose rindertimet duhet të respektojnë volumin ekzistues. Kuota që merret si referencë është ajo e kornizës së çatisë, e cila në rastin konkret shkon nga 7.85 m në 9.75 m pavarësisht se lartësia përfundimtare e çatisë mbetet e njëjta. Një rritje volumi e tillë cenon peisazhin historik dhe unitetin kompozicional.

Në zbatim të Planit të Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës (neni 10, pika 2b dhe 2 c), sugjerojmë që projekti të rivijë për shqyrtim duke ruajtur kompozimin vëllimor origjinal i cili është formulues për peisazhin tradicional arkitektonik të rrugës Gjuhadol.

Lidhur me sa më sipër edhe DRTK në Shkodër me relacionin teknik nr. 186/1, datë 23.06.2021 shprehet se ndërhyrjet e propozuara në fasadën e objektit tjetërsojnë karakteristikat e objektit, pjesë e ansamblit historik rruga Gjuhadol.

KKTKM ka marrë vendimin nr. 341, datë 07.07.2021 (nr. 948, prot., datë 08.07.2021) me anë të të cilit miratohet projekti i paraqitur nga aplikuesi pa ndryshme në të.

Për sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit në terren kërkoi vendosjen në dispozicion të dokumentacionit prezent në DRTK për këtë projekt. Nga Drejtoria është vendosur në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

- Njoftim pr fillim punimesh nga firma B. M. Konstruktion me drejtues ligjore M. Gj., shkresa është pa numër protokolli dhe është protokolluar në DRTK me nr. 186/3, datë 16.09.2021.
- Kërkesën për caktim mbikëqyrësi për projektin në flajë nga DRTK Shkodër dërguar IKTKT me shkresën nr. 186/4, datë 16.11.2012.
- Kthim përgjigje shkresës nr. 186/4, datë 16.11.2021, me nr. Prot. 1941/1, datë 19.11.2021, ku specifikohet nga IKTK se subjekti që ka bërë njoftimin për fillim punimesh me drejtues teknik A. K. nuk zotëron licence si person juridik për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale. Për këtë arsye nuk është caktuar mbikëqyrësi i punimeve.
- Inspektim i kryer nga DRTK Shkodër me procesverbalin nr. 186/6, datë 24.11.2021, nga ku konstatohet se subjekti ka vendosur skeleri në objekt, por për momentin ende nuk punohet.
- Shkresa nr. 186/7, datë 24.11.2021, me lene Kërkesë për plotësim informacioni dhe marrje masash për pezullim punimesh, drejtuar nga DRTK Shkodër A. S. dhe shoqërisë B. M. Konstruktion SHPK;
- Procesverbal me nr. 186/8, datë 06.12.2021 i mbajtur nga DRTK Shkodër, nga ku konstatohet se ende nuk kryhen punime, por skeleria vazhdon të jetë në objekt.
- Kthim përgjigje nga B. M. Konstruktion SHPK me nr. 8, datë 02.12.2021 (protokolluar në DRTK Shkodër me nr. 186/9, datë 06.12.2021), ku subjekti sqaron se ka aplikuar për rinovimin e licencës së restaurimit.
- Kthim përgjigje B. M. Konstruktion SHPK nga DRTK Shkodër me nr. 186/10, datë 09.12.2021 ku DRTK Shkodër rivendos në dukje se pavarësisht aplikimit për rinovim, ende subjekti nuk është pajisur me të dhe se duhet të vijojë me pezullimin e punimeve.

- Urdhër i titullarit të DRTK Shkodër nr. 70, datë 22.12.2021 (me nr. 186/11, prot., datë 22.12.2021) për inspektimin e objektit në fjalë.
- Procesverbal nr. 186/12, prot., datë 22.12.2021 ku konstatohet vazhdimi i punimeve në fasadën e jashtme;
- Shkresa nr. 186/13, prot., datë 22.12.2021 drejtuar Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, për dijeni Bashkia Shkodër, A. S. dhe firma óB. M. Konstruktionô SHPK ku kërkohet marrja e masave të menjëherëshme për pezullimin e punimeve.
- Shkresa 186/14, datë 30.12.2021 drejtuar IKTK për vënie në dijeni të shkresës nr. 186/13, prot., datë 22.12.2021.
- Urdhër i titullarit të DRTK Shkodër nr. 1, datë 05.01.2022 (me nr. 1, prot., datë 05.01.2022) për inspektimin e objektit në fjalë.
- Procesverbali nr. 1/1, prot., datë 05.01.2022 ku konstatohet vazhdimi i punimeve.
- Kërkesë për pezullim të menjëhershëm punimës me nr. ½, datë 05.01.2022 nga DRTK Shkodër drejtuar óB. M. Konstruktionô SHPK.
- Shkresa nr. 1/3, datë 06.01.2022, kërkesë për informacion drejtuar IMT dhe për dijeni Bashkisë Shkodër, ku kërkohet informacion nëse janë marrë masat për pezullimin e punimeve.
- Shkresa nr. 108, datë 06.01.2022 nga IMT (protokolluar në DRTK me nr. 1/4, datë 10.01.2022) ku citohet se óB. M. Konstruktionô SHPK ka pezulluar punimet.
- Shkresa nr. 224/1, datë 18.01.2022 nga IMT (protokolluar në DRTK me nr. 1/5, datë 21.01.2022) ku ritheksohet se shoqëria óB. M. Konstruktionô SHPK ka pezulluar punimet.

Në vijim të vendosjes në dispozicion të dokumentacionit cituar më sipër, grupi i auditimit kreu një vëzhgim në terren në objektin në fjalë nga ku u konstatua se punimet në objekt janë përfunduar pavërsisht shkresave dhe shqetësimeve të ngritura nga DRTK Shkodër kundrejt institucioneve kompetente.

Pjesë e këtij aktverifikimi është edhe fotografia e objektit në gjendjen aktuale, si dhe gjithë dokumentacioni cituar më lart i cili i është vendosur në dispozicion grupit të auditimit i skanuar.



Figura nr. 11 Foto e objektit para punimeve Burimi DRTK Shkodër



Figura nr. 12 Objekti pas përfundimit të punimeve Burimi Grupi i Auditimit

2. Audituesit e grupit të auditimit kryen verifikim në Drejtorinë Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër më datat (26; 27; 30 dhe 31.05.2022), si rezultat i një ankese e paraqitur pranë KLSH^{së}. Pasi u mor në shqyrtim ankesa e paraqitur nga z. A. K. (ardhur me email më datë 04.05.2022 dhe protokolluar në KLSH me nr. 456/2, prot., datë 23.05.2022), në të cilën ngrihet problematika në lidhje me rikonstruksionin e objektit **óKafe e Madhe** në qytetin e Shkodrës (objekt monument kulture kategori e parë), në të cilën pretendohet se, është falsifikuar relacioni teknik (dhënie mendimi) dhe më konkretisht janë paraqitur dy relacione ku, një relacioni i parë ndodhet në protokollin e institucionit, ndërsa një relacion tjetër është dërguar nëpërmjet platformës (e-leje).

Për këtë qëllim nga verifikimi lidhur me këtë çështje u konstatua se;

- Projekti i restaurimit të objektit **óKafe e madhe** është miratuar më Vendim të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve nr. 168, datë 08.07.2016, i cili ka miratuar projektin **“Restaurimi dhe ndërtimi i objektit 2–3 kate, me 1 kat nën tokë të Kafes së Madhe”** me vërejtjen e evidentuar se; ótë lehtësohet fasada e ndërtimit të ri nga elementët dekorativë të stilizuaró. Ky vendim është marrë në përputhje me kriteret e parashikuara nga ligji nr. 9048, datë 07.04.2003 óPër trashëgiminë kulturoreó.

Për periudhën nga momenti i miratimit të projektit me vendimin cituar më sipër, në DRTK Shkodër janë gjetur të arkivuara shkresat si më poshtë:

- Shkresa nr. 59, prot., datë 08.04.2016 nga óXh.ñShó shpk drejtuar ish/DRTK Shkodër (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare) óShqyrtim Projekt Restaurimió.
- Shkresa nr. 79, prot., datë 11.04.2016 nga ish/DRTK Shkodër drejtuar Institutit të Monumenteve të Kulturës óGani Strazimirió;
- Shkresa nr. 152, prot., datë 15.06.2016 nga ish/DRTK Shkodër drejtuar Institutit të Monumenteve të Kulturës óGani Strazimirió përcjellje projekti;
- Shkresa nr. 241, prot., datë 16.11.2016 nga Instituti i Monumenteve të Kulturës óGani Strazimirió me nr. 448, prot., datë 14.11.2016 me të cilën përcillet miratimi i rishikimit të projektit të miratuar me vendimin e KKR nr. 168, datë 08.07.2016, sipas vendimit të KKR nr. 237, datë 04.11.2016. Ky rishikim i vendimit nuk ndryshon kushtet e restaurimit të objektit në fjalë dhe të projektit në tërësi.

Në vijimin të procesit të verifikimit të dokumentacionit rezultoi sa më poshtë:

- DRTK Shkodër me shkresë nr. 144, prot., datë 21.05.2021 óVënie në dijeni për projektin e Kafes së Madheô drejtuar subjektit óXh.ñShô shpk dhe Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor, për dijeni Ministrisë së Kulturës, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Prefektit të Qarkut Shkodër në të cilën kërkohet sa më poshtë:

ó ... në mbështetje të ligjit nr. 27/2018 óPër trashëgiminë kulturore dhe Muzetëô, nenit 79 óLejet për ndërhyrjet në pasuritë kulturoreô, pika (7) ku qartësisht citohet se; óAfati për fillimin e punimeve nuk mund të jetë më shumë se një vit, nga data e miratimit të lejes për ndërhyrje. Afati i përfundimit të punimeve përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve miratuar nga KKTKM^{ja}. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve dhe ndryshimi i subjektit zbatues të përcaktuar në lejen e ndërhyrjes kryhen nga autoriteti që ka miratuar lejen me kërkesë të subjektit të pajisur me licencë. Shtyrja e afatit kryhet vetëm një herë, për një periudhë jo më të gjatë se afati fillestar, dhe jo më vonë se sa 45 ditë nga përfundimi i lejes së ndërhyrjesô.

Për sa më sipër nga momenti i miratimit të ndërhyrjes nuk është zbatuar vendimi i vitit 2016 në drejtim të zbatimit të tij fill pas miratimit dhe ndërsa për këtë çështje DRTK i drejtohet subjektit duke vendosur në dukje se për të zbatuar punimet në këtë objekt subjekti duhet tã drejtohet IKTK për të kërkuar shtyrjen e afatit të punimeve me qëllim që të realizohet projekti. Referuar mediave lokale, sipas DRTK Shkodër, punimet në objekt kanë filluar e për këtë arsye kërkohet që të pezullohen punimet nga firma deri në marrjen e masave si dhe plotësimin e dokumentacionit lidhur me projektin.ô

Në vijim të kësaj shkrese DRTK Shkodër, nga data 24.05.2021 deri më datë 28.05.2021 ka kryer 3 inspektime dhe ka mbajtur procesverbalet përkatëse (procesverbal nr. 144/1, prot., datë 24.05.2021; procesverbal nr. 144/2, prot., datë 25.05.2021 dhe procesverbal nr. 144/3, prot., datë 28.05.2021), në të cilët ka konstatuar nisjen e punimeve, vendosjen e llamarinave dhe vendosjen e tabelës informuese lidhur me lejen e ndërtimit, shëmbjen e objektit (mungesë të ndërkateve, çatisë, dyerve dhe dritareve, në këmbë qëndron vetëm fasada kryesore dhe fragmente të mureve perimetrale). Në momentin e këtyre inspektimeve nga punonjësit e DRTK Shkodër nuk janë gjetur punëtor në vend.

DRTK Shkodër me shkresën nr. 144/4, prot., datë 28.05.2021 óPër marrjen e masave urgjente për pezullimin e menjëhershëm të punimeve në objektin óKafja e Madhe Shkodërô, i është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Bashkisë Shkodër ñ për në dijeni Ministria e Kulturës, IKTK dhe Prefektit të Qarkut Shkodër - në të cilën kërkohet se, nga inspektimet e vazhdueshme që DRTK Shkodër ka kryer në terren është konstatuar se, tabela informuese në kantier se subjekti óXh.ñShô shpk është pajisur me leje ndërtimi nr. 128, datë 26.03.2021. Punimet e së cilës po kryhen nga shoqëria zbatuese óK.ô shpk, si dhe mbikëqyrës punimesh Ing. G. L.

Nga Bashkia nuk është kthyer përgjigje me shkresë për informacion për këtë leje për dhënie mendimi në DRTK, si dhe firma nuk ka njoftuar për fillimin e punimeve. Për këtë arsye nga DRTK Shkodër kërkohet marrja e masave nga Drejtoria Vendore e Policisë dhe IKMT për këtë çështje për pezullimin e menjëhershëm të punimeve.

Në vijim të kësaj shkrese nga DRTK Shkodër janë kryer inspektime të dokumentuara me procesverbalet përkatës sa më poshtë:

- Procesverbal nr. 144/5, prot., datë 31.05.2021

- Procesverbal Nr. 144/6, prot., datë 01.06.2021
- Procesverbal Nr. 144/7, prot., datë 02.06.2021
- Procesverbal Nr. 144/8, prot., datë 03.06.2021 (hequr eskavatori nga objekti)
- Procesverbal Nr. 144/9, prot., datë 04.06.2021
- Procesverbal Nr. 144/10, prot., datë 07.06.2021
- Procesverbal Nr. 144/11, prot., datë 08.06.2021
- Procesverbal Nr. 144/12, prot., datë 09.06.2021
- Procesverbal Nr. 144/13, prot., datë 10.06.2021
- Procesverbal nr. 144/15, prot., datë 14.06.20231 (kantier i mbyllur dhe nuk vërehen punime)
- Procesverbal nr. 144/17, prot., datë 15.06.2021
- Procesverbal nr. 144/19, prot., datë 16.06.2021
- Procesverbal nr. 144/21, prot., datë 17.06.2021
- Procesverbal nr. 144/23, prot., datë 18.06.2021
- Procesverbal nr. 144/24, prot., datë 21.06.2021 (nuk ka punime në kantier dhe kantieri vazhdon të jetë i mbyllur)
- Procesverbal nr. 144/26, prot., datë 22.06.2021
- Procesverbal nr. 144/27, prot., datë 24.06.2021
- Procesverbal nr. 144/28, prot., datë 28.06.2021
- Procesverbal nr. 144/29, prot., datë 01.07.2021
- Procesverbal nr. 144/30, prot., datë 02.07.2021
- Procesverbal nr. 144/31, prot., datë 05.07.2021
- Procesverbal nr. 144/32, prot., datë 09.07.2021
- Procesverbal nr. 144/33, prot., datë 12.07.2021
- Procesverbal nr. 144/34, prot., datë 19.07.2021
- Procesverbal nr. 144/35, prot., datë 22.07.2021 (në afërsi të objektit është hapur një kanal gjatësor dhe po kryhen punime nga UKT Shkodër)
- Procesverbal nr. 144/36, prot., datë 23.07.2021. (Kantieri është i mbyllur por vazhdoen punimet nga UKT Shkodër)

Me shkresën nr. 144/14, prot., datë 14.06.2021, IKMT (Drejtoria rajonale Shkodër) kërkon që DRTK Shkodër të përcjell të gjithë dokumentacionin lidhur me këtë objekt.

Me shkresën nr. 950/2, prot., datë 07.06.2021 (protokolluar në DRTK nr. 144/16, prot., datë 14.06.2021) dërguar nga IKTK në DRTK Shkodër (për dijeni Ministria e Kulturës), ku IKTK shprehet se *vlefshmëria e lejes* nuk është i vetmi problem në këtë çështje e për kërkohet që DRTK të dërgojë pranë IKTK një relacion të detajuar mbi ndërhyrjet e vëzhguara nga DRTK dhe *si qëndrojnë këto në raport me projektin e miratuar* me vendim të KKR nr. 168, datë 08.07.2016.

Me shkresën nr. 8373/1, prot., datë 14.06.2021 (protokolluar në DRTK Shkodër me nr. 144/18, prot., datë 16.05.2021) IKMT i përgjigjet DRTK Shkodër thuhet se titullari i institucionit që me një vendim të ndërmjetëm të urdhëron pezullimin e punimeve, *në kushtet kur ende nuk është funksional Inspektoriati sipas ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"*.

Shkresa nr. 144/20, prot., datë 16.06.2021 óKthim përgjigje IKTKô, DRTK i ka dërguar inspektoriatit me CD projektin e restaurimit të Godinës óKafja e Madheô, si dhe kopjen e vendimit të KKR.

Shkresa nr. 8373/2, prot., datë 15.06.2021 nga Bashkia Shkodër (protokolluar në DRTK me nr. 144/22, prot., datë 17.06.2021) Kthim përgjigje Bashkia Shkodër sqaron se:

Në vijim të marrjes së vendimit nga KKR, Bashkia me vendimin nr. 320, datë 26.12.2017 ka dhënë lejen e ndërtimit për objektin në fjalë me zhvillues óXh.ñShô shpk, pronar B. Ç., A. Ç. dhe subjekt ndërtues óBH&SBô shpk.

Në sistemin elektronit (e-lejet) më datë 19.02.2021 me nr. AN190220210047 e administruar nga Bashkia Shkodër me nr. 3190, prot., në të cilën depozitohet kërkesa e zhvilluesit óXh.ñShô shpk për óShtyrje të afatit të lejes së ndërtimitô. Kjo kërkesë është miratuar me vendim nr. 320, datë 26.12.2017, punimet e të cilës kanë filluar referuar shkresës nr. 710/1, prot., datë 18.01.2018 óLeje për fillim punimeshó. Shtyrja e afatit të lejes është bazuar në nenin 40, pika 3 të ligjit nr. 107/2014 Për planifikimin dhe zhvillimin e territoritô, i ndryshuar.

- Shkresa nr. 144/25, prot., datë 21.05.2021 DRTK kthen përgjigje IKTK (për dijeni Ministrisë së Kulturës) lidhur me projektin ku evidentohet se projekti ka qëllim ndërhyrje restaruese kur ndërkohë konstatohet se objekti është shëmbur pjesërisht, pasi nga objekti qëndron në këmbë vetëm fasada kryesore. Gjithashtu firma óK.ô shpk nuk ka licencë restaurimi dhe DRTK nuk ka asnjë informacion mbi fillimin e punimeve, ditarin teknik dhe grafikun e punimeve.

Nga shqyrtimi dokumentacionit për vitin 2021 u konstatua se, projekti është depozituar në platformën digjitale (*e – leje*) si aplikim óBrenda kufirit të qendrës historikeô me aplikues óA. A.ô dhe zhvillues óXh.ñShô shpk, me titull “**Restaurim i fasadës – rindërtim i kafes së madhe dhe ndërtim i ambienteve ndihmëse**” administruar në DRTK me nr. 243, prot., datë 26.08.2021. Bëhet fjalë për një projekt të ri.

Nga një verifikim i librave të protokollit për vitin 2021 u konstatua se, DRTK Shkodër ka hartuar një Relacion teknik óDhënie mendimiô për këtë aplikim me nr. 243/1, prot., datë 26.08.2021, në të cilin jepet “*mendim negativ*” mbi aplikim e dërguar, pasi në preventivin e miratuar parashikohen ndërhyrje restaruese në interior; në fasadë; në çati etj, ndërkohë që nga inspektimet është evidentuar se objekti është shëmbur (ka mungesë të çatisë, të dyerve, të dritareve dhe të ndërkateve, qëndron në këmbë vetëm fasada kryesore. Nga platforma (*e–leje*) rezulton se, aplikimi është refuzuar nga IKTK pasi nuk është plotësuar projekti.

Lidhur me sa shtjelluar më sipër u konstatua se, për këtë projekt në vitin 2022 është depozituar në platformën digjitale (*e – leje*) si aplikim óBrenda kufirit të qendrës historikeô me aplikues óA. A.ô dhe zhvillues óXh.ñShô shpk me titull óRestaurim i fasadës ñ rindërtim i kafes së madhe dhe ndërtim i ambienteve ndihmëseô e administruar në DRTK Shkodër me nr. 125, prot., datë 25.03.2022.

Nga verifikimi i librave të protokollit për vitin 2022 u konstatua se, në vijim të aplikimit në (*e – leje*), DRTK Shkodër ka hartuar relacionin teknik óDhënie mendimiô e protokolluar me shkresën nr. 125/1, prot., datë 06.04.2021 e nënshkruar elektronikisht nga znj. B. P. me detyrë drejtore DRTK Shkodër; znj. S. K. me detyrë arkitekte; z. E. L. me detyrë inxhinier topograf; z. F. M. me detyrë arkitekt ñ restaurator. znj. S. K. me detyrë arkitekte; z. E. L. me detyrë inxhinier topograf; z. F. M. me detyrë arkitekt ñ restaurator kanë hartuar dhe nënshkruar elektronikisht relacionin më datë 05.04.2022, ndërsa drejtoresha e institucionit ka nënshkruar elektronikisht më datën 07.04.2022, ndërsa shkresa përcjellëse është hartuar dhe protokolluar më datën 06.04.2022 (*kjo shkresë përcjellëse nuk është as me vulë të njomë dhe as me firmë me stilolaps*).

Paralelisht me sa me sipër, grupi i auditimit i kërkoi titullarit të institucionit të verifikojë se cili nga dy dokumentet (relacione) të gjetura në DRTK është ngarkuar në platformën (**e-leje**), ku nga verifikimi i kryer në platformën digjitale (**e-leje**) u konstatua se, në këtë platformë gjendet i ngarkuar dokumenti (relacion) me nr. 125/1, prot., datë 04.04.2022 ***i cili nuk është i njëjtë me atë që gjendet në protokollin e institucionit (pa vulë dhe pa firmë).***

Nga këqyrja e dy dokumenteve dhe krahasimi i tyre u vërejtën këto ndryshime:

Në formë:

Dokumenti me nr. 125/1, prot., datë 06.04.2022:

- Dokumenti gjendet në protokoll
- Është konceptuar si relacion bashkë me shkresë përcjellëse
- Dokumenti nuk është ngarkuar në e-ñ lejet
- Nënshkruar elektronikisht nga B. P. me detyrë drejtore DRTK Shkodër; znj. S. K. me detyrë arkitekte; z. E. L. me detyrë inxhinier topograf; z. F. M. me detyrë arkitekt në restaurator. znj. S. K. me detyrë arkitekte; z. E. L. me detyrë inxhinier topograf; z. F. M. me detyrë arkitekt në restaurator

Dokumenti me nr. 125/1, prot., datë 04.04.2022:

- Dokumenti nuk gjendet në protokoll,
- Dokumenti është ngarkuar në e-ñ lejet
- Është vetëm relacion teknik.
- Nënshkruar elektronikisht nga znj. B. P. me detyrë drejtore DRTK Shkodër dhe z. H. S. me detyrë përgjegjësi i sektorit të parkut arkeologjik Lezhë.

Në përmbajtje ndryshojnë paragrafet si më poshtë:

Dokumenti me nr. 125/1, datë 06.04.2022:

Paragrafi është: *óTeknika e ndërtimit për sa i përket restaurimit të objektit nuk përkon me legjislacionin në fuqi për pasuritë kulturore. Në projekt (preventiv dhe specifikime teknike) gjejmë të përdoruar elemente si sistemi kapot për veshjen e jashtme, apo përdorimin e duro aluminim në dyer dhe dritare. Gjithashtu konsiderojmë projektin e paplotë për sa i takon detajeve arkitektonike për ndërkatet, ndërtimin e çatisë etj, të cilat nuk na lejojnë të krijojmë një ide të plotë mbi realizimin zbatimin e tij.*

Nga shqyrtimi i dokumentave të projektit të ardhur në e-leje me nr aplikimi AN160320220010 konstatohet se projekti ka nevojë për plotësime të mëtejshme referuar gjendjes aktuale të objektit.”

Dokumenti me nr. 125/1, datë 04.04.2022.

Pargrafi ndryshon në: *“Teknika e ndërtimit për sa i përket restaurimit të objektit nuk përkon me legjislacionin në fuqi për ndërhyrjet në pasuritë kulturore. Në projekt (preventiv dhe specifikime teknike) gjejmë të përcaktuara elemente të tilla si: sistemi kapot për veshjen e jashtme të fasadës, apo përdorimin e materialit duro-aluminium në dyer dhe dritare. Marrë parasysh rëndësinë që ka ky objekt për qytetin, si pjesë identitare e tij dhe për vlerat e tij historiko-arkitekturore që mbart edhe pse jo në gjendje integrale, vlerësojmë se rindërtimi i godinës duhet bërë në përshtatje me konsultimin në dokumentet arkivore si foto, planimetri të vjetra që ka për këtë objekt, si pjesë e korpusit të trashëgimisë historike të Shkodrës, specifikisht duke shfaqur mospajtimin tonë në përdorimin e dyerve dhe dritareve me material duralumin por në zëvendësimin e tyre me material druri. Kjo edhe në vazhden e mos cënimit të ansamblit të Qendrës Historike në Shkodër. Në vijim, specialistët e DRTK Shkodër,*

konsiderojnë hartimin e projektit të paplotë për sa i takon detajeve arkitektonike për ndërkatet dhe ndërtimin e çatisë etj, të cilat nuk na lejojnë të krijojmë një ide të plotë mbi realizimin dhe zbatimin e tij. Nga shqyrtimi i dokumentave të projektit të ardhur në e-leje me nr aplikimi AN160320220010 konstatohet se projekti ka nevojë për plotësime të mëtejshme referuar gjendjes aktuale të objektit, duke theksuar domosdoshmërinë e ruajtjes së vlerave dhe autenticitetit.”

Dy dokumentet cituar më sipër, pra ai që ndodhet në protokollin e institucionit dhe ai që nuk ndodhet në të, por që është ngarkuar në e – lejet pa pasur të gjitha firmat e duhura, japin mendim negativ, pra refuzues për projektin e ri të paraqitur në DRTK Shkodër. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj. B. P. , Drejtoresë e DRTK Shkodër dhe z. H. S. përgjegjës i sektorit të parkut arkeologjik Shkodër – Lezhë, në cilësinë e personave që kanë nënshkruar këtë dokument dhe e kanë ngarkuar atë në platformën e – lejet.

Lidhur me konstatimin e mësipërm janë paraqitur observacione nga znj. B. P., titullare e DRTK Shkodër, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 100/4, prot., datë 10.06.2022 ku thuhet se:

Pretendimet e Subjektit:

Hedhja në sistemin on line të relacionit teknik “Dhënie Mendimi” të hartua në zëvendësim të relacionit fillestar të hartuar nga sektori i arkitekturës ka ardhur si rezultati i faktit se nga ky sektor nuk janë reflektuar në relacionin fillestar sugjerimet për ndryshim të bëra nga Drejtoresha e DRTK Shkodër. Sugjerimet janë bërë me qëllimin e vetëm të evidentimit të shkeljeve lidhur me kafën e madhe të projektuar nga arkitekti Kolë Idromeno, si një pasuri kombëtare. Subjekti pretendon se përbën shkelje fakti që sistemi e – lejet nuk lejon që të ngarkosh njëkohësisht dy dhënie mendimi në dy shkresa të ndryshme, e në protokoll ka mbetur raporti i hartuar nga përgjegjësi i sektorit të parkut arkeologjik e firmosur nga drejtoresha e DRTK e në protokoll është protokollua relacioni i sektorit të arkitekturës. Shkelja nuk ka qenë abuzive apo për shkaqe korrupsioni, por një bashkim mendimesh, sepse në thelb nuk ndryshon mendimi i dhënë. Ky akt është bërë në përfitim të qytetit i cili gumëzhin nga përçudnimi i bërë Kafes së Madhe.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, sikundër është shprehur edhe në material, ka evidentuar që dy dokumentet ku ne përfundim shprehet mendimi negativ për projektin e kafes së madhe. Megjithatë, nga këndvështrimi i përputhshmërisë së veprimit me ligjin, uploadimi në sistemin e – leje i një dokumenti që nuk ekziston në protokoll është shkelje. Duhet të ketë korrespondencë midis dokumentacionit të prodhuar dhe protokolluar në institucion me atë të ngarkuar në sistemi. Nuk mund të ketë dy mendime në të njëjtën kohë për një projekt. Çfarë do të kishte ndodhur sikur mendimi i dytë i hedhur në e – leje, të kishte qenë i kundërt me atë të parin? Grupi i auditimit e mirëkupton observacionin e paraqitur, por gjykon që ky **nuk qëndron**, pasi mbështetja e këtyre veprimeve mund të përbëjë risk që në të ardhmen situata të tilla të ripërsëriten.

Nga verifikimi në terren grupi auditimit konstatoi se, subjekti aplikues Altus Atelier (projektues A. S. dhe zhvillues óXh.-Shô shpk) ka aplikuar përsëri në vitin 2022 me një projekt totalisht të ri

me titull “Restaurim i fasadës – rindërtimi kafes së madhe dhe ndërtim i ambienteve ndihmëse”, pasi subjekti zhvillues ka shembur objektin në kundërshtim me projektin e miratuar me vendimin e KKR nr. 168, datë 08.07.2016, të rishikuar sipas vendimit të KKR nr. 237, datë 04.11.2016.

Diferencat midis dy projekteve të vitit 2016 dhe vitit 2022:

Projekti i parë është restaurimi pasi objekti është në këmbë, pavarësisht se është në gjendje të degraduar; Ndërtimi një objekti të ri dy dhe tre kate. Vlera e preventivit është **111,953,159 lekë me tvsh.**

Projekti i dytë është restaurim i fasadës së mbetur në këmbë nga objekti pas prishjes dhe rindërtim i Kafes së Madhe pasi ndërkohë zhvilluesi i projektit të vitit 2016 e ka shembur atë në vitin 2021; Ndërtim i ambienteve ndihmëse 3 kate pas godinë së kafes së madhe. Vlera e preventivit është **201,848,969 lekë me tvsh.**

Statusi aktual i projektit në vitin 2022 sipas platformës (e-lejet) është óDërguar për plotësim dokumentacioni nga IKTK subjektit aplikues.

Observacionet e Subjektit

Lidhur me sa më sipër Ministria e Kulturës ka paraqitur observacionet si më poshtë:

1. Në lidhje me gjetjen nr. 22 dhe rekomandimin 17 për periudhën objekt auditimi janë hartuar dhe miratuar planet për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e qendrave historike të Kaninës, Shkodrës, Voskopojës dhe Bënjës. Është në proces finalizimi për miratimin plani për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e qendrave historike të Elbasanit. Puna për përgatitjen dhe propozimin për miratim të projektakteve do të vijojë në përputhje me Planin analitik vjetor të projektakteve. Në lidhje me rekomandimin për regjimet e ruajtjes dhe mbrojtjes të pasurive kulturore materiale të paluajtshme, regjimi i ruajtjes përcaktohet në Urdhrin e ministrit për deklarimin e pasurisë kulturore të paluajtshme të cilët miratohen rast pas rasti. Në lidhje me planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë sqarojmë që në të cilat aktet e deklarimit të qendrave historike, zona arkeologjike, ansambleve janë të përcaktuara qartazi.
2. Në lidhje me gjetjen 29, faqe 61, lidhur me shqyrtimin për zbatimin e punimeve në vijim të gjetjeve gjatë shembjes së shkollës óLlambi Goxhomanió, FShZh në korrik 2022 ka depozituar përmes portalit e-albania rezultatin e gërmimit arkeologjik. Aplikimi do të shqyrtohet në sektorët e përmbajtjes për të vijuar shqyrtimin dhe vendimarrjen në KKTKM. Sqarojmë se prej datës 15 korrik 2022 sistemi e-lejet është i bllokuar si pasojë e sulmit kibernetik.
3. Sa i takon detyrave në faqen 65 të raportit, IKTK shprehet dakort me afatet e përcaktuara.
4. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Gjirokastrë, ka paraqitur observacionin e mëposhtëm: “Nga studimi i projekt raportit, të realizuar nga grupi i auditimit, vërejmë se ky raport është gjithëpërfshirës. Përsa i takon Drejtorisë sonë, vec konstatimeve të përgjithshme, nuk ka pasur vërejtje konkrete. Nga konstatimet e bëra theksi vihet te mungesa e krijimit të Inspektoriatit Kombëtar Përgjegjës, pranë DRTK-ve. Sipas mendimit tonë, kjo është e domosdoshme për mbarëvajtjen e punës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve. Përsa i përket rekomandimeve konkluzioneve dhe rekomandimeve të përcaktuara, në përfundim të trajtimit të çështjes 4, jemi dakord me to. Përsa i përket afatave të vendosura për zbatimin e rekomandimeve, ato nuk varen plotësisht nga ne. Përgjegjësinë më të madhe e ka Ministria e Kulturës, e cila është përgjegjëse për ngritjen e grupeve të përbashkëta për zbatimin e

rekomandimeve. Ne do të jemi dakord dhe gjithmonë të angazhuar në cdo program që Ministria do të hartojë. Afatet e realizimit të rekomandimeve duken të arritshme”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Në prezencë të vështirësive të ndeshura në zbatimin konkret të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe në mungesë të komentarit të tij, grupi i auditimit gjykon se MK duhet të përcaktojë paraprakisht në nivel makro planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave kulturore të paluajtshme e në vijim të trajtohen rast pas rasti veçoritë e çdo situatë.

Gjetje nga auditimi:

14. MK ende nuk ka hartuar planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore. Rezulton gjithashtu se referuar kërkesave të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, nuk janë hartuar dhe miratuar regjimet e ruajtjes dhe të mbrojtjes së pasurive kulturore materiale të paluajtshme⁵¹; nuk janë hartuar dhe miratuar Planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë, të cilat specifikojnë objektivat, detyrat dhe mënyrat e zhvillimit të tyre, me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, në përputhje me regjimet e saj të mbrojtjes⁵²; nuk janë hartuar dhe miratuar planet sektoriale në nivel rajonal, plani i përgjithshëm vendor dhe planet e detajuara vendore të zhvillimit për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë, të cilat kanë lidhje specifike me rregullat dhe normat që hartohen në përputhje me regjimet për mbrojtjen e pasurive të paluajtshme kulturore të njësisë përkatëse vendore.⁵³

15. Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 297, datë 31.07.2015 óPër shpalljen e zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturësó është miratuar në zbatim të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 óPër trashëgiminë kulturoreó, i ndryshuar, i cili tashmë nuk është më në fuqi.

16. Në kushtet kur ende nuk është krijuar Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, funksioni i inspektimit në fushën e trashëgimisë kulturore mbulohet nga DRTK ñ të, por këto institucione nuk kanë fuqi ndëshkuese. Ato kryejnë inspektime dhe konstatojnë shkeljet e ligjit në fushën e trashëgimisë kulturore dhe i përcjellin ato pranë institucioneve eprorë, si dhe inspektorateve vendore e bashkive, por nga këto institucione nuk ka reagime konkrete apo ndëshkime ndaj atyre që shkelin ligjin.

17. Në DRTK Berat, KKTKM dhe Ministria e Kulturës, në rastin e zbulimeve gjatë shembjes së shkollës óLl. Goxhomanió ende nuk janë shprehur lidhur me zbatimin e mëtejshëm të këtij projekti në përputhje me Konceptin e Gërmimit Arkeologjik të miratuar me Vendim të KKTKM ñ së nr. 275, datë 08.06.2021.

18. Në territorin e DRTK Vlorë, Sektori i Sarandës:

- ka raportuar pranë institucionit gjendjen e monumenteve óUra e gurtë e Tatzatit mbi lumin e Kalasës nën shkëmb, Tatzatô dhe óVarret (Varroshi), Vergoó si dhe ka konstatuar ndërhyrje të karakterit ndërtimor në kolonat e mbetura anësore të monumentit óUra e gurtë e Tatzatit mbi lumin e Kalasës nën shkëmb, Tatzatô, i cili ndodhet ndërmjet fshatrave Kalasë dhe Tatzat;

⁵¹ Neni 43, ligji nr. 27/2018

⁵² Neni 44, pika 1 ligji nr. 27/2018

⁵³ Neni 44, pika 2, ligji 27/2018

- gjatë inspektimit në terren të varreve monumentale në fshatin Vergo të Bashkisë Delvinë, është konstatuar ndërhyrje pa leje nga pronari i banesës pranë varreve monumentale, i cili ka bërë rrethimin e varreve me blloqe betoni duke i nxjerrë jashtë rrethimit të banesës së tij;
 - ka identifikuar 36 monumente kulture (kryesisht kala) në territorin e Sarandës për të cilat duhet ndërhyrje e vazhdueshme si në mirëmbajtje ashtu edhe në hartim projektesh.
- DRTK Vlorë ka hartuar dhe u ka dërguar institucioneve kompetente shumë shkresa lidhur me ndërhyrje të paautorizuara në objekte monumente kulture në territorin që ky institucion administron nga evidentohen ndërhyrje pa leje në monumentet e kulturës, prishje të monumenteve gjatë zbatimit të projekteve të miratuara, kërkesa për pezullime punimesh etj, nga të cilat mund të përmendim:
- objekti banimi 1 kat me kollona dhe soletë të ndërtuar së fundmi në zonën e mbrojtur B të parkut arkeologjik të Finiqit. Kjo problematikë nuk ka gjetur zgjidhje nga institucione të cilat u është drejtuar DRTK Vlorë⁵⁴;
 - punime pa leje të Bashkisë Sarandë në zonat Arkeologjike A dhe B të qytetit të Sarandës;
 - gërmime klandestine në varrezën tumulave të Himarës si dhe gërrime në shtratin e përroit të Korranit (Komisariatit të Policisë Vlorë ka referuar rastin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me nr. 921, prot., datë 05.05.2021);
 - kërkesë pezullimi i punimeve të restaurimit të kishës së óShën Nikollësó në Porto Palermo, Himarë, pasi ato janë në kundërshtim me projektin e miratuar. Për këtë çështje DRTK Vlorë ka depozituar një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. 417, prot., datë 11.08.2020.
 - vënie në dijeni të dëmtimit të monumentit të kulturës óTavani dekorativ në shtëpinë e Pirro Gjokopullitó i cili është restauruar në kuadër të projektit óRikualifikimi urban dhe restaurimi i objekteve në qendrën historike dhe zonën e mbrojtur fshatrat Dhërmió, konstatohet ndërtimi i çatië me strukturë betoni dhe zhvendosja e tavanit i cili nuk ndodhet më në objekt. Për sa më sipër, Fondi Shqipëtar i Zhvillimit me shkresë nr. 1634/1, prot., datë 03.08.2020, bazuar në óCertifikatën e Përfundimit të Punimeveó të lëshuar nga supervizuesi óA. Studioó, si dhe óCertifikatën e përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeveó nga Bashkia Himarë, e konsideron të mbyllur me sukses këtë projekt.

19. Në territorin e DRTK Gjirokastër është konstatuar prishja e gjetjeve arkeologjike rastësore (një pus dhe një mur) nga firma që kryen punimet e ndërtimit të parkimit nëntokësor në Sheshin óÇerçiz Topullió. BOE P. shpk dhe S. 98 shpk që kryen punimet e ndërtimit të parkimit nëntokësor në Sheshin óÇerçiz Topullió, pas inaugurimit të fillimit të punimeve, ka vijuar punën pa kryer lajmërimet përkatëse në DRTK. BOE P. shpk dhe S.98 shpk nuk ka njoftuar zbulimin e pusit, por DRTK ka marrë dijeni për këtë gjetje nëpërmjet burimeve të tërthorta. BOE P. shpk dhe S.98 shpk vazhdojnë punimet e ndërtimit të parkimit nëntokësor në shkelje të vendimit të KKTkMnë nr. 262, datë 08.06.2021, me atë të të cili i kërkohet subjektit të kontraktojë një arkeolog të licencuar për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e zbulimeve arkeologjike aty.

⁵⁴ Shkresa nr. 274, prot., datë 05.05.2021 óPër marrjen e masave të menjëhershme dhe prishjen e ndërtimeve pa lejeó, drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Vlorë, Komisariatit të Policisë Vlorë, Bashkisë Finiq, për Dijeni IKTK Tiranë ku kërkohet prishja e një objekti banimi 1 kat me kollona dhe soletë të ndërtuar së fundmi në zonën e mbrojtur B të parkut arkeologjik të Finiqit. Kjo problematikë nuk ka gjetur zgjidhje nga institucione të cilat u është drejtuar DRTK Vlorë.

20. Në DRTK Tiranë janë evidentuar ndërhyrje në monumentet e kulturës të natyrave të ndryshme si në Kalanë e Dorëzit, (Pezë), ku zhvillon aktivitetin ekonomik një gurorë\ brenda zonës së mbrojtur të objektit shpallur me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr.46, datë 02.02.2015, Për shpallje Zonë të Mbrojtur për óKalaja e Dorëzitô, Pezë, Tiranë.

21. Në DRTK Korçë janë evidentuar ndërhyrje të natyrave të ndryshme në monumentet e kulturës, si më poshtë:

- evidentim i punimeve të paautorizuara të karakterit ndërtimor në fshatin Rehove.⁵⁵

- kërkesë për pezullim punimesh në objektin sipas projektit me titull óRikonstruksion i pjesshëm i banesës 2 dhe 3 kate, ndërtim i shtesës anësore dhe rindërtim i katit të dytë, pasi nuk ka kontratë supervizimi për këtë projekt.

- ndërhyrje të paautorizuara ndërtimore nga pronari në objektin monument kulture i kategorisë së dytë óVila Polena, për të cilat DRTK Korçë ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë.⁵⁶

- kërkesë për moslejim të bagëtime në oborret e kishave në fshatin Voskopojë. Etj.

22. Nga inspektimet e DRTK Shkodër është konstatuar se Ish Banesa Shtetërore Ndue Zefi, sipas procesverbalit nr. 23/2, prot., datë 18.01.2022, monument kulture i kategorisë së parë, nuk ekziston më.

23. Në territorin e DRTK Shkodër, KKTKM ka miratuar projektin óRikonstruksioni i Fasadës dhe çatisë së objektit brenda Qendrës Historike Shkodër, në pronësi të z. A. S., pavarësisht se për këtë projekt Drejtoria e Monumenteve të Kulturës shprehet se objekti rritet në volum, si nga ana pamore dhe në lartësi, në raport me objektet e rrugës Gjuhadol, që kanë lartësi të unifikuar në lidhje me kornizën e çatisë, në mospërputhje me pikën c të Nenit 10, Plani i Qendrës Historike të Qytetit të Shkodrës, ku thuhet se rikonstruksionet ose rindërtimet duhet të respektojnë volumin ekzistues. DRTK Shkodër me relacionin teknik nr. 186/1, datë 23.06.2021 shprehet se ndërhyrjet e propozuara në fasadën e objektit tjetërsojnë karakteristikat e objektit, pjesë e ansamblit historik rruga óGjuhadolô. Subjekti që ka bërë njoftimin për fillim punimesh në DRTK Shkodër me drejtues teknik A. K., i cili nuk zotëron licencë si person juridik për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale. DRTK Shkodër i është drejtuar zyrtarisht Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, për dijeni Bashkia Shkodër, A. S. dhe firma óB. M. Konstruktionô SHPK duke kërkuar marrjen e masave të menjëherëshme për pezullimin e punimeve. Në vijim të vendosjes në dispozicion të dokumentacionit përkatës në DRTK Shkodër, grupi i auditimit kreu një vëzhgim në terren në objektin në fjalë nga ku u konstatua se punimet në objekt janë përfunduar pavarësisht shkresave dhe shqetësimeve të ngritura nga DRTK Shkodër kundrejt institucioneve kompetente.

25. Nga zbatimi i projektit të restaurimit të objektit óKafe e madheô, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve nr. 168, datë 08.07.2016, i cili ka miratuar projektin **“Restaurimi dhe ndërtimi i objektit 2–3 kate, me 1 kat nën tokë të Kafes së Madhe”**, i ndryshuar, me Vendimin e KKR nr. 237, datë 04.11.2016, DRTK Shkodër ka konstatuar shembjen e objektit (mungesë të ndërkateve, çatisë, dyerve dhe dritareve, në këmbë qëndron vetëm fasada kryesore dhe fragmente të mureve perimetrale). Subjekti zbatues óXh. Shô SHPK

⁵⁵ Shkresa nr. 124, prot., date 07.03.2019, drejtuar Bashkisë Kolonjë, për dijeni IKTK.

⁵⁶ Kallëzim penal nr. 158, prot., date 10.05.2021.

ka nisur punimet në shkelje të nenit 79 të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, ku citohet se afati për fillimin e punimeve nuk mund të jetë më shumë se një vit, nga data e miratimit të lejes për ndërhyrje. Ndërkohë që afati i përfundimit të punimeve përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve miratuar nga KKTKMnja. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve dhe ndryshimi i subjektit zbatues, i përcaktuar në lejen e ndërhyrjes, kryhen nga autoriteti që ka miratuar lejen me kërkesë të subjektit të pajisur me licencë. Shtyrja e afatit kryhet vetëm një herë, për një periudhë jo më të gjatë se afati fillestar, dhe jo më vonë se sa 45 ditë nga përfundimi i lejes së ndërhyrjes. Nga momenti i miratimit të ndërhyrjes nuk është zbatuar vendimi i vitit 2016. DRTK Shkodër ka konstatuar në terren (nga tabela informuese në kantier) se subjekti óXh.ñShô SHPK është i pajisur me leje ndërtimi nr. 128, datë 26.03.2021. Punimet kryheshin nga shoqëria zbatuese óK.ô SHPK, si dhe mbikëqyrës punimesh Ing. G. L.

26. Titullari i DRTK Shkodër nuk ka urdhëruar pezullimin e punimeve me një vendim të ndërmjetëm, në kushtet kur ende nuk është funksional Inspektorati, në shkelje të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë i cili i jep kompetencën për të marrë masa urgjente sigurie në situata të tilla

27. Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2021, u konstatua se, është depozituar në platformën digjitale (*e-leje*) si aplikim óBrenda kufirit të qendrës historikeó, me aplikues óA. A.ó dhe zhvillues óXh.- Shô shpk, projekti me titull **“Restaurim i fasadës–rindërtim i kafes së madhe dhe ndërtim i ambienteve ndihmëse”**, adminsitruar në DRTK me nr. 243, prot., datë 26.08.2021. Nga një verifikim i librave të protokollit **për vitin 2021** u konstatua se, DRTK Shkodër ka hartuar një Relacion teknik óDhënie mendimió për këtë aplikim me nr. 243/1, prot., datë 26.08.2021, në të cilin jepet **“mendim negativó** mbi aplikimin e dërguar, pasi në preventivin e miratuar parashikohen ndërhyrje restauruese në interior; në fasadë; në çati etj, ndërkohë që nga inspektimet është evidentuar se objekti është shembur (ka mungesë të çatisë, të dyerve, të dritareve dhe të ndërkateve, qëndron në këmbë vetëm fasada kryesore. Nga platforma (*e-leje*) rezulton se, aplikimi është refuzuar nga IKTK pasi nuk është plotësuar projekti. Në vitin 2022 është depozituar në platformën digjitale (*e – leje*) si aplikim óBrenda kufirit të qendrës historikeó me aplikues óA. A.ó dhe zhvillues óXh.ñShô shpk projekti me titull **óRestaurim i fasadës – rindërtim i kafes së madhe dhe ndërtim i ambienteve ndihmëse”** e adminsitruar në DRTK Shkodër me nr. 125, prot., datë 25.03.2022. Nga verifikimi i librave të protokollit për vitin 2022 u konstatua se, në vijim të aplikimit në (*e – leje*), DRTK Shkodër ka hartuar relacionin teknik óDhënie mendimió e protokolluar me shkresën nr. 125/1, prot., datë 06.04.2021 e nënshkruar elektronikisht nga znj. B. P. me detyrë drejtore e DRTK Shkodër; znj. S. K. me detyrë arkitekte; z. E. L. me detyrë inxhinier topograf; z. F. M. me detyrë arkitekt në restaurator. znj. S. K. me detyrë arkitekte; z. E. L. me detyrë inxhinier topograf; z. F. M. me detyrë arkitekt në restaurator kanë hartuar dhe nënshkruar elektronikisht relacionin më datë 05.04.2022, ndërsa drejtoresha e institucionit ka nënshkruar elektronikisht më datën 07.04.2022, ndërsa shkresa përcjellëse është hartuar dhe protokolluar më datën 06.04.2022 (kjo shkresë përcjellëse nuk është as me vulë të njomë dhe as me firmë me stilolaps). Dy dokumentet cituar më sipër, pra ai që ndodhet në protokollin e institucionit dhe ai që nuk ndodhet në të, por që është ngarkuar në e në lejet pa pasur të gjitha firmat e duhura, pasi të dy relacionet japin mendim negativ, pra refuzues për projektin e ri të paraqitur në DRTK Shkodër. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 óPër Arkivató, si dhe Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

28. Nga verifikimi në terren grupi auditimit konstatoi se, subjekti aplikues Altus Atelier (projektues Archispace Studio dhe zhvillues ÓXh.ñ Shô shpk) ka aplikuar përsëri në vitin 2022 me një projekt totalisht të ri me titull óRestaurim i fasadës ñ rindërtimi i kafes së madhe dhe ndërtim i ambienteve ndihmëseô, pasi subjekti zhvillues **ka shembur objektin në kundërshtim me projektin e miratuar** me vendimin e KKR nr. 168, datë 08.07.2016, të rishikuar sipas vendimit të KKR nr. 237, datë 04.11.2016.

Konkluzione:

14. Mos regjistrimi dhe inventarizimi i monumenteve të kulturë si asete dhe mos vendosja e tyre konkretisht në ngarkim të institucioneve në nivel qendror apo edhe vendor përbën risk konkret humbjen, shkatërrimin dhe/ose tjetërsimin e tyre. Në skenarin më të keq, ato lihen pas dore dhe degradojnë deri sa humbasin vlerat kulturore dhe arkitektonike e restaurimi ose rikthimi në gjendjen e mëparshme bëhet i pamundur, e këto hiqen nga lista e monumenteve të kulturë.

15. Mos hartimit dhe miratimi i planeve ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore; regjimeve të ruajtjes dhe të mbrojtjes së pasurive kulturore materiale të paluajtshme⁵⁷; i planet të detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë, të cilat specifikojnë objektivat, detyrat dhe mënyrat e zhvillimit të tyre, me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, në përputhje me regjimet e saj të mbrojtjes⁵⁸; i planeve sektoriale në nivel rajonal, plani i përgjithshëm vendor dhe planet e detajuara vendore të zhvillimit për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë⁵⁹ penalizon në tërësi procesin e mbrojtjes dhe administrimit të monumenteve të kulturës, pasi nuk lejon integrimin e politika të ministrisë në këtë fushe. Kjo gjendje përkethehet në mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi frutdhënës midis institucioneve në nivel qendror dhe atyre në nivel vendor që të përkethehet në një përmirësim të gjendjes së monumenteve e jo në përkeqësim të tyre sikundër është evidentuar edhe gjatë këtij auditimi.

16. Mos përcaktimi i óAutoritetit përgjegjësô për hartimin dhe miratimin e dokumenteve të planifikimit që i referohen zhvillimit të zonave të rëndësisë kombëtare, sjell edhe më tepër konfuzion për procesin e mbrojtjes dhe administrimit të këtyre monumenteve sidomos në kushtet kur institucionet duhet të nisin të bashkëpunojnë për të hartuar këto dokumenta planifikimi. Mbetet e paqartë përgjegjësia se kush do inicioj çfarë, kush do të përfshihet e kush do ti miratojë këto dokumenta, pa lenë mënjane edhe përmbajtjen e tyre.

17. Mos përditësimi i Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 297, datë 31.07.2015 óPër shpalljen e zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturësô evidenton mungesën e qartësisë të MK për përcaktimin e regjimeve të mbrojtjes dhe ruajtjes së monumenteve të kulturës, të cilat ende pas 4 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nuk janë përcaktuar.

18. Për periudhën objekt auditimit shkresat dhe problematikat e raportuara nga DRTK - të janë të shumta dhe ato evidentojnë mungesën e komunikimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve në nivel vendor, me pasojë të parikuperueshme për monumentet e kulturës. Në këtë këndvështrim nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm dhe efektiv midis institucioneve të specializuara në nivel

⁵⁷ Neni 43, ligji nr. 27/2018.

⁵⁸ Neni 44, pika 1 ligji nr. 27/2018.

⁵⁹ Neni 44, pika 2, ligji 27/2018.

vendor dhe njërive të vetëqeverisjes vendore, që kjo e cila amplifikohet edhe më tepër në kushtet e mungesës së Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Shpesh herë institucionet kanë vështirësi në kanalizimin e komunikimeve midis tyre, ndërkohë që ka pasoja thelbësore, pasi kujtesa kombëtare rrezikon të humbasë dhe nuk ka ndëshkime për shkelësit e ligjit të cilët dëmtojnë monumentet e kulturës.

Rekomandime

14. MK, në cilësinë e institucionit epror përgjegjës për mirëmenaxhimin e monumenteve të kulturës, të ngrejë një grup pune ku të përfshihen të gjithë institucionet e sistemit kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore, me bashkëpunimin dhe mbështetjen e njërive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera, me qëllim hartimin e një dokumenti strategjik dhe një plani veprimi konkret për inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve ótrashëgimi kulturoreó në vendin tonë.

Dhjetor 2022

15. MK, në bashkëpunim me IKTK dhe DRTKñtë, të ngrejë një grup pune për të evidentuar të gjitha problematikat lidhur me pronësinë e monumenteve të kulturës duke evidentuar hapat që duhen ndjekur për të zgjidhur këto problematika, në përfitim të procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme.

Qershor 2023

16. MK, në cilësinë e institucionit politikëbërës, të hartojë dhe miratojë planet për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore; regjimet e ruajtjes dhe të mbrojtjes së pasurive kulturore materiale të paluajtshme⁶⁰; planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë.

Dhjetor 2023

17. MK, në cilësinë e institucionit përgjegjës për mbarëvajtjen e monumenteve të kulturës, të koordinojë me të gjithë aktorët në nivel qendror, rajonal dhe vendor për hartimin dhe miratimin e planeve sektoriale në nivel rajonal, planit të përgjithshëm vendor dhe planeve të detajuara vendore të zhvillimit për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë.

Dhjetor 2023

18. IKTK, në cilësinë e institucionit që koordinon dhe monitoron punën e DRTKñve, nën udhëheqjen e Ministrisë së Kulturës, të marrë masa duke ngritur një grup pune për të evidentuar përgjegjësitë, në rastet e ndërhyrjeve në monumentet e kulturës të evidentuara në këtë raport auditimi, si dhe të gjitha rastet dhe tipologjitë e ndërhyrjeve në monumentet e kulturës të tjera në vendin tonë, duke marrë masa konkrete për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Dhjetor 2022

19. DRTK Shkodër të hartojë dhe miratojë proceset e punës për menaxhimin e dokumentacionit arkivor në institucion, në përputhje me ligjin për arkivat dhe normat tekniko profesionale, me qëllim që të shmangë në të ardhmen problematika të ngjashme si ato të evidentuara nga auditimi.

Dhjetor 2022

⁶⁰ Neni 43, ligjit nr. 27/2018.

4.3 A është garantuar financim buxhetor i duhur për menaxhimin e monumenteve të kulturës?

4.3.1 A ka rezultuar i mjaftueshëm financimi buxhetor në drejtim të mirëadministrimit të monumenteve të kulturës?

Në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të miratuara dhe kryejnë funksion objekte të trashëgimisë së kulturës të publikuara në faqen zyrtare *online* të Ministrisë së Kulturës (MK) dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë së Kulturës (IKTK) të evidentuara në objekte të kategorizuara me emërtimin e monumentit, kategorinë, adresën e vendndodhjes së objektit (*bashkia, qarku*), të dhënat e shpalljes monument, numri i objektit, të cilët janë të pajisur me kartelë për trashëgiminë kulturore të paluajtshme me të dhëna administrative të objektit me emërtime të specifikuara, si dhe në zona të mbrojtura sa më poshtë;

a. Ndërtesa, godina banesa familjare.

b. Ndërtesa, kulte fetare të evidentuara (*Xhami, Kisha, Teqe, Tyrbe, Ikona, etj*).

c. Ndërtesa të ndryshme sociale.

d. Ndërtime të evidentuara (*Kala, Fortesë, Urë, Shpellë, Varrezë, etj*).

Në zbatim të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 *“Për trashëgiminë kulturore”* i ndryshuar; ligjit nr.27, datë 17.05.2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe Muzet”*; VKM nr.581, datë 28.08.2019 *“Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtrisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”*, si dhe VKM nr.139, datë 21.10.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”* konstatohet se, DRTK^{te}, Kultet Fetare dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) kanë detyrimin ligjor të administrojnë dhe të monitorojnë këto objekte të cilësuar monumente të trashëgimisë së kulturës, ndërsa të evidentuara për secilin institucion janë sa më poshtë:

Tabela nr. 13

Nr	Institucionet	Objekte të trashëgimisë së kulturës			Zona të Mbrojtura
		Totali	Kat.(I)	Kat.(II)	
1	DRTK Tiranë	378	167	211	32
2	DRTK Shkodër	230	212	18	27
3	DRTK Vlorë	220	220	0	40
4	DRTK Korçë	304	286	18	47
5	DRTK Berat	479	123	356	5
6	DRTK Gjirokastër	550	221	329	23
	Totali objekte të trashëgimisë	2 162	1 227	932	174

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga faqe zyrtare online e Ministrisë së Kulturës, IKTK dhe DRTK

Të dhënat e evidentuara në tabelë pasqyrojnë se, në të gjithë territorin e vendit janë të miratuara dhe të evidentuara si monumente të trashëgimisë së kulturës gjithësej **2 162 objekte**, nga të cilat **1 229 objekte Kat.I^{re}** dhe **932 objekte Kat.II^{te}**, njëkohësisht edhe **174 Zona të mbrojtura**.

Në të gjitha objektet e kategorizuar monumente të trashëgimisë së kulturës është domosdoshmri dhe shumë e nevojshme që këto objekte të monitorohen, ruhen, vlerësohen, mbrohen, administrohen dhe të evidentohet gjendja e tyre teknike me qëllim që të parandalohen dëmtimet, rrënimet dhe kthimi i tyre në rrënoja të pa vlefshme, por vecanërisht në ato objekte të cilat shërbejnë si atraksion turistik të aksesuara për vizitorë të huaj dhe vendas, është akoma edhe më tepër e domosdoshme që këto objekte të restaurohen, rehabilitohen, rikonstruohen dhe mirëmbahen vazhdimisht në rutinë, nga të cilat janë krijuar të ardhura nga shitja e biletave për vizitorët.

Të ardhurat nga vizitorët e objekteve.

Për periudhën e audituar vitet (2019, 2020, 2021), objekte të aksesuara për vizitorë vendas dhe të huaj në të cilat janë realizuar të ardhura nga shitja e biletave janë vetëm në 8 objekte të trashëgimisë kulturës të administruara nga 4 DRTK, të evidentuara për secilin objekt dhe drejtori pasqyrohen sa më poshtë:

Tabela nr. 14

Nr	Institucioni	Objekti vizituar	2019	2020	2021
1	DRTK Shkodër	Kalaja e Rozafës	13.695.700	4.447.440	10.910.400
2	DRTK Vlorë	Kalaja (Palermo, Himar, Kaninë) dhe parku Finiq	4.942.900	1.237.100	4.200.800
3	DRTK Berat	Kalaja e Beratit	10.964.430	5.116.300	18.548.860
4	DRTK Gjirokastrë	Kalaja e Gjirokastrës dhe parku Antigone	17.977.146	5.768.890	15.656.020
		TOTALI	45.580.176	16.569.730	49.316.080

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin të buxhetit faktik në DRTK.

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë dhe evidentojnë faktin se, nga 2162⁶¹ objekte të trashëgimisë së kulturës, të ardhura nga shitja e biletave janë realizuar vetëm nga 8 objekte të cilat janë të aksesuara me ciceron për vizitor vendas dhe të huaj, ku për periudhën raportuese ushtrimore objekt auditimi të ardhurat e arkëtuara në total janë në shumën prej **111,465,986 lekë**, ku më hollësisht për secilën periudhë arkëtimi I të ardhurave është për sa më poshtë;

*-Për periudhën viti 2019 është arkëtuar shuma prej **45.580.176 lekë**.*

*-Për periudhën viti 2020 është arkëtuar shuma prej **16.569.730 lekë**.*

*-Për periudhën viti 2021 është arkëtuar shuma prej **49.316.080 lekë**.*

Në zbatim të VKM nr.432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Kulturës nr.52, datë 09.02.2015 “Për krijimin e administrimit të të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës” të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave për vizitorë nga secila DRTK, si dhe limiti i miratuar për përdorimin të realizuara

⁶¹ Të dhëna të vendosura në dispozicion nga IKTKT.

referuar në nevojat e ndërhyrjeve e mirëmbajtje rutine në pasuritë e trashëgimisë kulturore për periudhat raportuese (2019; 2020; 2021) përdorimi të ardhurave është evidentuar si më poshtë:

Tabela nr. 15 Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2019 me këto të dhëna;

Nr	Institucioni	Të ardhurat nga shitja e biletave në objektet e aksesuara për vizitorë					
		Programuar	Realizuar	Pjesëmarrja		Limiti përdorimit	Shpenzuar për mirëmbajtje objekti
				Vlera	%		
1	DRTK Shkodër	Ska	13,695,700	12,326,130	90		2,937,158
2	DRTK Vlorë	Ska	4,942,900	4,448,610	90	3,500,000	3,478,368
3	DRTK Berat	Ska	10,964,430	9,867,987	90	4,100,000	2,950,110
4	DRTK Gjirokastrë	Ska	17,977,146	16,179,431	90	8,420,000	4,565,966
	Totali		47,580,176	42,822,158		18,957,158	13,931,602

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin të buxhetit faktik në DRTK

Tabela nr. 16 Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 me këto të dhëna:

Nr	Institucioni	Të ardhurat nga shitja e biletave në objektet e aksesuara për vizitorë					
		Programuar	Realizuar	Pjesëmarrja		Limiti përdorimit	Shpenzuar për mirëmbajtje objekti
				Vlera	%		
1	DRTK Shkodër	Ska	4,447,440	4,002,696	90	3,141,800	2,830,703
2	DRTK Vlorë	Ska	1,237,100	1,113,390	90	1,200,000	1,095,570
3	DRTK Berat	Ska	5,116,300	4,604,670	90	4,000,000	3,218,696
4	DRTK Gjirokastrë	Ska	5,768,890	5,192,001	90	4,050,000	4,009,758
	Totali		16,569,730	14,912,757		12,391,800	11,154,727

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin të buxhetit faktik në DRTK

Tabela nr. 17 Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2021 me këto të dhëna:


Nr	Institucioni	Të ardhurat nga shitja e biletave në objektet e aksesuara për vizitorë					
		Programuar	Realizuar	Pjesëmarrja 90%		Limiti përdorimit ⁶²	Shpenzuar për mirëmbajtje objekti
				Vlera	%		

⁶² Ministria e Kulturës i kufizon DRTK në ve përdorimin e 90% të të ardhurave të gjeneruara nga shitja e biletave që u takon atyre. Nga 90% që i takon institucioneve për të marrë nga të ardhurat e gjeneruara, konkretisht DRTK Shkodër i është alokuar 23.60% i vlerë, DRTK Berat i është alokuar 29.95%, DRTK Gjirokastrë 5.76% dhe DRTK Vlorë

1	DRTK Shkodër	Ska	10,90,400	9,819,360	90	2,317,800	0
2	DRTK Vlorë	Ska	4,200,800	3,780,720	90	4,700,000	3,780,720
3	DRTK Berat	Ska	18,548,860	16,693,974	90	5,000,000	3,838,790
4	DRTK Gjirokastrë	Ska	15,656,020	14,090,418	90	812,000	119,430
	Totali		38,405,680	44,384,472		12,829,800	7,738,940

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin të buxhetit faktik në DRTK

Referuar të dhënat e evidentuara në tabelat e analizuara më sipër për secilën periudhë raportuese, rezulton se megjithëse pjesëmarrja e institucionit mbi të ardhurat e realizuara është në masë 90%, ndërsa shteti arkëton 10% e mbetur nga këto të ardhura. Ministria e Kulturës ka miratuar limit në përdorimin e të ardhurave, ndërsa bazuar në nevojat për ndërhyrje në mirëmbajtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore ky fond është i pa mjaftueshëm dhe në këto kushte janë realizuar vetëm ndërhyrje më emergjente në objektet e trashëgimisë. Megjithatë ***edhe pse është vendosur limiti i miratuar në përdorimin e të ardhurave për të mirëmbajtur objektet e trashëgimisë së kulturës, përsëri nga DRTK limiti i vendosur nuk është realizuar në masën 100% të fondit të miratuar.***



Përpunimi: KLSH

Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) janë organizuar dhe funksionojnë si njësi shpenzuese e pavarur për të monitoruar, ruajtur, vlerësuar, mbrojtur, administruar dhe mirëmbajtur objektet e trashëgimisë së kulturës në periudhën raportuese ushtrimore (2019-2020-2021) me tregues buxhetor faktik të miratuar të pasqyruar në llogarit ekonomike (600; 601; 231), ndërsa për të mirëmbajtur 2159 objekte të trashëgimisë së kulturës janë kryer shpenzime të administruara në llog.(602) për blerje materiale ndërtimi dhe për të kryer punë publike me procedura prokurimi ***óvlerë e vogëló*** ku shpenzimet për secilën periudhë raportuese treguesit faktik janë të realizuar për sa më poshtë;

Tabela nr. 18 Për periudhën raportuese ushtrimore në vitin 2019 me këta tregues faktik

në 000/lekë

Nr	Institucioni	Treguesit faktik buxhetor të shpenzimev				Struktura organike			
		Llog.(600)	Llog.(601)	Llog.(602)	Llog.(231)	Specialist	Mirmbajtës	Sezonal	Totali
1	IKRTK (QKIPK)	4.978	813	2.363	0	8	0	0	8
2	IKTK (IMK)	31.929	5.324	10.314	29.217	55	0	0	55
3	DRTK Tiranë	Ska	Ska	Ska	0	12	8	2	22
4	DRTK Shkodër	14.771	2.472	6.768	0	12	9	2	23
5	DRTK Vlorë	19.726	3.304	7.990	0	19	17	2	38
6	DRTK Korçë	12.768	2.136	5.635	0	16	10	1	27
7	DRTK Berat	13.665	2.281	7.791	0	24	14	3	41
8	DRTK Gjirokastrë	17.112	2.850	13.660	0	16	14	4	34
	Totali	114.949	19.180	54.521	29.217	162	72	14	248
9	M.Kulturës	890.932	0	486.103	751.665				

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin të buxhetit faktik në DRTK

Pas riorganizimit dhe funksionimit të njësisë shpenzuese (IMK) në IKTK, të (QKIPK) në IKRTK, si dhe DRTK për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 janë këta tregues faktikë:

Tabela nr. 19

në 000/lekë

Nr	Institucioni	Treguesit faktik buxhetor të shpenzimev				Struktura organike			
		Llog.(600)	Llog.(601)	Llog.(602)	Llog.(231)	Specialist	Mirmbajtës	Sezonal	Totali
1	IKRTK	5.936	987	973	0	8	0	0	8
2	IKTK	42.226	7.006	14.247	13.117	55	0	0	55
3	DRTK Tiranë	11.732	1.959	4.170	0	12	8	2	22
4	DRTK Shkodër	13.290	2.237	6.235	0	12	9	2	23
5	DRTK	21.363	3.654	9.991	2.000	19	17	2	38

	Vlorë								
6	DRTK Korçë	15.392	2.571	4.194	0	16	10	1	27
7	DRTK Berat	13.628	2.276	5.363	0	24	14	3	41
8	DRTK Gjirokastrë	16.684	2.788	9.842	0	16	14	4	34
	Totali	134.315	22.491	54.042	15.117	162	72	14	248
9	M.Kulturës	893.531	0	454.045	800.228				

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin të buxhetit faktik në DRTK

Tabela nr. 20 Për periudhën raportuese ushtrimore në vitin 2021 me këta tregues faktik
në 000/lekë

Nr	Institucioni	Treguesit faktik buxhetor të shpenzimev				Struktura organike			
		Llog.(600)	Llog.(601)	Llog.(602)	Llog.(231)	Specialist	Mirmbajtës	Sezonal	Totali
1	IKRTK	5.680	934	1.659	0	8	0	0	8
2	IKTK	43.138	7.228	15.375	4.982	55			55
3	DRTK Tiranë	11.449	1.917	6.395	0	12	8	2	22
4	DRTK Shkodër	13.251	2.236	3.528	0	12	9	2	23
5	DRTK Vlorë	21.071	3.546	8.209	3.744	19	17	2	38
6	DRTK Korçë	15.422	2.571	3.570	1.144	16	10	1	27
7	DRTK Berat	13.784	2.335	8.071	0	24	14	3	41
8	DRTK Gjirokastrë	17.929	3.015	9.485	0	16	14	4	34
	Totali	141.724	23.782	56.292	9.870	162	72	14	248
9	M.Kulturës	910.877	0	426.725	493.463				

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e rakorduar me thesarin të buxhetit faktik në DRTK

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, evidentohen treguesit faktik të realizuar për shpenzimet e kryera në periudhat raportuese ushtrimore nga secila DRTK^{të}, institucione të cilat kanë si qëllim kryesor monitorimin, evidentimin, ruajtjen, vlerësimin, mbrojtjen dhe administrimin e gjendjes teknike të objekteve monumente të tashëgimisë së kulturës dhe të kryejnë investime për restaurimin, rehabilitimin, rikonstruksionin e mirëmbajtjen rutinë.

Duke u referuar në hartën e riskut dhe në monitorimin e vazhdueshëm të kryer nga DRTK^{te} për gjendjen teknike të çdo objekti të trashëgimisë së kulturës të administruar në juridiksion të DRTK^{ve}, njëkohësishtë bazuar në treguesit buxhetor të programuar me kërkesat nëpërmjet PBA periudha (2019-2021), si dhe në nivelin e treguesve buxhetor të miratuar nga MK, apo në treguesit faktik të buxheti të realizuar nga njësia shpenzuese DRTK^{ja}, gjendja e zërit shpenzime për *óInvestimeó* të administruar në llog.(231) me analizë të hollësishme të kërkuara, të miratuara dhe të realizuara për secilën DRTK si njësi shpenzuese, gjendja e investimeve pasqyrohet sa më poshtë:

Tabela nr. 21

Nr	Institucion	2019			2020			2021		
		<i>Të kërkuara në PBA</i>	<i>Miratuar me buxhet dhe te realizuara</i>	<i>Gjendja e evidentuar në bilanc</i>	<i>Të kërkuar a në PBA</i>	<i>Miratuar me buxhet dhe te realizuar</i>	<i>Gjendja e evidentuar në bilanc</i>	<i>Të kërkuar a në PBA</i>	<i>Miratuar me buxhet e te realizuar</i>	<i>Gjendja evidentuar në bilanc</i>
1	IKRTK	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	ITKT	0	29.217	228.318	0	13.117	241.435	617.448	4.982	246.417
3	DRTK BR	0	0	75.829	0	0	75.829	0	0	75.829
4	DRTK SH	3.600	0	209.451	3.600	0	209.451	3.600	0	209.451
5	DRTK TR	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	DRTK KO	93.058	0	0	70.946	0	0	24.950	1.144	0
7	DRTK GJ	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	DRTK VL	61.894	0	27.527	62.900	2.000	36.419	169.329	3.744	42.528
	Totali	158.552	29.217	551.125	137.446	15.117	563.134	815.327	9.870	574.225

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e PBA, të buxhetit dhe Pasqyrat financiare në DRTK

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme evidentohet se gjendja e llogarisë 231 në bilancet e disa institucioneve pasqyrohet me gjendje, ndërkohë që nuk ka objekte në proces restaurimi apo të pa përfunduara, apo të pajisur me certifikatë të marrjes së punimeve në dorëzim për periudhën objekt auditimi.

Nga të dhënat e pasqyruara në këtë tabelë konstatohet se, si domosdoshmëri dhe emergjente nga secila DRTK janë kërkuar fonde për të investuar në restaurime, rehabilitime dhe rikonstruktivime të objekteve të trashëgimisë së kulturës, ku më hollësisht në secilën periudhë evidentohen sa më poshtë;

-në vitin 2019 vlera prej 158.552 mijë lekë;

-në vitin 2020 vlera prej 137.446 mijë lekë;

-në vitin 2021 vlera prej 815.327 mijë lekë.

Megjithëse nga DRTK^{-të} në secilën periudhë raportuese ushtrimore janë bërë kërkesa të vazhdueshme për fonde në investime të cilat i kanë të shoqëruara me projekte të hartuara dhe me vlera preventivi paraprak, ndërsa Ministria e Kulturës në programet buxhetore ka miratuar dhe alokuar fonde për investime me vlerë totale prej **6.888 mijë lekë** ku, më hollësisht në secilën periudhë evidentohen sa më poshtë;

- për vitin 2019, vlera 0 (zero) lekë;

- për vitin 2020, vlera prej 2.000 mijë lekë (për DRTK Vlorë);

- për vitin 2021, vlera prej 4.888 mijë lekë, nga e cila (për DRTK Korçë vlera 1.144 mijë dhe për DRTK Vlorë vlera 3.744 mijë lekë.)

Nga analiza e tabelës me sipër konstatohet se referuar PBA 2019 - 2021, për vitin 2019 janë parashikuar në total për 6 DRTK - të dhe IKRTK e IKTK, fondet prej 158,552 mijë lekë për investime (për mirëmbajtje objekteve), nga të cilat janë miratuar me ligj buxheti shuma prej 29,217 mijë lekë (ose 18% e nevojës), dhe janë realizuar në masën 100%.

Për vitin 2020, sipas PBA janë planifikuar dhe kërkuar 137,446 mijë lekë, nga të cilat janë miratuar 15,117 mijë lekë (ose 11%) dhe janë realizuar 11,709 mijë lekë.

Për vitin 2021, referuar PBA janë kërkuar 815,327 mijë lekë, nga të cilat janë miratuar 9,870 mijë lekë (ose 1% nga sa nevojëtohet) dhe janë realizuar 11,091 mijë lekë.

Gjithë sa më sipër, tregon mungesë totale të mbështetjes me fonde buxhetore, të nevojës për mirëmbajtje të monumenteve të kulturës.

Bazuar në numrin e lartë të objekteve të trashëgimisë kulturore prej **2162**, të cilat kanë nevojë për investime, kjo vlerë e investuar është në kushtet e pa mjaftueshmërisë dhe e pa përfillshme, për gjendjen egzistuese në të cilën gjenden të tyre, megjithëse për periudhën raportuese (2019; 2020; 2021) nga DRTK^{-të} janë bërë vazhdimisht kërkesa për të kryer investime në objektet e trashëgimisë së kulturës rezulton se, MK në cilësinë e investitorit ka realizuar pak investime, edhe këto objekte në të cilat DRTK^{-të} nuk kanë bërë kërkesa për investim, ndërkohë këto objekte nuk i kanë konsideruar prioritare me vlerën e investuar sa më poshtë:

Tabela nr. 22

<i>Nr</i>	<i>Institucioni</i>	<i>Objekti i investuar</i>	<i>Vlera e investimit</i>	<i>Periudha investuar</i>	<i>Investitori</i>
1	DRTK Tirane	-Projekti Elektrik për ndricimin e jashtëm Kalaja e Krujes	15.439.576	2020	M.Kulturës
2		-Restaurimi catise banesës e Sali Shijakut (Faza emergjences) Objekt privat.	1.266.210	2020	M.Kulturës
3	DRTK Gjirokastrë	-Restaurim Kisha Shen Ilias Stegopull Gjirokastrë	7.759.380	2020	IKTK
4		-Projekti Elektrik për ndricimin e jashtëm Kalaja e Gjirokastrës	22.239.536	2020	M.Kulturës
		Totali i investuar nga Ministria e Kulturës	46.704.702		

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga treguesit e PBA, të buxhetit dhe Pasqyrat financiare në DRTK

Nga procesi i auditimit në pasqyrat e pozicionit financiar të njësive shpenzuese konstatohet se, në llog.(231) *óPër aktive afatgjata materiale* pasqyrohet me vlerë të investuar gjendje në datë 31.12.2021 me shumën **574.225 mijë lekë** vlerë e cila përfaqëson investimet e kryera që duhet të jetë në proces realizimi, apo të pa përfunduara në objekte e investuara, ndërsa në fakt nga analiza e hollësishme e kësaj llogarie ekonomike, kjo gjendje është vlerë e mbartur nga periudhat paraardhëse që nga viti 2005 e mbrapa të pa analizuar dhe të pa dokumentuara me emërtim të objektit që është investuar, me vlerën e kontratës, me operatorin ekonomik që ka kryer investimin, për pasojë kjo vlerë e investuar nuk është e përfshirë në vlerën e objektit dhe nuk është trupëzuar si vlerë e shtuar e AAGJ^{ve}, ndërkohë që në objekte është investuar edhe për instalime në pajisje më konkretisht për biletarinë vlera e të cilave nuk është inventarizuar në shtesë të AAGJ^{-të}.

Për këtë qëllim IKMT me shkresën nr.760, datë 17.04.2020 i ka kërkuar dhe shkresën nr.1367, datë 06.08.2021 rikërkuar Ministrisë së Kulturës që të miratojë kalimin kapital të këtyre investimeve drejtë atyre institucioneve që administrojnë këto objekte monumente të kulturës të investuara duke hartuar edhe aktet rregullative për të kaluar në administrim të llogarive Klasa (2) *óAktive afat gjata materiale*, në se investimi në objekt ka përfunduar dhe është i pajisur me certifikatën e marrjes përfundimtare në dorëzim, detyrim për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës.

Ky veprim nuk ka gjetur përgjigje dhe zbatim, ndërsa është në mospërputhje me VKM nr.153, datë 03.04.1993 *óPër kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarjeve dhe institucionet shtetërore*, me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* i ndryshuar, si dhe me UKM nr.30, datë 27.12.2011 *óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* i ndryshuar.

Gjetje nga auditimi:

29. Mbështetja financiare me fonde buxhetore e DRTK ñ ve për mirëmbajtje të monumenteve të kulturës ka qenë e pamjaftueshme krahasuar numrin e lartë të objekteve të trashëgimisë kulturore. DRTK^{-të} kanë bërë vazhdimisht kërkesa për investime për të përmirësuar gjendjen e objekteve të trashëgimisë kulturore materiale, por këto nuk janë miratuar. MK ka realizuar pak investime, në objekte për të cilat DRTK^{-të} nuk kanë bërë kërkesa për investim.

30. Referuar të ardhurave të realizuara nga DRTK - të, ka rezultuar se megjithëse pjesëmarrja e institucionit mbi të ardhurat e realizuara është e miratuar në masën 90% (ose 102,555,586 mijë lekë per periudhën 2019 - 2021), nga njësia eprore është miratuar limit në përdorimin e tyre, ndërkohë që bazuar në nevojat për ndërhyrje në mirëmbajtjen e pasurive së trashëgimisë kulturore ky fond është i pamjaftueshëm. Në këto kushte janë realizuar vetëm ndërhyrjet më emergjente. Nga ana tjetër, pavarësisht uljes së të ardhurave në dispozicion të DRTK ñ ve për të mirëmbajtur objektet e trashëgimisë kulturore, përsëri DRTK - të nuk e kanë realizuar në masën 100% fondin e miratuar.

Konkluzione

15. Mos alokimi i fondeve në nivelet e kërkuara nga institucionet dhe në mosrespektim të nevojave të tyre nuk ndihmon proceset e punës së tyre në drejtim të mbrojtjes dhe administrimit të monumenteve të kulturës.

16. Mos përdorimi në total i të ardhurave (edhe pse të limituara) evidenton mungesë programimi efektiv nga DRTK për këto burime financiare.

Rekomandime

20. DRTK-ntë, të programojnë mbi bazë risku përdorimin e të ardhurave të realizuara duke evidentuar ndërhyrjet emergjente në monumentet e kulturës, me qëllim përdorimin frutdhënës të të ardhurave të realizuara dhe alokuara nga Ministria e Kulturës, duke shmangur djegjen e fondeve.

Në vijimësi

21. MK, në cilësinë e institucionit epror, të analizojë kërkesat buxhetore të DRTK-ntë ve lidhur me zërin investime, në mënyrë që alokimet e fondeve të jenë në limite të kënaqshme dhe sa më afër nevojave të këtyre institucioneve.

Brenda vitit 2023

22. MK të alokojë pjesën takuese të të ardhurave të realizuara nga DRTK-ntë në masën 90%, kundrejt prezantimit të ndërhyrjeve konkrete nga këto institucione në monumentet e kulturës që ato mbrojnë dhe administrojnë.

Brenda vitit 2023

4.3.2 A ka sjellë financimi buxhetor impaktin e duhur në mirëadministrimin e monumenteve të kulturës?

Nga auditimi i gjendjes së monumenteve, IKTK ka vendosur në dispozicion të grupit të auditimit të dhënat mbi gjendjen aktuale të monumenteve të kulturës sipas kategorive si më poshtë:

Drejtoret Rajonale të Trashëgimisë Kulturore		Shkalla 1	Shkalla 2	Shkalla 3	Shkalla 4	Shkalla 5	Shkalla 6	Shkalla 7	Tot. Mon.	Tot. Zona
		Monumente që nuk ekzistojnë	Objekte plotësisht të shkatërruara	Objekte në rrezik qendrueshmërie	Objekte në gjendje të pranueshme por në nevojë restaurimi	Objekte në gjendje të mirë; në nevojë mirëmbajtje të vazhdueshme	Objekte të tjetërsuara	Objekte pa kartelë		
DRIK BERAT	Qarku Berat	7	2	28	353	90	0	0	480	10
DRTK GJIROKASTËR	Qarku Gjirokastrë	16	41	52	173	218	49	10	559	30
DRTK SHKODËR	Qarku Kukës	5	4	8	13	11	0	0	41	2
	Qarku Lezhë	2	3	13	3	12	1	0	34	10
	Qarku Shkodër	18	8	15	52	43	20	0	156	15
DRTK TIRANË	Qarku Dibër	13	2	8	18	24	2	0	67	2
	Qarku Durrës	10	2	11	14	14	2	1	54	10
	Qarku Tiranë	6	1	20	16	212	0	3	258	20
DRTK KORÇË	Qarku Korçë	2	10	28	105	20	6	0	171	37
	Qarku Elbasan	24	31	26	33	15	10	0	139	10
DRTK VLORË	Qarku Fier	9	7	8	5	16	1	0	46	10
	Qarku Vlorë	10	11	21	99	70	7	1	219	41
TOTAL		122	122	238	884	745	98	15	2224	197

Tabela nr. 23 Gjendja e monumenteve

Ka rezultuar sikundër evidentohet edhe nga tabela e mësipërme se në total në vendin tonë janë rreth 122 monumente që nuk ekzistojnë, 122 monumente që janë plotësisht të shkatërruara, 884 monumnete në gjendje të pranueshme por që kanë nevojë për restaurim, 745 objekte në gjendje të mirë dhe në nevojë për një mirëmbajtje të vazhdueshme, 98 objekte të tjetërsuar si dhe 15 objekte pa kartelë.

Në raportet vjetore të monitorimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi për qëllimin e politikës nr. 1 Ruatja, mbrotja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale, realizuara nëpërmjet objektivit të politikës nr. 1 Rahabilitimi i trashëgimisë kulturore arkitektonike dhe të peizazhit përmes rritjes së monumenteve të rehabilituara raporton se janë restauruar dhe mirëmbajtur 140 objekte të trashëgimisë arkitektonike dhe të peizazhit.

Më konkretisht për vitin 2019 raportohet sa më poshtë

- Me investime nga Buxheti Shteti është kryer restaurimi i plotë i objektit "Mësonjëtorja e Parë Shqipe, Korçë" me fond 29,647,238.4 lekë.

- Mirëmbajtja e Monumenteve të Kulturës realizuar me me fondin - Art 602, (mirëmbajtje e objekteve) ka qenë në vlerën 27,420,481 lekë.

Në funksion të realizimit të objektivave dhe detyrave përgjatë vitit 2019, Drejtoret Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, si institucionet përgjegjëse në administrimin e vlerave të trashëgimisë

kulturore në territoret nën juridiksionin e tyre, përmes zërit art. 602 të buxhetit të shtetit, me fondin 27,420,481 lekë, kanë kryer punime **mirëmbajtje/restaurimi në 109 objekte** dhe **pastrime, sistemime në 83 objekte**. Punimet e realizuara në këto objekte konsistojnë kryesisht në nxjerrjen e objekteve nga gjendja e riskut apo dhe me qëllim mbrojtjen e tyre nga degradimi i mëtejshëm, kryesisht punime mirëmbajtje/restaurim çati, fasada, konsolidime muresh, konsolidime afreskesh, pastrime nga vegjetacioni si dhe në përgatitjen e objekteve të trashëgimisë kulturore për sezonin turistik.

Sipas Institucioneve mirëmbajtje/restaurim dhe pastrime të realizuara si më poshtë:

Tabela nr. 24

Institucioni	Nr. Monumente të mirëmbajtura (buxheti i shtetit Art. 602)			
	Mirëmbajtje/Restaurim	Pastrim	Gjithsej	Vlera e mirëmbajtjes (lekë)
DRTK Berat	32	4	36	5,022,984
DRTK Gjirokastrë	40	11	51	6,859,454
DRTK Durrës	8	22	30	2,675,407
DRTK Vlorë	8	24	32	3,923,223
DRTK Korçë	8	20	28	2,573,359
DRTK Shkodër	13	2	15	6,366,054
Total	109	83	192	27,420,481

Sipas raportit të monitorimit të buxhetit për vitin 2020, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, nuk kanë mundur të kryejnë planin e parashikuar për mirëmbajtjen, restaurimin, konsolidimin, pastrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në territoret nën juridiksionin e tyre. Kjo për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid 19. Mungesa e fondeve nga të ardhurat që do të vilesnin nga vizitorët në muzetë, monumentet dhe parqet arkeologjike. Janë kryer kryesisht punime mirëmbajtje rutinë të objekteve të vizitueshëm, nxjerrjen e disa objekteve/banesave nga gjendja e riskut, pastrime nga vegjetacioni si dhe përgatitjen e objekteve të trashëgimisë kulturore për sezonin turistik.

Janë kryer punime mirëmbajtje dhe pastrime nga vegjetacioni në rreth 150 objekte monument kulture nga të cilat restaurim, konsolidim mirëmbajtje në rreth 68 objekte. Sipas Institucioneve mirëmbajtje/restaurim dhe pastrime të realizuara si më poshtë:

Tabela nr. 25

Institucioni	Nr. Monumente të Mirëmbajtura (Buxheti i Shtetit Art. 602)			
	Restaurim	Pastrim	Gjithsej	Vlera e Mirëmbajtjes (Lekë)
DRTK Shkodër	4	8	12	4,059,142
DRTK Berat	17	0	17	4,240,628
DRTK Tiranë	10	8	18	2,784,649
DRTK Korçë	11	27	38	959,840
DRTK Gjirokastrë	23	3	26	182,852
DRTK Vlorë	3	37	40	1,432,800

Total	68	83	151	13,659,911
--------------	-----------	-----------	------------	-------------------

Sipas raportit të monitorimit të buxhetit për vitin 2021 Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, kanë mundur të kryejnë aktivitetin për mirëmbajtjen, restaurimin, konsolidimin, pastrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në territoret nën juridiksionin e tyre, sipas tabelës së mëposhtme

Janë kryer punime mirëmbajtje dhe restaurime në 115 objekte, ndërsa së bashku me pastrime nga vegjetacioni arrijnë në rreth 183 objekte të monumenteve të kulturës, si në ndërhyrje restauruese, konsolidimese apo edhe mirëmbajtje. Sipas Institucioneve mirëmbajtje/restaurim dhe pastrime të realizuara si më poshtë:

Tabela nr. 26

Institucioni	Nr. Monumente të Mirëmbajtura (Buxheti i Shtetit Art. 602)		
	Restaurim	Pastrim	Gjithsej
DRTK Shkodër	19	17	36
DRTK Berat	15	0	15
DRTK Tiranë	8	7	15
DRTK Korçë	19	135	154
DRTK Gjirokastrë	38	5	42
DRTK Vlorë	4	-	4
Total	103	164	266

Sikundër edhe evidentohet nga të dhënat e mësipërme numri i objekteve të restauruara dhe të mirëmbajtura krahasuar me totalin e monumenteve në risk dhe në nevojë për ndërhyrje është i papërfillshëm. Është evidentuar gjithashtu gjatë auditimit mungesë qartësie në vendosjen e prioriteteve referuar monumenteve për të cilat duhet ndërhyrë. Pavarësisht faktit se ekziston një klasifikim sikundër evidentuar dhe më lart, nuk ekziston një mënyrë e qartë për të përcaktuar cilat janë objektet në të cilat duhet ndërhyrë dhe kur, sipas një renditjeje transparente dhe të argumentuar.

Gjetje nga auditimi:

31. Nga auditimi ka rezultuar se financimi buxhetor për periudhën objekt auditimi nuk ka qenë i mjaftueshëm për të përmirësuar gjendjen e monumenteve të kulturës.

32. Gjendja aktuale e monumenteve në vendin tonë është si më poshtë: **122** monumente që nuk ekzistojnë, **122** monumente janë plotësisht të shkatërruara, **884** monumente në gjendje të pranueshme por që kanë nevojë për restaurim, **745** objekte në gjendje të mirë dhe në nevojë për një mirëmbajtje të vazhdueshme, **98** objekte të tjetërsuar si dhe **15** objekte pa kartelë. Numri i objekteve të restauruara dhe të mirëmbajtura krahasuar me totalin e monumenteve në risk dhe në nevojë për ndërhyrje është i papërfillshëm. Në total për të tre vitet objekt auditimi janë mirëmbajtur/restauruar **280** objekte, janë pastruar kryesisht nga mbeturinat dhe vegjetacioni **330** monumente, pra gjithsej **610** monumente.

33. Nga auditimi është konstatuar se, pavarësisht klasifikimit të monumenteve mbi bazë risku, nuk ekziston një mënyrë e qartë për të përcaktuar cilat janë objektet në të cilat duhet ndërhyrë më parë dhe kur, sipas një renditjeje transparente dhe të argumentuar.

Konkluzione

17. Financimi buxhetor i pamjaftueshëm nuk ka ndihmuar institucionet në punën e tyre për përmirësimin e gjendjes së monumenteve të kulturës në vendin tonë, duke penguar ndërhyrjen në përmirësimin e gjendjes së tyre aktuale.

18. Mungesa e një analize të detajuar mbi shkaqet që kanë çuar në degradimin e shumë monumenteve të kulturës si dhe mos ndërhyrja aty ku është i mundur rikuperimi, nuk ka lejuar që institucionet të ndërgjegjësohen për veprimtaritë që duhen ndërmarrë për të rikthyer në jetë kujtesën kombëtare.

Rekomandime

23. MK, në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të ngrejë një grup pune, me qëllim analizimin e shkaqeve që kanë sjellë degradimin, tjetërsimin ose dhe rrënimin e monumenteve të kulturës në vendin tonë, duke propozuar gjithashtu edhe zgjidhje konkrete, sipas prioriteteve dhe të buxhetuara për përmirësimin e atyre monumenteve që paraqesin riskun më të madh për tu zhdukur apo për të humbur vlerat kulturore e arkitektonike.

Dhjetor 2022

5. PËRMBLEDHJA

Auditimi i Performancës me temë ÓMbrotja dhe Administrimi i Monumenteve të KulturësÓ ka pasur për objekt trashëgiminë kulturore materiale të paluatshme (pra monumentet e kulturës së kategorisë së parë dhe të dytë) në vendin tonë.

Nëpërmjet këtij auditimi është synuar vlerësimi i efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen dhe administrimin e monumenteve të kulturës në përfitim të promovimit të vlerave kulturore kombëtare të këtyre monumenteve, për periudhën 2019 ñ 2021.

Subjektet e këtij auditimi kanë qenë institucionet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e monumenteve të kulturës, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin me sukses të këtyre proceseve. Keto subjekte janë:

1. Ministria e Kulturës.
2. Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.
3. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.
4. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.
5. Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

Për pyetjen kryesore, **A kanë rezultuar efektive masat e marra për menaxhimin e monumenteve të kulturës për periudhën 2019 - 2021?** u arrit në këtë mesazh auditimi:

ÓInstitucionet përgjegjëse për menaxhimin e monumenteve të kulturës nuk e kanë orientuar veprimtarinë e tyre në mënyrë efektive, me qëllimin final, mbrojtjen, mirë - administrimin, inventarizimin dhe vlerësimin e monumenteve në vendin tonë, me rezultatin e vetëm⁶³ që **122** monumente nuk ekzistojnë, **122** monumente janë plotësisht të shkatërruara, **884** monumente në

⁶³ Të dhëna zyrtare të përpunuara nga IKTK për qëllimin e këtij auditimi.

gjendje të pranueshme por që kanë nevojë për restaurim, **745** objekte në gjendje të mirë dhe në nevojë për një mirëmbajtje të vazhdueshme, **98** objekte të tjetërsuar si dhe **15** objekte pa kartelë. Kjo situatë është shkaktuar edhe nga një programim ineffektiv i burimeve njerëzore dhe financiare në territor, sidomos sa i takon institucioneve të specializuara të ngarkuara me mbrojtjen dhe administrimin e këtyre monumenteve. Nga ana tjetër, Ministria e Kulturës, si institucion politikëbërës nuk është angazhuar maksimalisht në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore, duke lënë sistemin kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore *pa Inspektoriat*, çka do të thotë, pa patur në dorë mundësinë e ndëshkimit ndaj atyre që abuzojnë, shkatërrojnë apo tjetërsojnë monumentet e kulturës.

Ministria e Kulturës në të ardhmen duhet të angazhohet në bashkëpunim me institucionet e varësisë, por edhe me institucionet e tjera për të hartuar dokumentet dhe propozuar miratimin e procedurave të domosdoshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme në vendin tonë, për të sjellë një përmirësim konkret në gjendjen e tyre aktuale.®

Nga auditimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve janë vërejtur problematika lidhur hartimin dhe miratimin akteve nën ligjore në zbatim të ligjit nr. 27/2018 *óPër trashëgiminë kulturore dhe muzetë*®, të cilat kanë cunguar dukshëm aktivitetet dhe përmbushjet e misioneve respektive të institucioneve të tjera të sistemit kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore, sidomos në nivel të Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

Në mungesë të planeve (dokumente të planifikimit) të cilat duhet të harmonizojnë politikat makro të Ministrisë së Kulturës me politikat e institucioneve të tjera në nivel qendror dhe vendor, ndërhyrjet në monumentet e kulturës kanë qenë masive dhe të natyrave e varieteteve të ndryshme si për shembull, ndërtime të paautorizuara, zbatim projektesh në mos plotësim të kërkesave ligjore, pamundësia për të ndëshkuar shkelësit e ligjit, bashkëpunimi i ulët ndër-institucional sidomos me institucionet e vetëqeverisjes vendore etj.

Në këtë situatë nevojitet një ndërhyrje e vendosur dhe e koordinuar për të shpëtuar atë çka ka mbetur nga pasuria jonë kombëtare.

6. SHTOJCAT

Shtojca nr.1

- VKM Nr. 208, datë 10.4.2019 *óPër përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*®.
- Vendim Nr. 279, datë 2.5.2019 *óPër përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore*®.
- VKM nr. 169, datë 20.2.2020 *óPër shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme*®.
- VKM nr.792, datë 7.10.2020 *óPër përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale*®.
- VKM nr. 425 datë 27.05.2020 *óPër procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore*®i ndryshuar.

- VKM nr. 793, datë 7.10.2020 óPër përcaktimin e kushteve të posaçme e të kriterëve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujoreô
- VKM nr.857, datë 24.12.2019 óPër procedurat dhe kriteret e konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturoreô.
- VKM Nr. 687, datë 23.10.2019 óPër miratimin e zonës arkeologjike óAô të qytetit të Elbasanit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e sajô.
- VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 óPër miratimin e zonës arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyreô. .
- VKM Nr. 771, datë 30.9.2020 óPër deklarimin pasuri kulturore të óQendrës historikeô të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyreô.
- VKM Nr. 582, datë 3.10.2018 óPër deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e sajô.
- Udhëzim Nr. 583, datë 14.10.2019 óPër miratimin e kriterëve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrimô.
- VKM Nr. 625, datë 04.09.2019 óPër miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore publike dhe të funksionimit të subjekteve juridike të themeluara në formën e fondacionitô.
- VKM Nr. 737, datë 17.09.2020 óPër përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materialeô.
- VKM Nr. 364, datë 29.5.2019 óPër funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturoreô.
- VKM Nr. 208, datë 10.4.2019 për óPërbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materialeô.KKTKMô.
- VKM Nr. 857, datë 24.12.2019 óProcedurat dhe kriteret e konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturoreô. Butrinti
- VKM nr. 220, datë 7.4.2021 óPër kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqërues, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike.ô
- VKM nr. 792, datë 7.10.2020 óPër përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materialeô, i ndryshuar me VKM Nr.329, datë 02.06.2021.
- VKM nr. 329 datë 2.06.2021 óPër disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 792, datë 07.10.2020, të Këshillit të Ministrave óPër caktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategoritë e licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionin vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materialeô.
- VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 óPër projektimin, zbatimin e punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e tyreô.

- VKM nr. 1099, datë 24.12.2020 óPër miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore.
- VKM Nr. 729, datë 16.09.2020 óPër deklarimin pasuri kulturore "Qendër historike" të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.
- VKM Nr. 771, datë 30.9.2020 óPër deklarimin pasuri kulturore të óQendrës historike të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.
- VKM Nr. 560, datë 15.07.2020 óProcedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje apo kolaudim në pasuritë kulturore.
- VKM Nr. 399, datë 13.05.2020 óPër përcaktimin e kufijve të parkut arkeologjik Durrës.
- VKM nr. 199, datë 31.3.2021 óPër kushtet e posaçme të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifat e aplikimit dhe të kuotizacionit vjetor për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore. (Tregtia e pasurive kulturore).
- VKM nr. 199, datë 31.3.2021 óPër përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, procedurave për shqyrtimin ose anulimin e licencës, tarifave të kërkesës dhe kuotizacionit vjetor të licencave për veprimtari tregtare të pasurive kulturore.
- VKM nr 220, datë 7.4.2021 të Keshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike.
- VKM nr. 220, datë 7.4.2021 óPër përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike.
- Udhëzimin nr. 583, datë 14.10.2019 óPër miratimin e kritereve dhe procedurave standarde të kalimit të pronës në administrim.
- Urdhrin nr. 223, datë 3.7.2020 óPër rregulloren për veprimtarinë e KKMPK-së dhe sekretarisë teknike.
- Urdhrin për formatin e kërkesës dhe dokumentacionin shoqërues për lëshimin e lejes për ndërhyrje në pasuritë kulturore. (ky urdher është miratuar por disponohet nga sekretaria e IKT).
- VKM nr.399, datë 13.05.2020 óPër përcaktimin e kufijve të parkut arkeologjik Durrës.
- VKM nr. 792, datë 7.10.2020 óPër përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale, të ndryshuar.Vendimi nr. 438, datë 22.06.2022 "Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Pallatit të Brigadave".
- Vendimi nr. 420, datë 15.06.2022 óPër marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura".
- Udhëzimi nr. 374, datë 24.06.2021 "Për përcaktimin e rregullave të monitorimit dhe vlerësimit të subjekteve që kanë në administrim pasuritë kulturore";

Shtojca nr. 2

- Në zbatim të pikës 1, të nenit 19, óUdhëzimin për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturoreô.
- Në zbatim të pikës 6, të nenit 53, óUdhëzimin për termat dhe kushtet për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshmeô.
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 56, óUdhëzimin për procedurat dhe mënyrat e inventarizimit, regjistrimit dhe katalogimit të pasurive kulturoreô.
- Në zbatim të pikës 8, të nenit 56, óUdhëzimin për funksionimin e Sistemit digjital për bazën e të dhënave të pasurive kulturoreô.
- Në zbatim të pikës 1 të nenit 58, óUdhëzimin për kriteret dhe mënyrat e depozitimit të kërkesave për verifikim, metodologjinë e tarifave, organet këshillimore, kriteret për marrjen e vendimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të aplikimitô..
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 58, óUdhëzimin për kriteret e përpilimit të listave të pasurive të paluajtshme në pronë shtetërore, mënyrat e redaktimit të skedave përshkruese dhe dërgimin e tyre për verifikimô.
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 59, óUdhëzimin për mënyrën e funksionimit të komisionit këshillimor për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe në pasuritë jomaterialeô. (Në fazë bashkërendimi me strukturat e brendshme në MK, hartuar drafti fillestar nga Drejtoria Juridike).
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 59 ,óUdhëzimin për kriteret dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, të krijuar pranë IKRTK-së, IKTK-së dhe QKVT-sëô.(Në fazë bashkërendimi me strukturat e brendshme në MK, hartuar drafti fillestar nga Drejtoria Juridike).
- Në zbatim të pikës 12, të nenit 71, óUdhëzimin për procedurën për kryerjen e kontrollit teknik të pasurive kulturore të paluajtshmeô.
- Në zbatim të pikës 6, nenit 82, dhe të pikës 2 të nenit 137, óUdhëzimin për kriteret dhe nivelet e cilësisë që duhet të ketë programi i formimit vazhdues të personave të pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe me licence për kryerjen e veprimtarive arkeologjikeô.
- Në zbatim të pikës 3, nenit 85, óUdhëzimin për mënyrën dhe formën e mbajtjes së informacionit nga subjektet publike ose private për pasuritë kulturore që kanë në pronësi ose administrimô.
- Në zbatim të pikës 9, të nenit 92,óUdhëzimin për mënyrat e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëseô.
- Në zbatim të pikës 3, të nenit 100, óUdhëzimin për kushtet, kriteret, procedurat, mënyrat, kohëzgjatjen dhe tarifat për dhënien e miratimit dhe deklarin e interesit kulturorô.
- Në zbatim të pikave 1 dhe 4, të nenit 102, óUdhëzimin për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteveô.
- Në zbatim të pikës 7, të nenit 116, óUdhëzimin për krijimin dhe funksionimin e óRegjistrimit të tregtimit të pasurive kulturoreô.
- Në zbatim të pikës 4, të nenit 123, óUdhëzimin për procedurat dhe mënyrat e daljes së pasurive jashtë venditô.
- Në zbatim të pikës 6, të nenit 130, óUdhëzimin për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhuraô.

- Në zbatim të nenit 140 të këtij ligji óUdhëzimin për rregullat e hollësishme mbi lejen për hulumtime arkeologjikeô.
- Në zbatim të pikës 2, nenit 150, të këtij ligji óUdhëzimin për mënyrën e vlerësimit të gjetjeve rastësore të objekteve arkeologjikeô.
- Në zbatim të pikës 2, të nenit 165, óUdhëzimin për format e mbështetjes së veprimtarive dhe strukturave për vlerësimin e pasurive kulturore në pronësi privateô.
- Në zbatim të pikës 2, nenit 179, óUdhëzimin për përcaktimin e rregullave për dhënien në përdorim të drejtpërdrejtë të pasurive kulturoreô.
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 96 të këtij ligji duhet të miratojë óParashikimet në lidhje me zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, të veçanta, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhinô.
- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352 datë 18.11.2010 "Për artin dhe Kulturën", duhet të miratohej në katërmujorin e I Janar 2019, është planifikuar në PPAP 2022, në katërmujorin e III.
- Projektvendimi óPër mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të komisionit këshillimor të ngritur pranë QKVT-së, IKRTK-së dhe IKTK-së për vlerësimin dhe identifikimin e pasurive kulturoreô, katërmujori I Shkurt 2019, nuk është miratuar ende. Në fazë hartimi, shkresë për MFE, për tu përfshirë në Vendimin e Bordeve dhe Këshillave të institucioneve qendrore.
- Projektvendimi óPër përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim indirekt të pasurive kulturore personave fizikë apo juridikë, publikë ose privatëô, është në fazë bashkrendimi final.
- Projektvendimi óPër përcaktimin e tarifave për shpërblim të arsyeshëm nga riprodhimi i veprave për përdorim privat ose për përdorim tjetër personalô. Detyrim Ligjor, ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", pika 1 e nenit 31Referuar vendimit nr. 850, datë 29.12.2021 óPër miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve (PPAP) që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022, ky akt është planifikuar për tu realizuar dhe miratuar në katërmujorin e dytë.
- Projektvendimi óPër format dhe llojet e licencave të qarkullimit të lirë për eksportin e pasurive kulturore të luajtshmeô, planifikuar në katërmujorin e III Dhjetor 2019, është në fazë hartimi
- Projektligji óPër krijimin dhe funksionimin e zonës së veçantë të zhvillimit artistik dhe kulturor në Pallatin e Brigadaveô, është në fazë bashkërendimi final me ministritë e linjës.
- Vendimi óPër përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurisë kulturoreô, Qershor 2021, detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", shkonja "c" e pikes 3 e nenit 171
- Vendimi óPër përcaktimin e funksionimit, organizimit dhe veprimtarisë së Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurimô, Korrik 2021, detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", pika 9 e nenit 29.

7. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE

1. Xh. Ç. ñ Përgjegjës i grupit të auditimit
2. M. L. ñ Anëtare e grupit të auditimit
3. V. R. ñ Anëtar i grupit të auditimit
4. H. K. ñ Anëtar i grupit të auditimit